NDRYSHIMET KUSHTETUESE NË MEDIA: DEZINFORMATA, MANIPULIME MEDIATIKE, GJUHË E URREJTJES (ANALIZA)

iM@

NDRYSHIMET KUSHTETUESE NË MEDIA:

DEZINFORMATA, MANIPULIME MEDIATIKE, GJUHË E URREJTJES (ANALIZA)

Publikim: Ndryshimet kushtetuese në media: Dezinformata, manipulime mediatike, gjuhë e urrejtjes (analiza)

Botues:

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

Redaktorë:

Petrit Saraçini, kryetar i IMA

Zharko Trajanoski, drejtues i hulumtimeve në IMA

Autorë:

Zharko Trajanoski

Zoran Bojarovski

Dr. Sefer Tahiri

Petrit Saraçini

Përkthimi:

Riza Imeri

Meriton Tusha

Dizajni:

Jane Stefanov

Shkup, shator 2023

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Fondit Evropian për Demokraci (FED) - European Endowment for Democracy (EED). Përmbajtja e tij nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionin zyrtar të EED. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takon tërësisht autorit(ëve).

PËRMBAJTJA

HYRJE 5

ZHARKO TRAJANOSKI
DEZINFORMATA, TEORI TË KONSPIRACIONIT DHE MANIPULIME MEDIATIKE PËR NDRYSHIMET E PROPOZUARA KUSHTETUESE 7

ZORAN BOJAROVSKI
NDRYSHIMET KUSHTETUESE NË ALGORITMIN DEZINFORMATA – URREJTJE – POLARIZIM 37

DR. SEFER TAHIRI
MEDIAT SHQIPE: NDRYSHIMET KUSHTETUESE, DOMOSDOSHMËRI PËR INTEGRIM NË BE 51

PETRIT SARAÇINI
NDRYSHIMET KUSHTETUESE NË MEDIA DHE RRJETET SOCIALE: POLARIZIM DHE URREJTJE E FUQISHME, ONLAJN MODERIM I DOBËT, PAK HULUMTIME DHE ANKESA DREJTUAR TRUPAVE VETËRREGULLUESE 63

Hyrje

Publikimi “Ndryshimet kushtetuese në media: Dezinformata, manipulime mediatike, gjuhë e urrejtjes (analiza)” sjell analiza autoriale, në të cilat hulumtues të shquar me përvojë shumëvjeçare në media dhe në organizatat profesionale mediatike paraqesin gjetje, shembuj, pikëpamje dhe opinione për raportimin e mediave, dezinformatat, manipulimet mediatike dhe gjuhën e urrejtjes lidhur me ndryshimet e propozuara kushtetuese, të cilat janë kusht për vazhdimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Përmes analizimit të mënyrave se si është zhvilluar raportimi mediatik dhe komunikimi publik për këtë çështje, analizat e katër autorëve në këtë botim synojnë të zbulojnë narrativët dhe modelet kryesore të dezinformimit, manipulimit mediatik dhe gjuhës së urrejtjes dhe të tregojnë zgjidhjet e mundshme që do të kontribuonin për ulje të dëmeve nga polarizimi i publikut në debatin për ndryshimet kushtetuese.

Në analizën “Dezinformata, teori të konspiracionit dhe manipulime mediatike për ndryshimet e propozuara kushtetuese” autori Zharko Trajanoski bën me dije se narrativët dhe manipulimet dezinformuese që u njohën gjatë debatit publik për “propozimin francez” në vitin 2022, si dhe më herët gjatë Marrëveshjes së Prespës. referendumit dhe ndryshimeve kushtetuese në 2018 dhe 2019, vazhduan edhe në vitin 2023 në komunikimin mediatik dhe publik lidhur me ndryshimet kushtetuese.

Përmes shembujve konkretë, analiza e Trajanoskit i prezenton narrativët kryesorë që përmbanin dezinformata, teori konspirative dhe manipulime mediatike, duke përfshirë ato për “gjenocid dhe etnocid” kundër popullit maqedonas, “bullgarizim”, dezinformata për gjuhën maqedonase, dezinformata për fillimin, hapjen dhe vazhdimin e negociatave me BE-në, si dhe dezinformatat historike që ishin pjesë e pashmangshme e komunikimit mediatik dhe publik edhe për ndryshimet kushtetuese.

Në analizën “Ndryshimet kushtetuese në algoritmin dezinformata-urrejtje-polarizim”, autori Zoran Bojarovski nis me një kronologji të ngjarjeve dhe shpërthimin e gjuhës së urrejtjes gjatë të ashtuquajturit “propozim francez” për tejkalimin e kontestit me Bullgarinë dhe fillimit të negociatave të Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE, karakteristikat e të cilës u pasqyruan edhe në raportimin mediatik dhe debatin publik për ndryshimet kushtetuese.

Autori bën me dije se gjuha e urrejtjes ishte një “shoqërues” i fuqishëm i debatit publik edhe në këtë fazë - veçanërisht në episodet “Protokolli”, “Klubet bullgare në Maqedoni”, “Përcaktimi i amendamenteve kushtetuese nga grupi i ekspertëve” dhe në disa

episode tjera. Analiza identifikon karakteristikat dhe elementet e gjuhës së urrejtjes dhe mënyrën se si ato reflektohen në mjedisin aktual të komunikimit në vend në kontekst të ndryshimeve të propozuara kushtetuese.

Dr.Sefer Tahiri në këtë botim merr pjesë me analizën e titulluar "Mediat shqipe: Ndryshimet kushtetuese, domosdoshmëri për integrim në BE". Nga kjo analizë rezulton se mediat në gjuhën shqipe, ngjashëm me një vit më parë për "propozimin francez", kanë pasur raportim kryesisht afirmativ për ndryshimet e propozuara kushtetuese, të cilat janë kusht për vazhdimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE.

Tahiri bën me dije se edhe pse raportimi ishte kryesisht i balancuar, me hapësirë për pikëpamjet e partive në pushtet dhe opozitë nga kampusi politik shqiptar dhe maqedonas, prapëseprapë në një pjesë të mediave ka pasur tone kritike ndaj qëndrimeve të VMRO-DPMNE-së opozitare, ndërsa shumë vëmendje i është kushtuar edhe çështjes së trajtimit kushtetues të gjuhës shqipe si "gjuhë e folur nga 20 për qind e popullsisë", ku ndryshimet kushtetuese theksohen si mundësi për ndryshime dhe korrigjim të formulimit që politikanët dhe mediat në gjuhën shqipe e konsiderojnë si padrejtësi. Autori ndalet edhe në rastet e raportimeve sensacionale, përdorimin e fjalorit fetar, si dhe në përmbajtjet mediatike me dezinformata.

Pjesë e këtij botimi është edhe analiza e autorit Petrit Saraçini "Ndryshimet kushtetuese në media dhe në rrjetet sociale: Polarizim dhe urrejtje e fuqishme, onlajn moderim i dobët, pak hulumtime dhe ankesa drejtuar trupave vetërregulluese". Në të, përmes qëndrimeve të disa organizatave profesionale mediatike, analizohet raportimi i mediave për ndryshimet kushtetuese, si dhe polarizimi i fuqishëm dhe gjuha e urrejtjes që u shkaktuan nga kjo temë në opinion, por veçanërisht në rrjetet sociale.

Në pikëpamjet e shprehura, mbizotëron mendimi se tema e ndryshimeve kushtetuese shkakton një polarizim të dukshëm të opinionit, por nga ana tjetër vërehet edhe mungesa e hulumtimeve mediatike më gjithëpërfshirëse dhe profesionale për këtë çështje, për të cilën edhe vetë trupat vetërregullues theksojnë se kanë pak parashtresa për shkelje të rregullave etike në raportimin mediatik. Gjithashtu, theksohet se pak media i moderojnë komentet në postimet e tyre në rrjetet sociale, ndërsa për gjuhën e urrejtjes organizatat theksojnë se duhet të ketë një përgjigje më të konsoliduar dhe më të koordinuar nga institucionet.

Publikimi është pjesë e aktiviteteve të Institutit për Media dhe Analitikë IMA, të mbështetura nga Fondi Evropian për Demokraci (European Endowment for Democracy) nga Brukseli, dhe është kontribut në realizimin e angazhimeve të IMA-s për promovimin e lirisë së medias, ballafaqimin me dezinformatat dhe gjuhën e urrejtjes, zhvillimin e mendimit dhe debatit kritik, si dhe kërkimin e zgjidhjeve për të adresuar këto sfida të rëndësishme.

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

1. DEZINFORMATA, TEORI TË KONSPIRACIONIT DHE MANIPULIME MEDIATIKE PËR NDRYSHIMET E PROPOZUARA KUSHTETUESE

Shkruan: ZHARKO TRAJANOSKI

Kushti që e mori Maqedonia e Veriut për vazhdimin e negociatave me BE-në (ndryshim i Kushtetutës, për çka kërkohet shumicë prej dy të tretave), u ka mundësuar aktorëve të ndryshëm politikë të zhvillojnë dhe të përhapin mediatikisht narrativë për kontestimin e ndryshimeve kushtetuese dhe për minimin e besimit në institucionet dhe autoritetet. Narrativët dezinformuese dhe manipulimet që u njohën gjatë debatit publik për "propozimin francez" në vitin 2022, vazhduan edhe në vitin 2023 në media dhe në komunikimin publik lidhur me ndryshimet kushtetuese. Disa nga këto narrativë u përdorën me sukses në fushatat publike kundër Marrëveshjes së Prespës, referendumit dhe ndryshimeve kushtetuese në vitin 2018 dhe 2019, qëllimi i të cilave ishte pengimi i anëtarësimit të plotfuqishëm të Maqedonisë së Veriut në NATO. Qëllimi i fushatave me dezinformata, teorive të konspiracionit dhe manipulimeve mediatike për ndryshimet e propozuara kushtetuese është të pengojnë vazhdimin e negociatave të filluara me BE-në.

Duke analizuar shembuj të shumtë mediatik, të cilët përmbajnë dezinformata, teori të konspiracionit dhe manipulime mediatike, arritëm të zbulojmë disa narrativë kryesore: narrativët e "gjenocidit dhe etnocidit" kundër popullit maqedonas; narrativët për "bullgarizim"; narrativët dezinformues në lidhje me gjuhën maqedonase; narrativët dezinformuese për fillimin, hapjen dhe vazhdimin e negociatave me BE-në; si dhe narrativët historik me dezinformata dhe teori konspirative, të cilat ishin pjesë e pashmangshme e komunikimit mediatik dhe publik edhe për ndryshimet kushtetuese.

"Debati" për amendamentet kushtetuese gjithashtu i mundësoi propagandës (pro) ruse të forcojë ndikimin e narrativëve antiperëndimor dhe anti-BE në hapësirën mediatike maqedonase.

Pothuajse të njëjtat rrjete propagandistike, kanale të komunikimit dhe narrativë dezinformues për rrezikimin e identitetit, gjuhës dhe popullit maqedonas, të përdorura në vitin 2018 gjatë Marrëveshjes së Prespës dhe referendumit, kanë qenë aktive edhe në vitin 2022 (në lidhje me "propozimin francez"), si dhe në vitin 2023 (në lidhje me ndryshimet kushtetuese).

Emërues i përbashkët i të gjitha këtyre narrativëve propagandistik është se ato dërgojnë mesazhe të frikësuese dhe kërcënuese të drejtuar kryesisht ndaj maqedonasve etnikë - mesazhe se ndryshimet e propozuara kushtetuese kërcënojnë mbijetesën e maqedonasve dhe popullit maqedonas, se kërcënojnë gjuhën maqedonase, identitetin maqedonas, historinë maqedonase, si dhe mbijetesën e shtetit. Fushata të tilla me narrativë propagandistik forcojnë frikën, mosbesimin dhe ndezin pasionet etno-nacionaliste jo vetëm te maqedonasit etnikë, por edhe te pjesët e tjera të popujve në Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë në Ballkan.

Në pjesën e parë të kësaj analize, do të shohim se si dezinformatat e vjetra dhe teoritë e konspiracionit për "gjenocidin" dhe "etnocidin" e popullit maqedonas u ringjallën në mënyrë propagandistike në kontekst të ndryshimeve të propozuara kushtetuese në vitin 2023, si kusht për vazhdimin e negociatave me BE-në.

1) Narrativet për ndryshimet kushtetuese: Ringjallja e dezinformatave të vjetra dhe teorive konspirative për "gjenocid" dhe "etnocid" të popullit maqedonas

Narrativët dezinformues dhe teoritë e konspiracionit për "asgjësimin", "zhdukjen", "shkatërrimin", "shpërbërjen", "etnocidin" dhe "gjenocidin" (mbi identitetin) e popullit maqedonas nuk janë diçka e re në hapësirën mediatike maqedonase. Teori të tilla konspirative janë shpërndarë periodikisht në kontekste politike të krizës nga aktorë të ndryshëm.

Në pjesën e parë, do të ilustrojmë ngjashmërinë dhe vazhdimësinë e narrativëve dezinformues dhe teorive konspirative për "asgjësimin", "zhdukjen", "shkatërrimin" ose "shpërbërjen", "etnocidin" dhe "gjenocidin" mbi popullit maqedonas pas nënshkrimit dhe zbatimit të "Marrëveshjes së Prespës" (2018), pas miratimit të të ashtuquajturit "propozim francez" (2022), dhe në procesin në vazhdim të ndryshimeve kushtetuese në vitin 2023.

Do të tregojmë shembuj të shumtë mediatike se si termat juridikë "gjenocid" dhe "etnocid" u keqpërdorën për mobilizim etno-nacionalist dhe politik edhe në kontekst të debateve për ndryshimet kushtetuese (në mënyrë të ngjashme siç u keqpërdorën në kontekst të "Marrëveshjes së Prespës" dhe "propozimit francez").

1.1. Dezinformata dhe teori konspirative për asgjësim dhe "gjenocid ndaj popullit maqedonas" para dhe pas "Marrëveshjes së Prespës"

"Kontesti për emrin" me Greqinë u përdor maksimalisht për mobilizim etno-nacionalist dhe politik (sidomos pas "vetos greke" në vitin 2008) duke abuzuar termat juridikë "gjenocid" dhe "etnocid". Organizatat radikale nacionaliste, si Kongresi Botëror Maqedonas, që atëherë bënë akuza për "gjenocid kundër popullit maqedonas" me një ndryshim të mundshëm të "emrit shtetëror Maqedoni".[1] Propaganda pro-qeveritare më pas frikësonte popullatën me "shkatërrim të popullit maqedonas" dhe "etnocid" nëse opozita do të vinte në pushtet.[2] Narrativat e frikshme antiperëndimore për "shkatërrimin e plotë të popullit dhe shtetit maqedonas" dhe akuzat e pabaza për "gjenocid" u propaganduan edhe gjatë krizës politike 2015-2017.

Prandaj, nuk është aspak e habitshme që narrativet e "gjenocidit" janë ringjallur pas shpalljes së një zgjidhjeje përfundimtare të "kontestit për emrin" me Greqinë në qershor 2018. Pak ditë para nënshkrimit të "Marrëveshjes së Prespës", ka reaguar publikisht grupi i intelektualëve pro-rus "Manifesti maqedonas", i cili prej vitesh bën fushatë "JO në BE"[3], dhe paralajmëronte për një „holokaust mbi Maqedonasit", për „planin për likuidimin e identitetit tonë" dhe „gjenocidin e planifikuar të identitetit" (në fund të vitit 2017, kryeministrit i qeverisë së re, Zoran Zaev, i dërgoi edhe një letër me mesazhin „Do të jeni

përgjegjës për gjenocidin (etnocidin) mbi popullin e juaj"). "Manifesti Maqedonas" në qershor 2018 akuzoi në mënyrë eksplicite kryeministrin se është "vrasës i identitetit të Maqedonisë dhe Maqedonasve" dhe se ka kryer "gjenocid ndaj popullit të vet".[4] Shkrimtari dhe kolumnisti i rregullt i "Nova Makedonija", z. Eftim Kletnikov, akuzonte edhe për "gjenocid identitar" ("po bëhet varrosja e identitetit të një kombi")[5], edhe për "gjenocidin e popullit maqedonas".[6] Në paraqitjet në media, Kletnikov bëri krahasime të pabaza «biblike» midis maqedonasve dhe hebrenjve,[7] ndërsa në një rubrikë të mëvonshme, ai e përshkroi "gjenocidin perëndimor identitar kundër maqedonasve në Prespë 2018» si «shkatërrim i një populli të lashtë me një gjenezë të thellë disa mijëvjeçare, nga Jafeti, djali më i vogël i Noeut, pas përmbytjes e në vazhdim...».[8]

Narrativi dezinformues dhe nxitës për «gjenocid» u pranua edhe nga partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE, e cila në konferenca për shtyp fajësonte për «gjenocidin e turpshëm»[9], dhe pohonte në mënyrë dramatike se "kjo e ashtuquajtur marrëveshje është një akt i pastrimit të një kombi të tërë, kjo është më e keqe se gjenocidi, se është gjenocid kundër një kombi të tërë - pra është etnocid".[10] Narrativi nxitës për "gjenocid" u pasua me dezinformim në lidhje me "Marrëveshjen e Prespës" (se "emri Maqedoni do të fshihet nga Kushtetuta", se "çdo përdorim i mbiemrit maqedonas, maqedonase, maqedonisht është i ndaluar plotësisht, në të gjitha format dhe nga gjitha institucionet që kanë botime dhe që marrin para nga shteti") dhe me insinuata për ndalimin e himnit.[11]

Narrativët dezinformues për „gjenocidin modern" dhe "gjenocidin etnik të popullit Maqedonas dhe fshirjen e gjithçkaje maqedonase"[12] u përforcuan në fushatën «Bojkotoj» (Bojkotiram) përpara Referendumit të vitit 2018. Kjo fushatë ishte mjaft aktive dhe virale në rrjetet sociale[13] me hashtagjet "#Bojkotoj" (Bojkotiram) amendamentet në Kushtetutë për të shlyer Maqedoninë dhe popullin maqedonas nga ekzistenca!" dhe „#Bojkotoj #Gjenocid" (Bojkotiram Genocid).[14]

Pasi më 30 korrik 2018, Kuvendi mori vendim për shpalljen e referendumit konsultativ, mbi 30 parti dhe shoqata pro-ruse apeluan për "mospjesëmarrje dhe bojkotim të referendumit, që është një projekt gjenocidal ndaj popullit maqedonas".[15] Si udhëheqëse e kampit "Maqedonia bojkoton" ishte partia proruse "Maqedonia e Vetme" (e riemërtuar sipas kallëpit të "Rusia e Vetme" e Putinit), e cila qysh në fillim të vitit 2018 propozoi që autostrada për në Greqi të quhej "gjenocid", në vend se "Miqësi".[16] "Maqedonia e Vetme" bëri thirrje për „luftë të shenjtë të të gjithë neve për mbijetesën e një populli të tërë", akuzoi NATO-n si një "organizatë gjenocidale", dhe mbrojti një aleancë strategjike me Rusinë që "siguron mbijetesën dhe të ardhmen e Maqedonisë", e cila kërcënohej nga "gjenocidi që ata duan ta bëjnë mbi popullin maqedonas".[17] Gjeopolitikët pro-rusë gjithashtu u përpoqën t'i paraqesin ndryshimet kushtetuese si proces gjenocidi ("operacioni gjenocid live"), ndërsa "riemërtimi dhe fshirja e Maqedonisë" si „veprim kundër Zotit" që ndihmon "Djallin të krijojë një mbretëri kundër Zotit".[18]

Edhe përfaqësues të maqedonasve në vendet fqinje[19] dhe të diasporës (në periudha të ndryshme) akuzuan për gjenocid ndaj popullit maqedonas, „gjenocid i identitetit, historisë dhe kulturës së popullit Maqedonas", „gjenocid kulturor dhe antropologjik", „gjenocid mbi një kulturë", etj.



Poster nga fushata për bojkot të Referendumit në vitin 2018, burim: FB faqja VMRO

Edhe pse tabori #Bojkotoj ishte një grup heterogjen, disa nga zëdhënësit e bojkotit ishin shumë të afërt me lidershipin e partisë më të madhe opozitare VMRO-DPMNE. Për shembull, kryetarja e Komisionit për Sistemin Politik të VMRO-DPMNE-së, Tanja Karakamisheva, e cila ishte e ulur pranë Mickoskit në takimin e liderëve për referendumin, në ditën e referendumit agjitoi "NUK VOTOJ dhe nuk përgjigjem në pyetje gjenocidale", ndërsa më vonë avokoi publikisht për hyrje në Bashkimin Euroaziatik, sepse "është e ardhmja e botës". Edhe anëtarët e udhëheqësisë të VMRO-DPMNE-së bënë fushatë se në referendum «do të votohet për Maqedoninë e Veriut, për krijimin e një kombi të ri artificial, për shkatërrimin e popullit maqedonas".[20] Edhe revista partiake e veteranëve të VMRO-DPMNE-së, "Kombi Maqedonas" e shpalli referendumin "gjenocid", duke pretenduar se me pranimin e ndryshimit të emrit Maqedonasit "do të zhduken nga skena historike".[21]

Presioni publik ndaj VMRO-DPMNE-së për të bërë thirrje për bojkot të referendumit u drejtua edhe nga dinjitari i Kishës Ortodokse Maqedonase (KOM), Mitropoliti Agatangel, i cili beson se "gjenocid i planifikuar, i vazhdueshëm dhe i hapur ndaj popullit maqedonas është kryer në njëqind vitet e fundit", dhe se firmosja e marrëveshjes me qeverinë greke është një "gjenocid subtil i një populli". Agatangel i dërgoi një mesazh eksplicit Mickoskit - "thirrni për bojkot të referendumit të manipuluar që po përgatitet për ne në për të shuar Maqedoninë dhe popullin maqedonas një të ardhme të afërt". [22] Në vitin 2019, Agatangel përdori madje vizitën e Papës në Shkup për të përsëritur akuzat për "gjenocid të heshtur dhe special kundër popullit maqedonas".[23]

Dezinformata për "ndërrimin e emrit të popullit maqedonas" si "holokaust kulturor" u përhap edhe në "Tubimin qendror të Bojkotoj "Bojkotoj Verioren, gjithmonë Maqedoni!" - Shkup". Organizatorët "Të Rinjtë për Maqedoninë" (të cilët mburren si nismëtarë të lëvizjes "Bojkotoj" dhe në platformën e tyre hedhin posht "Marrëveshjen

gjenocidale të Prespës ") bënë krahasime të pabaza midis maqedonasve, hebrenjve dhe mohikanëve, duke përhapur teori konspirative se mbijetesa e maqedonasve si popull ishte e kërcënuar.[24]

VMRO-DPMNE edhe pas referendumit vazhdoi diskursin për "etnocid të popullit Maqedonas", për "fshirjen e identitetit maqedonas",[25] kurse kuadrot e saja drejtuese deklaronin publikisht se "një kolaps ekonomik, etnocid dhe gjenocid ndaj popullatës maqedonase ka ndodhur dhe po ndodh ende...".[26]

Ashtu siç fushatat pro-ruse të viteve 2015-2017 nxisnin frikën nga kantonizimi, federalizimi, ndarjet e vendit dhe shpërbërjes së tij, fushatat e vitit 2018 krijuan një botëkuptim të perceptimeve se Marrëveshja e Prespës dhe referendumi çojnë në "vetëshkatërrim". vetëvrasje, "vetëmohim", "zhdukje", "shfarosje", "etnocid", "gjenocid të popullit maqedonas" etj. Narrativë të tillë dezinformues, nxitës dhe polarizues, të cilët përfshinin kërcënime imagjinare jo vetëm ndaj identitetit maqedonas, por edhe ndaj popullit maqedonas, sipas ekspertëve për dezinformim të BE-së, ishin thelbësore për «minimin e pjesëmarrjes në referendumin për ndryshimin e emrit».[27]

1.2. Presidenti i shtetit Ivanov gjithashtu përhapte dezinformata dhe teori konspirative për "anulimin ligjor" dhe "anulimin juridik dhe historik të popullit maqedonas"

Ndonëse para referendumit u përhap në media se presidenti Ivanov në fjalimin e tij në OKB do ta ekspozonte "Marrëveshjen e Prespës" si "përpjekje për gjenocid ndaj popullit maqedonas",[28] Ivanov në fjalimin e tij theksoi vetëm "vetëcensurimin e vetëdijes kolektive të popullit maqedonas" dhe "anulimin juridik të popullit maqedonas".[29]

Pasi në fund të vitit 2018 "Manifesti Maqedonas" kërkoi nga Ivanovi që të fillojë një procedurë në OKB për mbrojtjen e emrit, duke pretenduar se "po bëhet gjenocid identitar ndaj popullit maqedonas",[30] në fjalimin e tij vjetor në Kuvend, Ivanov paralajmëroi për "anulim juridik dhe historik të popullit maqedonas".[31] Narrativët e "asgjësimit të popullit maqedonas" u propaganduan edhe nga partitë pro-ruse, nga të sapoformuarit „Rodina" (e cila fliste edhe për "gjenocidin identitar ndaj popullit maqedonas"), edhe nga "Maqedonia Unike"(Edinstvena Makedonija) e cila më vonë në një letër drejtuar Makronit përshëndeti moscaktimin e një date për negociata, duke iu referuar "anulimit kombëtar të popullit maqedonas nga qeveria kukull në Shkup".[32]

Sa i përket kërkesës së "Manifestit Maqedonas" drejtuar Ivanovit, zëdhënësi Eftim Kletnikov, në një intervistë të vitit 2020, do të pretendojë se "ne jemi një komb i vrarë" dhe se Rusia këmbënguli që çështja e emrit të kthehet në OKB. Sipas Kletnikovit, Gjorge Ivanov nuk e ka bërë një gjë të tillë, ndonëse për një nismë të tillë janë mbledhur nënshkrimet e qytetarëve, pas së cilës zëdhënësi i "Manifestit Maqedonas" e ka akuzuar për "tradhti të lartë".[33]

"Manifesti Maqedonas" i dërgoi edhe një letër Putinit në fund të vitit 2021, në të cilën përsëriteshin akuzat për "gjenocid identitar", duke shpjeguar se "qëllimi me likuidimin e kujtesës së maqedonasve" ishte "të likuidohej vetëdija e tyre gjenerike për vëllazërinë me sllavët", dhe veçanërisht me Rusinë dhe rusët, të dashurisë së tyre për ta." Në letrën e nënshkruar nga disa intelektualë dhe nga Mitropoliti i mitropolisë së Vardarit, Agatangel i KOM-AO, theksohet "farefisnia e gjakut mes maqedonasve dhe rusëve", dhe "lidhja e tyre binjake siameze".[34]

1.3. Dezinformata dhe teori konspirative për "asgjësim" dhe "gjenocid kundër popullit maqedonas" pas "propozimit francez"

Narrativët me dezinformata, manipulime, frikësime dhe teori të konspiracionit për popullin maqedonas dhe maqedonasit ishin një pjesë qendrore e fushatës së opozitës kundër "propozimit francez" dhe kornizës negociuese në verën e vitit 2022.

Partitë dhe politikanët më radikalë të opozitës pro-ruse theksuan "kushtet bullgare për fshirjen e kombit maqedonas" (Maqedonia Unike), duke dramatizuar se "koka e popullit maqedonas i pritet në protokoll» (Jakimovski nga GROM), ndërsa "E Majta" (Levica) pro-ruse solli një gijotinë me përshkrimin "propozimi francez" në një nga protestat. Mesazhi "Propozimi francez është gijotinë për popullin maqedonas!" u promovua edhe nga kandidatja për Kryetare të komunës Qendër nga VMRO-DPMNE dhe "Zëri për Maqedoninë".[35]

Propagandistja pro-ruse Mirka Velinovska, e cila pas 27 prillit 2017 pretendonte se "kundër maqedonasve nga pjesa e qytetëruar e botës po ushtrohet gjenocid i inskenuar",[36] si e ftuar në kanalin pro-rus "Biseda të Rodinës", dhe i akuzoi "evropianët e pacivilizuar" se po përpiqen të kryejnë gjenocid dhe të shpallin "një popull të gjallë të vdekur".

Dezinformatat që me të ashtuquajturin "propozim francez" po kryhet "etnocid, kulturocid", dhe madje "gjenocid kundër një populli të tërë" ishin një shenjë dalluese e fushatës së opozitës kundër kornizës negociuese të BE-së.[37] Pasi që kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, publikisht e akuzoi kryeministrin Dimitar Kovaçevski për "gjenocid ekonomik"[38] dhe se "asgjëson identitetin maqedonas",[39] deputetet e VMRO-DPMNE-së në Kuvend përhapën dezinformata se "me propozimin francez po shohim një gjenocid të tmerrshëm",[40] dhe teoritë konspirative se "propozimi francez" do të bënte "gjenocid kundër popullit maqedonas"[41] dhe se do t'i kishim bërë „etnocid" vetvetes.

Zëdhënësit intelektualë kundër "propozimit francez" gjithashtu ngritën panik publik për "gjenocid dhe etnocid".[42] Ish-nënkryetari i qeverisë së udhëhequr nga VMRO-DPMNE përgjegjës për integrimet evropiane, Ivica Bocevski, gjatë një paraqitjeje si i ftuar në TV Alfa, grisi "propozimin francez" dhe më vonë dezinformoi në një kolumnë se hyrja në BE "duhet paguar duke anuluar gjithçka që është maqedonase dhe duke i fshirë maqedonasit nga rrethi i kombeve dhe nga shoqëria e etnive"."[43]

1.4. Abuzimi i ASHAM për përhapjen e dezinformatave dhe teorive konspirative

Një nga gjeneruesit kryesorë të dezinformatave dhe teorive konspirative për "Marrëveshjen e Prespës" dhe "propozimin francez" është kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM), Lupço Kocarev, i cili pretendonte se "...me propozimin francez, Qeveria e Maqedonisë do të dëshmojë se në shtetin e Maqedonisë, brenda kufijve të Maqedonisë së sotme, nuk ka maqedonas"."[44] Kryetari i ASHAM Kocarev në një nga kolumnat e tij dezinformoi se "maqedonasit qysh sot nuk ekzistojnë", duke nxjerrë një përfundim të gabuar nga një dokument i regjistrimit në fakultet.[45]

Gjatë fushatës kundër "propozimit francez" në vitin 2022, Kocarev bëri akuza të pabaza për "gjenocid të maqedonasve në Egje dhe në Pirin", gjoja i kryer nga marrëveshjet me Greqinë dhe Bullgarinë, dhe përhapi teori konspirative se "maqedonasit do të zhduken", dhe se nuk kane për të hyrë në BE.[46]

Lupço Kocarev vazhdoi të abuzonte me ASHAM dhe pozitën e tij si president edhe në ditën e ASHAM-it në tetor të vitit 2022, duke përhapur dezinformata dhe akuza të pabaza se "po bëhet gjenocid kulturor ndaj maqedonasve në vendin e tyre" dhe kudo që ata jetojnë.[47] Ivica Bocevski, në kolumnën propagandistike ku e promovon Kocarevin si president të vetëm të Maqedonisë, e cilëson atë si pjesë të "inteligjencës maqedonase kundër gjenocidit kulturor kundër popullit maqedonas dhe përpjekjeve për fshirjen e shtetësisë maqedonase".[48] Si kryetar i ASHAM-it, Kocarev vazhdoi të përhapte dezinformata dhe analogji të pabaza se maqedonasit ishin në prag të zhdukjes si rrëqebulli i Ballkanit.[49]

Mund të thuhet se në shkurt të vitit 2023, ishte Kocarev ai që filloi fushatën kundër ndryshimeve kushtetuese në asamblenë vjetore të ASHAM-it, kur dezinformoi se më 17 qershor 2018 "populli maqedonas është zhdukur plotësisht nga skena ndërkombëtare."[50] Në të njëjtën kohë, Kocarev pretendoi se marrëveshjet me Greqinë dhe Bullgarinë "përfaqësojnë gjenocid kulturor të maqedonasve", dhe sugjeroi se "në kujtesën kolektive të popullit maqedonas, ato të emërtohen me shprehjen "holokaust maqedonas"" dhe se "institucionet kompetente në Maqedoni duhet propozuar një ditë përkujtimore për shënimin e holokaustit maqedonas".[51] Pavarësisht kritikave për anti-shkencë[52] dhe për "gëndrime anti-bullgare", Kocarev vazhdoi të përdorte shprehjen "holokausti maqedonas në të cilin u gjend sot populli maqedonas" edhe gjatë përkujtimit në Paris për një paraardhës të tij, gjatë të cilit përhapte mitin etno-nacionalist për një "tradite mijëvjeçare" të "emrit maqedonas, gjuhës maqedonase, kulturës maqedonase, identitetit maqedonas, historisë maqedonase".[53] Edhe pse shprehja "holokausti maqedonas" nuk është e re në literaturën etno-nacionaliste maqedonase, ringjallja e saj në kontekstin e "Marrëveshjes së Prespës, Platformës së Tiranës dhe Marrëveshjes me Bullgarinë" është vepër e putinistit Eftim Kletnikov, në funksion propagandistik të satanizimit[54] dhe nazifikimit të Perëndimit.[55]

Kocarev vazhdoi fushatën kundër ndryshimit të Kushtetutës duke përhapur teori konspirative tashmë të njohura për zhdukjen e maqedonasve në BE. Në një intervistë, Kocarev skicoi si skenar të parë mundësinë që Maqedonia të bëhet anëtare e plotë e BE-së në njëzet vitet e ardhshme, por "në të njëjtën kohë, maqedonasit tashmë janë zhdukur plotësisht dhe nuk ekzistojnë". Sipas Kocarev, me pranimin e kërkesave bullgare dhe greke gjatë negociatave me BE-në, "identiteti maqedonas, Maqedonia dhe maqedonasit gradualisht do të zhduken sikur të mos ekzistonin kurrë".[56]

Kocarev vazhdoi me akuzat për "gjenocid kulturor"[57] edhe në kontekst të ndryshimeve kushtetuese, duke akuzuar se po kryhet "gjenocid kulturor" nga "të gjitha dokumentet" në të cilat maqedonasve u kërkohet "të heqin dorë nga maqedonizmi".[58] Kundër përpjekjeve për të relativizuar konceptin e identitetit (që, sipas Kocarev, u bënë "me të vetmin qëllim për shkatërrimin, asgjësimin dhe poshtërimin e popullit maqedonas, identitetit dhe gjuhës së tij"), kryetari i ASHAM-it në rubrikat e tij rregullisht propagandon mitet etno-nacionaliste për "vazhdimësi mijëvjeçare të gjuhës maqedonase, identitetit maqedonas dhe popullit maqedonas".

1.5. Dezinformata dhe teori të konspiracionit për «asgjësimin», «etnocidin» dhe «gjenocidin ndaj popullit maqedonas» në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese

Në pritje të procesit të ndryshimeve kushtetuese, propaganduesit pro-rus të "Manifestit Maqedonas" vazhduan me fushatën kundër "gjenocidit identitar" dhe "likuidimit identitar të popullit maqedonas", i cili duhej të përfundonte me "fshirjen e emrit KOM – AO"[59] Në fillim të vitit 2023, në një paraqitje si i ftuar në TV Alfa, Kletnikov akuzoi se partia në pushtet me "kapacitet nazifashist" "likuidoi identitetin, thjeshtë e theri, preu kokën e identitetit kolektiv" të popullit maqedonas, ndërsa Perëndimi kishte një plan për "bullgarizimin" e maqedonasve, "të mos ketë fare maqedonas".

"Manifesti Maqedonas" gjithashtu themeloi një "gjykatë morale" në maj të vitit 2023, dhe avokatët dhe prokurorët e saj dënuan publikisht "gjenocidin identitar të maqedonasve",[60] mes tjerash edhe për „... për maqedonasit, propozim-kornizën gjenocide për një marrëveshje me Bullgarinë nga Emanuel Makron...". Zëdhënësi Eftim Kletnikov, i cili avokonte krijimin e një gjykate morale që në vitin 2019,[61] me rastin e 15 vjetorit të "Manifestit Maqedonas", kujtoi se "manifesti ishte i pari që foli dhe paralajmëroi për rrezikun e gjenocidit identitar", të „ideuar nga Brukseli dhe Uashingtoni". Kletnikov akuzoi në televizionin kombëtar TV Alfa „qeverinë gjenocidale" për „gjenocidin në Maqedoni", ndërsa në "Letër e hapur për Emanuel Makron", e akuzoi atë së është i përfshirë në «gjenocidin e identitetit tash mbi maqedonasit nga Evropa e Brukselit". Si vazhdimësi e fushatës kundër ndryshimeve kushtetuese, Kletnikov përhapte teori të konspiracionit morbide se "ne jemi hebrenjtë e rinj (të Rajhut të Tretë) dhe indianët e këtij qytetërimi" që u "zgjodhën për shkatërrim", duke përfunduar - "BRIKS shumë më i mirë se BE-ja që na vret identitetin". Edhe një nga anëtarët pro-rus të "Manifestit Maqedonas" në kolumnat e tij bënte insinuata se SHBA, BE dhe NATO ishin të mërzitur që nuk mund të kryenin gjenocid fizik dhe propagandonte se "BE është një qorrsokak" dhe se "alternativa e vetme është BRIKS".[62] Madje, "Manifesti maqedonas" i dha mbështetje publike protestës kundër minierës së Illovicës, me sloganin "Ndalesë për shkatërrimin e Maqedonisë dhe maqedonasve", duke pretenduar se edhe ajo minierë është "pjesë e planit për gjenocid identitar që kjo qeveri antipopullore po e zbaton me vetëdije apo pa vetëdije prej kohësh".

Edhe gazeta "Nova Makedonija" në vitin 2023 vazhdoi fushatën kundër "politikës agresive dhe etnocidale të Sofjes ndaj popullit maqedonas", kundër "politikave jashtëzakonisht gjenocidale dhe etnocidale të një shteti anëtar të BE-së". "Nova Makedonija" në analizat e saj e forcoi narrativin për "kulturocid ose etnocid", duke shpallur Marrëveshjen me Bullgarinë për "etnocide ose kulturocide", dhe duke akuzuar Evropën si "bashkëpunëtor në politikat gjenocidale dhe etnocidale të dy vendeve fqinje".

Në Ditën e pavarësisë, "Nova Makedonija" publikoi një intervistë me kryetarin e Kongresit Botëror Maqedonas (KBM), Todor Petrov, në të cilën ai akuzoi se "një qeveri kukull ka kryer gjenocid ndaj popullit maqedonas në vendin e vet Maqedoninë" dhe se "Maqedonia është nën regjimin e fashizmit. Maqedonasit janë nën regjimin e gjenocidit!".[63] Paraprakisht, në kolumnë në "Nova Makedonija" Todor Petrovi akuzonte për "tradhti të lartë, gjenocid ndaj popullit maqedonas dhe krim kundër njerëzimit, i cili nuk vjetrohet", duke sugjeruar dënimin me vdekje për një krim të tillë.[64]

Po edhe partitë pro-ruse, si "E Majta" (Levica), akuzuan për "gjenocid identitar të maqedonasve që po bëhet përmes amendamenteve në kushtetutë" ose "gjenocid identitar të kombit maqedonas". Partia pro-ruse "Rodina" ishte pjesë e fushatës anti-perëndimore kundër "ideologjisë gjinore",[65] dhe në ballë të

protestës së KOM me thirrjen "Të dalim sa më shumë dhe të tregojmë fuqishëm se gjenocidi dhe etnocidi kulturor nuk do të kalojë". Në emisionin "e jashtëzakonshëm" partiak, "Barazia gjinore ose rrezikimi i gjithçkaje maqedonase: Gjinia, Populli, Shoqëria", një anëtar i kryesisë së "Rodina" Maqedoni akuzoi se Përëndimi dëshironte të vriste jo vetëm familjen si qeli, por edhe "duan të vrasë organizmin maqedonas dhe Maqedoninë në tërësi". Në anën tjetër doli partia pro-ruse "Maqedonia e Unike" me "nismë për kyçjen e rusëve, bjellorusëve, ukrainasve, çekëve, sllovakëve, polakëve dhe sllovenëve në Kushtetutën e Maqedonisë", me arsyetim "shkencor" se "Maqedonia është Nëna e të gjithë popujve sllavë që u larguan nga Maqedonia" dhe se bëhet fjalë për popuj "të cilët e kanë themelin në popullin maqedonas".

Kryetari i partisë pro-ruse GROM Stevço Jakimovski, si i ftuar në TV24 përhapte teori konspirative se qëllimi i disa fqinjëve ishte që maqedonasit të mos ekzistojnë në Kushtetutë: "Qëllimi i të gjithë tyre, si bullgarëve, ashtu edhe atyre nga Shqipëria dhe grekët, është që maqedonasit të mos ekzistojnë në Kushtetutën maqedonase, që ky duhet të jetë një shtet qytetar dhe që maqedonasit të mos jenë më, ky është qëllimi i të gjithëve rreth nesh". Emisionet e debatit në televizion kombëtar shpërndaheshin dezinformata se me ndryshimet e shpallura në kushtetutë nuk do të ketë komb maqedonas dhe se me përfshirjen e Bullgarëve në Kushtetutë do të jenë tre kombe përbërëse - "Shqiptarët, Bullgarët dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut".[66]

Shkurtimisht, dezinformatat dhe teoritë e konspiracionit për "gjenocidin dhe etnocidin kundër popullit maqedonas" vazhduan të përhapen në vitin 2023 - kryesisht nga politikanë pro-rusë, analistë, figura publike, intelektualë, kolumnistë, si dhe nga shoqatat etno-nacionaliste të qytetarëve në ngjarjet kulturore. Për shembull, në ftesën për festivalin e koreve patriotike "Maqedonia 2023" organizuar nga Shoqata e qytetarëve "Makedon" për 2 gusht 2023, përmendet se "gjenocidi dhe etnocidi antiqytetërues ndaj popullit Maqedonas" është duke u zbatuar dhe festivali legjitimohet si akt i mbrojtjes së identitetit maqedonas dhe nga tentativat për "shkatërrimin e Maqedonisë dhe popullit maqedonas".[67] Ky shembull poashtu tregon se si termat juridikë "gjenocid" dhe "etnocid" u keqpërdorën për mobilizimin etno-nacionalist në kontekstin e debateve për amendamentet e Kushtetutës.

Edhe pse keqpërdorimi i termave "gjenocid" dhe "etnocid" nuk ishte i dallueshëm në paraqitjet mediatike të përfaqësuesve të VMRO-DPMNE-së (si në vitin 2022 e më parë), edhe kjo parti vazhdoi me teoritë e konspiracionit dhe përhapjen e dezinformatave dhe manipulimeve mediatike lidhur me popullin maqedonas, identitetin maqedonas dhe shtetin maqedonas (që do të ndiqet në pjesët vijuese të kësaj analize të narrativëve kryesorë të dezinformimit në kontekstin e amendamenteve të Kushtetutës të vitit 2023).

2. Teori të konspiracionit për "bullgarizim" dhe dezinformata për gjuhën dhe historinë maqedonase në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese

Në pjesën e dytë të analizës do të shohim lidhjen mes teorive të konspiracionit për "bullgarizimin", dezinformatat për gjuhën maqedonase, dezinformatat dhe manipulimet mediatike për fillimin, hapjen dhe vazhdimin e negociatave me BE-në, dezinformatat historike dhe manipulimet, si dhe narrativët etno-nacionaliste, mitet dhe teoritë konspirative për "Bullgarinë e Madhe" dhe "Shqipërinë e Madhe" në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese. Do të shohim edhe rolin e mediave në përhapjen jokritike të dezinformatave, manipulimeve dhe teorive konspirative në lidhje me ndryshimet kushtetuese.

2.1.Teoritë konspirative për "bullgarizim" me ndryshimet kushtetuese

Narrativët dezinformues që përmbajnë teori konspirative për "bullgarizim" u propaganduan nga liderët e partisë kryesore opozitare VMRO-DPMNE në kontekstin e "propozimit francez" dhe hapjes së negociatave me BE-në.[68] Pasi Kuvendi miratoi konkluzionet për "propozimin francez", Mickoski akuzoi për "tradhti, plani i së cilës është asimilimi dhe bullgarizimi i popullit maqedonas".[69] Diskursi opozitar kundër "bullgarizimit" në kuadrin e "propozimit francez" u forcua dhe u radikalizua edhe nga politikanët pro-rus.[70]

Narrativët politikë të "bullgarizimit" u propaganduan edhe në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese në vitin 2023, nga një sërë aktorësh, por shumë më pak nga përfaqësues të VMRO-DPMNE-së. Këtë e kritikoi kryeministri Dimitar Kovaçevski, i cili publikisht tregoi se ka ndryshuar "retorika e VMRO-DPMNE-së se po bëhet bullgarizim, asimilim...".[71]

Kryeministri Kovaçevski kritikoi gjithashtu "histerinë për gjoja bullgarizim" të vitit të kaluar, e cila "nuk ekziston më në diskursin publik, përveç tek disa botë rusë të paguar...".[72]

Mirëpo, siç do të shohim, shprehja "bullgarizim" ishte dhe është pjesë përbërëse e diskursit mediatik dhe publik në kuadër të procesit të ndryshimeve kushtetuese, kthesës propagandistike, siç filluan ta ekspozojnë hapur ish-ministrat e VMRO-DPMNE-së mitin e "bullgarizimit".[73]

Për shembull, në maj të vitit 2023, emisioni "Detektor" në TV Sitel nxori në pah të dhënat nga një sondazh se "62% e maqedonasve besojnë se korniza e negociatave është një hyrje në bullgarizimin e Maqedonisë" (50.9% e të anketuarve).[74] e cila e keqinterpreton kornizën negociuese të BE-së si "kornizë negociuese me Bullgarinë". Emisioni 360 gradë gjithashtu në maj të vitit 2023 e aktualizoi çështjen e "bullgarizimit të Maqedonisë".[75]



Pjesë nga sondazhi i Institutit për Hulumtime Politike Shkup, i publikuar në emisionin "Detektor" në TV Sitel

Në pyetjen "a kërcënohet Maqedonia me bullgarizim", i ftuari në "Detektor" Ivica Bocevski i cilësoi qëndrimet bullgare si "bullgarizim përmes evropianizimit" dhe bëri një pretendim të paargumentuar se "...qëndrimi i përgjithshëm kornizë i qeverisë bullgare, dhe një deklaratë e Asamblesë popullore, përfshihen në kornizën negociuese". Në një paraqitje në emisionin "Vetëm e vërteta" në TV Kanal 5 në korrik të vitit 2023, Bocevski vazhdoi të pretendonte se "evropianizimi përmes bullgarizimit nuk do të zbatohet",[76] që është vazhdimësi e tezave të tij të mëparshme për Maqedoninë si "koloni bullgare" dhe për integrimet evropiane si "bullgarizim përmes evropianizimit".[77]

Teza e VMRO-DPMNE-së "nuk do të lejojmë bullgarizimin e Maqedonisë" ishte aktuale edhe në korrik të vitit 2023 në media, dëshmon themeluesi dhe presidenti i parë i VMRO-DPMNE-së Ljubço Georgievski, i cili në një intervistë për "Fokus" e dekonspiron këtë tezë, duke fajësuar "partinë më pro-serbe" aktuale për "serbizimin e Maqedonisë".[78] Më parë, edhe kreu i PDSH-së, Menduh Thaçi, ka akuzuar publikisht VMRO-DPMNE-në si një «parti pro-ruse dhe pro-serbe» dhe për «asimilim të popullit maqedonas».[79]

Fushatat politike kundër "bullgarizimit" vazhduan në kuadër të ndryshimeve kushtetuese.

Partia pro-ruse "E Majta", e cila në fillim të vitit 2023 organizoi protesta kundër bullgarizimit, filloi fushatën se "amendamentet kushtetuese janë kornizë ligjore për bullgarizimin e Maqedonisë".[80] Gjithashtu, "E majta" e diskreditoi marrëveshjen me Bullgarinë si fillim zyrtar i procesit të bullgarizimit të Maqedonisë.[81] "E majta" udhëhoqi një fushatë të zezë kundër "procesit të bullgarizimit të Maqedonisë me futjen e Bullgarëve në Kushtetutë" dhe diskreditoi anëtarët e grupit punues për propozimin – nismën për ndryshimin e Kushtetutës si "Ekipi i bullgarizimit".[82] Partia pro-ruse "E majta" përdori gjithashtu termin "bullgarizim" për të zhvilluar një fushatë anti-perëndimore kundër BE-së dhe SHBA-së.[83]

Kreu i partisë "E majta", Dimitar Apasiev, vazhdoi të flasë kundër "propozimit francez për bullgarizim".[84] të agjitojë "të ndalohet bullgarizimi, platforma e Sofjes" dhe ta shpallë si "një përpjekje të dështuar për të bullgarizuar Kushtetutën".[85] Edhe politikanë të tjerë pro-rusë, si nga partia "Zëri për Maqedoninë", propaganduan teori konspirative se "ndryshimet kushtetuese janë një rrugë drejt bullgarizimit tonë të plotë". Intelektualët me pikëpamje pro-ruse në vitin 2023 vazhduan gjithashtu të shkruanin kundër "propozimit të Makronit për "bullgarizimin" e Maqedonisë" dhe të akuzonin "bullgarizimin tonë si një komb imagjinar pa kujtesë historike".

Një tregues shtesë i rëndësisë së teorive të konspiracionit për "bullgarizimin" në kuadër të nismës për ndryshime kushtetuese janë përpjekjet e pushtetarëve për të diskreditуar dhe nxjerrë në pah publikisht tezat e "bullgarizimit". Për shembull, në një intervistë për MIA, kryeministri Kovaçevski i cilësoi tezat e "asimilimit dhe bullgarizimit" dhe "diktatit bullgar" si floskula dhe të pavërteta.[86] Ministri i punëve të jashtme Osmani, nga ana tjetër, hodhi poshtë publikisht tezën se me "përmendjen e bullgarëve si pakicë e veçantë në Kushtetutë, bëhet bullgarizimi i shtetit", duke sugjeruar që kjo bëhet "duke marrë pasaportat ku vetë deklaroni se jeni bullgar me origjinë".[87] Argumente të ngjashme se marrja e pasaportave bullgare do të thotë "bullgarizim", argumentonte publikisht edhe nënkryetari i LSDM-së, Stefan Bogoev,[88] i cili shpjegoi edhe tezën se "koncepti i hyrjes në BE është koncept i maqedonizmit" dhe " Koncepti i izolimit është koncept bullgarizimi dhe detyrimi i qytetarëve tanë në dëshpërim për të nxjerrë pasaportën bullgare".[89]

Kundrejt tezave të tilla, analisti pro-rus Risto Nikovski shpërndau dezinformata se me përfshirjen e Bullgarëve në Kushtetutë "do të pajtohemi vetë se nuk ekzistojmë si komb dhe se Sofja ka të drejtë kur e pretendon këtë".[90]

Edhe kundërfushata proqeveritare kundër tezave të "bullgarizimit" dëshmon për paargumentimin e deklaratave të kryeministrit Kovaçevski nga gushti i vitit 2023 se "bullgarizimi dhe asimilimi nuk përdoren si fjalë, sepse nuk ekzistojnë".[91] Siç shihet shprehja "bullgarizim" ishte pjesë e pandashme e fushatave dezinformuese kundër ndryshimeve kushtetuese, por edhe e kundërnarrativëve të kolumnistëve proqeveritar.[92]

Ndonëse VMRO-DPMNE nuk e përdori termin "bullgarizim" aq sa në fushatën kundër "propozimit francez" të vitit 2022, përfaqësuesit e partisë më të madhe opozitare vazhduan të bëjnë fushatë kundër ndryshimeve kushtetuese të paraqitura si "asimilim" dhe "diktat bullgar", si dhe "bullgarizim të heshtur të popullit maqedonas".[93] Për shembull, nënkryetari i VMRO-DPMNE-së, Vllado Misajllovski pretendoi se "ajo që kërkon Bullgaria është një lloj asimilimi ndaj popullit maqedonas", zëdhënësi i VMRO-DPMNE-së, Naum Stoillkovski ka paralajmëruar për "asimilimin e plotë të Maqedonisë dhe popullit maqedonas", Qeveria u akuzua për pranimin e "kushteve për integrimin evropian që nënkuptojnë ose negociata të përjetshme ose asimilim", dhe reagimet e partisë vunë në dukje "kurthin e Bullgarisë në të cilin ne ose do të negociojmë pafundësisht ose do të asimilohemi".

Pas propozimit të Mickoskit në mbledhjen e liderëve në qershor të vitit 2023 që ndryshimet e mundshme kushtetuese të vlejnë ditën kur fillon ratifikimi i protokollit të anëtarësimit të Maqedonisë në BE nga parlamentet e 27 vendeve anëtare", u bë e qartë për opinionin se VMRO-DPMNE nuk është kundër bullgarëve në Kushtetutë, siç nuk është kundër kroatëve në Kushtetutë.[94] Edhe pse më vonë në një konferencë për media (19.08.2023) Mickoski dërgoi mesazhe të pakompromis lidhur me ndryshimet

kushtetuese ("nuk ka çmim me të cilin do t'i pranonim këto amendamente kushtetuese nën diktatin bullgar"),[95] e në të njëjtën konferencë për shtyp, ai tregoi disa kushte për përfshirjen e bullgarëve në Kushtetutë si "pjesë e popullit bullgar që jeton në Maqedoni", të cilët "janë pjesë e kombit maqedonas".[96] Pikëpamjet e tilla u interpretuan si të kundërta me pikëpamjet e Mickoskit nga viti 2022 - "përderisa unë jam president, kushtetuta nuk do të ndryshohet për t'i bërë pjesë të saj kërkesat bullgare". Prandaj disa analistë konkluduan se "Mickoski nuk e kontestoi hyrjen e bullgarëve në Kushtetutë, por manipuloi me bullgarizimin, asimilimin dhe diktatin bullgar dhe faktin se qeveria nuk ka dy të tretat e shumicës për amendamentet kushtetuese".[97]

2.2. Narrativë dezinformues për gjuhën maqedonase në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese

Në vitin 2022, mediat maqedonase përhapën disa narrativë me dezinformata dhe manipulime mediatike për gjuhën maqedonase në kontekstin e "propozimit francez": se "gjuha maqedonase nuk është në propozim", se është riemërtuar, se "ka pasur vetëm një fusnotë se gjuha maqedonase është dialekt i bullgarishtes", se "vetëm për ne gjuha do të jetë maqedonase", madje edhe se qeveria aktuale e ka riemërtuar gjuhën maqedonase në "gjuhë amtare".[98] Në vitin 2022, lideri i opozitës Mickoski pretendonte se deputetët e VMRO-DPMNE-së ishin "mbrojtësit e gjuhës dhe identitetit maqedonas dhe nuk do të lejojnë ndryshime në Kushtetutë".

Më 18.10.2022, në një paraqitje si i ftuar në Kanalin e Parë të shërbimit publik, lideri i VMRO-DPMNE-së, Mickoski gabimisht pretendoi se gjuha maqedonase në BE gjithmonë do të ketë fusnotë. Por pas nënshkrimit të marrëveshjes së Frontex mes BE-së dhe Maqedonisë së Veriut më 26.10.2022, Ursula fon der Lejen deklaroi qartë se nuk ka asnjë fusnotë: "...Ju kam premtuar se marrëveshja Frontex do të nënshkruhet, e përkthyer në gjuhën maqedonase, pa fusnotë, pa yll, në baza të barabarta me të 24 gjuhët e BE-së...", theksoi Fon der Lejen në konferencën për media në Qeverinë e Maqedonisë pas nënshkrimit të Marrëveshjes.[99]

Edhe pse Fon der Lejen deklaroi "Jam thellësisht e bindur se nuk do të presim shumë për të pasur 25 gjuhë zyrtare",[100], po edhe Borel theksoi se Marrëveshja me Frontex është "garanci për gjuhën maqedonase si një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian", dezinformatat dhe manipulimet për gjuhën maqedonase vazhduan edhe në vitin 2023, në lidhje me negociatat me BE-në. Për shembull, pretendimet e paverifikuara për një "fusnotë" për gjuhën maqedonase u publikuan përsëri në media[101] në kuadër të "Marrëveshjes me Frontex"· Ambasadori evropian Gir praktikisht i mohoi ato, duke theksuar se marrëveshja e ratifikuar së fundmi për statusin e Frontex-it është "nënshkruar dhe përkthyer në gjuhën maqedonase, pa fusnota dhe yllëza, në baza të barabarta me të 24 gjuhët e Bashkimit Evropian".[102] Edhe pse ambasadori evropian Gir publikisht theksoi se "gjuha maqedonase tashmë është në kuadër të negociatave pa asnjë kualifikim" [103], portali Mkd.mk zhvilloi një sondazh me pyetjen manipuluese "A do t'i përkrahnit amendamentet kushtetuese nëse BE-ja jep garanci të forta për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit maqedonas?".[104]

Në vitin 2023 vazhduan të publikohen dezinformata dhe manipulime për mosnjohjen e gjuhës maqedonase në BE, si dhe se gjuha maqedonase nuk ishte maqedonase jashtë Maqedonisë·[105] Për shembull, profesoresha Ellka Jaçeva-Ullçar pretendoi «Sot,

për ata në jug, gjuha maqedonase nuk ekziston, sepse dikush u pajtua që atje nuk ka njerëz që flasin maqedonisht",[106] përkundër lajmit nga viti 2022 se "Greqia ka regjistruar Qendrën e gjuhës maqedonase". Vetëm një muaj më vonë, Jaçeva-Ullçar do ta mohojë veten, duke pohuar se "me ekzistencën e Qendrës së gjuhës maqedonase, shteti grek praktikisht e legjitimon gjendjen reale se dialektet e Egjeut i përkasin gjuhës maqedonase".[107]

Edhe projektligji për gjuhën maqedonase ishte cak i dezinformatave dhe manipulimeve, si ajo se folësit e gjuhës shqipe në Maqedoni kishin në praktikë të drejta më të mëdha gjuhësore se sa folësit e maqedonishtes.[108] Gjithashtu u propagandua se çdo mohim i vazhdimësisë historike të gjuhës maqedonase është "maqedonofobi".[109]

E derisa në Kuvend vazhdonte debati për amendamentet kushtetuese të Komisionit për çështje kushtetuese, u përhapën dezinformata për gjoja "suspendimin e gjuhës maqedonase nga deklarimet" e produkteve të caktuara.[110] Nga foltorja e Kuvendit, lideri i "Të majtës" Apasiev pretendonte se "kemi një deklaratë të njëanshme për gjuhën maqedonase, të arkivuar zyrtarisht në arkivat evropiane, se gjuha maqedonase është DIALEKT BULLGARO-PERËNDIMOR", që është manipulim, sepse nuk ka në "deklaratën e njëanshme" të Bullgarisë një deklaratë me tezë të tillë eksplicite, e nuk përmendet as shprehja "bullgaro-perëndimor". Analistë të tjerë po ashtu manipuluan se "me referencën zyrtare të deklaratës bullgare se nuk ka gjuhë maqedonase, BE-ja hapi rrugën për mohimin e saj".[111]

Në artikullin "Sfidë e re për gjuhën maqedonase në BE" u publikua një pretendim i paargumentuar se "është ende treguese në mënyrë shqetësuese që përfaqësuesit evropianë i shmangen përmendjes së gjuhës maqedonase, edhe kur vijnë me një mision për të bindur që bullgarët të përfshihen në kushtetutën maqedonase". Megjithatë, përfaqësuesit kryesorë të BE-së, Fon der Lejen dhe Borell, jo vetëm që përmendën gjuhën maqedonase, por edhe shpallnin deklarata në gjuhën maqedonase, dhe treguan qartë se do të jetë një nga gjuhët zyrtare të BE-së.

Megjithatë, përkundër deklaratave të liderëve të lartë të BE-së, si dhe konkluzioneve të Këshillit të BE-së, ku thuhet se përkthimi i dokumenteve do të bëhet në gjuhën maqedonase, dhe përkundër faktit se skriningu është bërë në gjuhën maqedonase, parti të caktuara pretendonin se "në asnjë dokument të BE-së nuk përcaktohet se gjuha maqedonase do të jetë zyrtare pas anëtarësimit të Maqedonisë në BE."[112]

2.3. Dezinformata dhe manipulime mediatike për fillimin, hapjen dhe vazhdimin e negociatave me BE-në

Dezinformatat dhe manipulimet mediatike për nisjen e negociatave me BE-në ishin pjesë përbërëse e narrativëve të opozitës dhe mediave kundër "propozimit francez".[113] Për shembull, para hapjes së negociatave me BE-në (19 korrik 2022), lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, gabimisht pretendoi se «nuk do t›i fillojmë negociatat tani»[114] dhe se "propozimi francez" nuk ofron fillimin e integrimit evropian të Maqedonisë.[115]

Në të njëjtën ditë kur mediat dhe gazetarët shpallën fillimin e negociatave me BE-në, lideri i partisë "E majta", Apasiev, sulmoi gazetarët për raportim me tituj të porositur "negociatat me BE-në kanë filluar", duke pretenduar se "negociatat do të fillojnë në verën e qyqeve".[116] Partia "E majta" pretendoi se "Konferenca ndërqeveritare nuk

hap negociatat për BE“ dhe se në Bruksel “po krijohet një përshtypje e rreme për një lloj fillimi të negociatave me BE-në” (“nuk ka fillim të negociatave derisa të ndryshohet Kushtetuta e Maqedonisë me kërkesë të Bullgarisë”).

Edhe pas hapjes së negociatave më 19 korrik 2022, Mickoski publikisht pretendoi se nuk ka negociata me BE-në. Më 20 korrik 2022, Mickoski deklaroi jo vetëm se nuk ka negociata, por se nuk ka as skrining (“Nuk ka skrining, nuk ka negociata”),[117] duke paralajmëruar një referendum për “kornizën negociuese”. Pak ditë më vonë, Mickoski përsëri pretendoi se “ne nuk po i fillojmë negociatat”, ndërsa dezinformoi për kornizën negociuese të miratuar nga Këshilli i BE-së: “Ne do t’i fillojmë negociatat dhe do ta miratojmë kornizën negociuese kur të ndryshojmë Kushtetutën”.[118]

Paraardhës i narrativëve të tillë me dezinformata politike për hapjen e negociatave ishin interpretimet “eksperte” se “Negociatat hapen pas konferencës ministrore dhe pas ndryshimit të Kushtetutës”.[119] Interpretime të tilla u mohuan gjithashtu në raportin e BE-së për Maqedoninë e Veriut nga 12.10.2022, i cili konfirmoi se procesi i negociatave dhe skriningu kanë filluar pas miratimit të kornizës së negociatave nga Këshilli i BE-së.[120]

Mirëpo, edhe pas publikimit të raportit të KE-së, i cili konfirmoi se BE-ja ka filluar procesin e negociatave me Maqedoninë e Veriut, Mickoski vazhdoi të përhapë gënjeshtra se “ne nuk i kemi filluar ato negociata”.[121] *Përveç Mickoskit, edhe analistë të tjerë dhe politologë gabimisht pretenduan se negociatat nuk kanë filluar dhe se “negociatat do të fillojnë nëse ndryshohet Kushtetuta”. IMA bëri me dije se ndryshimet kushtetuese nuk janë kusht për fillimin e negociatave nga BE-ja, por kusht për përfundimin e* “fazës hyrëse të negociatës për anëtarësim“.[122]

Edhe në vitin 2023 vazhduan manipulimet mediatike se negociatat me BE-në nuk kanë nisur dhe nuk janë hapur,[123] madje edhe se Maqedonia nuk ka marrë ende një “datë për fillimin e negociatave”.[124] Narrativët dezinformues se negociatat me BE-në nuk kanë nisur, apo se do të fillojnë vetëm pas ndryshimeve kushtetuese, janë përsëritur në shumë raste nga përfaqësues të ndryshëm të opozitës, analistë dhe media. Për shembull, përfaqësues të VMRO-DPMNE-së në disa raste kanë deklaruar se “Maqedonia nuk nis fillimin e negociatave“, “negociatat nuk kanë filluar ende“, “Maqedonia deri më tani nuk ka marrë datë për fillimin e negociatave“, “ne nuk kemi një datë për negociata me BE-në“, “të përfundojnë ndryshimet kushtetuese dhe të nisë procesi i negociatave“, etj.

Gjithashtu, në vitin 2023 ka vazhduar trendi i keqinterpretimit të ndryshimeve kushtetuese “inkorporimi i bullgarëve në Kushtetutë, si parakusht për fillimin e negociatave me BE-në“.

Në vitin 2023 kemi pasur edhe akuza të pabaza se kryeministri dhe përfaqësuesit e BE-së kanë dezinformuar se Maqedonia e Veriut ka filluar negociatat me BE-në. Për shembull, u publikua një analizë me pretendime të pabaza se kryeministri në Bruksel në korrik 2022 mbajti një “fjalim që përhapte dezinformatë se negociatat kishin filluar”. Dhe jo vetëm kryeministri, por edhe Presidentja e Komisionit Evropian u akuzua pa prova se mbështeti me vetëdije “narrativin e rreme për negociatat që kanë nisur” kur deklaroi në Bruksel më 19.07.2022 “Sot, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut po fillojnë negociatat me Bashkimin Evropian...”.[125]

Megjithatë, akuzat e tilla për dezinformim janë të pabaza, si dhe akuzat ndaj Presidentes të KE-së për “narrativ të rreme” për fillimin e negociatave me BE-në dhe akuzat analoge të VMRO-DPMNE-së se “Kovaçevski gënjeu se negociatat kishin filluar...“.

Sipas kritereve të zgjerimit të publikuara në faqen e internetit të BE-së, "negociatat e anëtarësimit fillojnë zyrtarisht pasi vendet anëtare të bien dakord për kornizën negociuese". Prandaj, në informacionin zyrtar të BE-së për "Konferencën ndërqeveritare për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut" thuhet se "Më 19 korrik 2022, BE-ja filloi fazën hyrëse të negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut".[126]

Në blogun "Respublika", deklarata e Mariçiqit se "data e fillimit të negociatave" është "19 korrik 2022" është vlerësuar gabimisht si "dezinformatë me të cilën Qeveria do të ndërtojë qëndrimin e saj deri në aktin e votimit të ndryshimeve kushtetuese". Por ky vlerësim i gabuar bie ndesh me vendimin e Këshillit të BE-së "Konferenca ndërqeveritare për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut", me procesin e skriningut, po dhe me ekspertët që konfirmuan se negociatat e anëtarësimit kanë filluar.[127]

Thënë shkurt, pretendimi se data 19 korrik 2022 është data e fillimit të negociatave të Maqedonisë së Veriut me BE-në nuk është ndonjë dezinformatë nga ana e ministrit (apo qeverisë), por një qëndrim dhe informacion zyrtar nga ana e BE-së.[128] Ky qëndrim u theksua më pas në Konferencën ndërqeveritare në nivel ministror për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut, kur kryesuesi Jan Lipavski theksoi se procesi i negociatave për anëtarësim ka filluar dhe se "Fillimi i negociatave është me përfitim të ndërsjellë si për Maqedoninë e Veriut ashtu edhe për BE-në". Qëndrimi i BE-së për hapjen apo fillimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut u përsërit shumë herë, jo vetëm në kanalet e BE-së, por edhe nga përfaqësuesit zyrtarë.

2.4. Dezinformata dhe manipulime historike në kontekst të ndryshimeve kushtetuese

Dezinformatat historike dhe manipulimet në marrëdhëniet maqedono-bullgare dhe hapësirat mediatike janë një temë që meriton një analizë të veçantë dhe gjithëpërfshirëse. Në vitin 2023, narrativët me dezinformime dhe manipulime historike ranë në sy gjatë homazhit përMara Bunevën, në festën e ditëlindjes dhe shënimin e vdekjes së Goce Dellçevit, [129] gjatë përkujtimit të dëbimit të Hebrenjve nga Maqedonia,[130] por edhe gjatë përkujtimit të ngjarjeve dhe personaliteteve të tjera historike, siç ishte Kryengritja e Ilindenit, kur po ashtu u përhapën lajme të rreme dhe dezinformata.[131]

Një nga çështjet e diskutueshme në vitin 2022, që vazhdoi të debatohet në media në vitin 2023, është nëse dhe në çfarë mase historia është pjesë e kornizës së negociatave me BE-në.[132]

Këtu do të theksojmë vetëm tendencën e përhapjes mediatike të narrativëve me dezinformata dhe manipulime për historinë[133] dhe "komisionin historik" në kuadër të "propozimit francez", që vazhdoi edhe në kuadër të "debatit" për ndryshimet kushtetuese.

Edhe në vitin 2023 vazhdoi trendi nga viti 2022 i akuzimit të komisionit historik për "bullgarizim". Partia "E Majta", e cila në vitin 2022 e akuzoi "Komisionin për bullgarizimin e popullit maqedonas" dhe se ai ishte në shërbim të "supremacisë", edhe në vitin 2023 vazhdoi përmes përfaqësuesve të saj ta cilësojë si "organ për bullgarizim". Në vitin 2023 vazhdoi tendenca e analogjive të pabaza historike, të cilat promovuan teza propagandistike dhe teori konspirative për ndryshimet kushtetuese dhe përfshirjen e bullgarëve në kushtetutë.[134] Edhe në vitin 2023 kishte përpjekje për të ngritur panik mediatik për "bullgarizimin" e historisë maqedonase nga historianët.[135]

Gjithashtu, vazhdoi tendenca e interpretimeve ekskluzive etno-nacionaliste të shprehjes "histori e përbashkët" (në të dy anët e kufirit) dhe kundërshtimi ndaj dispozitës së Marrëveshjes me Bullgarinë për organizim « festimesh të përbashkëta me pëlqim të ndërsjellë të ngjarjeve dhe personave të përbashkëta historike, që synojnë forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në frymën e vlerave evropiane". Për shembull, teksti "Maqedonia vetë feston më së miri figurat dhe datat e veta historike" konkludon se "festimi i përbashkët i datave dhe i figurave me Bullgarinë rezulton të jetë kundërproduktiv", ndërsa historiani Çepreganov jep një shpjegim ideologjik pse "nuk ka nevojë për festim të përbashkët": "Çfarë do të nderojmë bashkë me ta? Goce Dellçev ka luftuar për Bullgarinë e San Stefanit? Jo. Goce Dellçev luftoi për shtetin dhe pavarësinë maqedonase. Si t'i bashkojmë këto dy gjëra në kremtim të përbashkët? Këto janë dy ideologji të kundërta".

Në tekstin "Maqedonasit dhe bullgarët nuk duhet të nderojnë bashkërisht Goce Dellçevin" jepet një interpretim ekskluziv se "veprimtaria revolucionare e Goce Dellçevit nuk ka asnjë pikë kontakti me historinë bullgare, përveç nganjëherë prania e tij fizike në Sofje dhe në disa qytete më të vogla të Bullgarisë."

Në tekstin Historia e përbashkët si një hap drejt shtetit të përbashkët (Nova Makedonija, 01.02.2023) theksohet sërish deklarata e historianit Çepreganov se "nderimi i përbashkët është përfshirë në marrëveshje me të vetmin qëllim që të tregohet se kemi një histori të përbashkët dhe se ne jemi një komb".


нова Македонија
ПРВИОТ МАКЕДОНСКИ ДНЕВЕН ВЕСНИК
20 ДЕНАРИ
www.novamakedonija.com.mk СРЕДА, 1 ФЕВРУАРИ 2023 БРОЈ: 25.738 ГОДИНА: LXXVIII
БЕТОН
Треба да имаме меѓународен поредок заснован на меѓународното право и на Повелбата на ОН!
Нова Македонија СЛЕДЕТЕ НЕ
САМО ЕДНА ТОЧКА Е ВАЖНА ЗА СОФИЈА ОД ЦЕЛИОТ ДОГОВОР ЗА ПРИЈАТЕЛСТВО И СОРАБОТКА
Заедничката историја како чекор до заедничка држава
Македонија има свои интереси и своја политика, таа им припаѓа на сите Македонци
Проф. д-р Александар Литовски
Свирна локомотивата за Жабени, возот за Лерин сè уште молчи
Хрватска како дестинација далеку од европскиот просек, но привлечна за работниците од бивша Југославија
На наредната енергетска крстосница, Германија ќе заврти со полукружно вртење
ФАКОМ ВО СВЕТОТ НА ЧЕЛИКОТ www.fakom.com.mk

Ilustrimi i tekstit Historia e përbashkët si një hap drejt shtetit të përbashkët, faqja e parë e Nova Makedonija, 01.02.2023

Edhe para festimit të Ilindenit, Çepreganov parashikoi në mënyrë profetike se "BE-ja do të kërkojë që ne, maqedonasit, të heqim dorë nga Ilindeni në emër të rrugës sonë drejt BE-së, dhe kjo të mbështetet nga komisioni multidisiplinar për çështje historike dhe arsimore, dhe e gjithë kjo në emër të "historisë së përbashkët".[136]

Këta shembuj tregojnë se trendi i abuzimit mediatik të historisë, figurave historike dhe historianëve për qëllime politike vazhdoi.[137]

2.5. Narrativët, mitet dhe teoritë konspirative etnonacionaliste për "Bullgarinë e Madhe" dhe "Shqipërinë e Madhe" në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese

Narrativët etno-nacionalistë për "Bullgarinë e Madhe" ranë në sy në përkujtimin e vrasjes së Mara Bunevës në janar të vitit 2023,[138] pas së cilës eurodeputeti Angel Xhambazki ka theksuar në faqen e tij në Facebook "rroftë kombi i bashkuar dhe i pandashëm bullgar, nga Ohri deri në Detin e Zi dhe nga Danubi në Detin e Bardhë" dhe "Rroftë Maqedonia bullgare".[139] Ndonëse Xhambazki është anëtar i një partie që nuk arriti të sigurojë hyrjen në Parlamentin bullgar, provokime të tilla "mega-bullgare" [140] shkaktuan polarizim social dhe reagime të ashpra partiake, ndërsa partia pro-ruse "E majta" kërkoi ndalimin e hyrjes së gjashtë "armiqve" të popullit maqedonas, të lidhur me "klubet fashiste në mbarë Maqedoninë, të cilat përdoren për propagandë agresive antimaqedonase".[141]

Disa ditë më vonë në Ohër u sulmua fizikisht sekretari i klubit bullgar "Car Borisi III", ndërsa një nga sulmuesit e tij u akuzua për lëndim të rëndë trupor nga urrejtja për shkak të përkatësisë kombëtare dhe etnike.[142] Bullgaria reagoi ndaj "përshkallëzimit serioz të krimeve të urrejtjes dhe manifestimeve kundër Bullgarëve në vend", megjithëse viktima nuk ishte shtetas bullgar.[143]

Një kontekst i tillë i polarizuar u ndez më tej nga titujt e mediave, të cilat iu referuan pretendimeve zyrtare se "shërbimi rus i inteligjencës qëndron prapa strukturave në Bullgari që kryejnë një fushatë antishtetërore kundër Maqedonisë së Veriut" dhe për "Rusinë si faktor i tretë në konfliktin maqedono-bullgar".[144] Pasuan reagimet zyrtare nga Bullgaria - përmendja e "vetos" nga Radevi dhe insinuatat dhe dezinformatat historike për Goce Dellçevin nga Jotova - tregonin për një përkeqësim serioz të marrëdhënieve.[145]

Në këtë kontekst polarizues, historiania dhe politikania Natasha Kotllar Trajkova, nënshkruese e letrës së hapur drejtuar Putinit nga "Manifesti maqedonas", botoi një kolumnë "Dy mitet fqinje dhe "ndryshimet tona kushtetuese", në të cilën akuzonte se mitet e "Bullgarisë së Madhes" dhe "Shqipërisë së Madhe" "duket se kanë mbështetjen e BE-së dhe NATO-s"! "[146]

Urimi zyrtar i Ministrit të punëve të jashtme, Bujar Osmani, për festën kombëtare të Bullgarisë më 3 mars, u përdor nga mediat për të ringjallur "Bullgarinë e San Stefanit" dhe përfaqësimin mediatik të Osmanit në të njëjtën linjë me "mohuesit e popullit maqedonas dhe shtetit" dhe "irredentistët" bullgarë.[147] Si në vitet e mëparshme, mediat përdorën deklarata ultra-nacionaliste dhe publikuan harta të "Bullgarisë së Madhe" për të nxitur pasionet nacionaliste.[148]

Për përkeqësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve maqedono-bullgare dëshmon reagimi i ashpër i Bullgarisë pas opinionit negativ për përdorimin e emrit Ivan Mihajllov si emër i klubit kulturor bullgar në Manastir.[149] Ka tregues të shumtë të përkeqësimit të marrëdhënieve maqedono-bullgare edhe në muajt në vijim, që kulmoi me deklaratën e

kryeministrit Kovaçevski në Këshillin e Evropës, ku ai krahasoi diskursin e Bullgarisë me diskursin e Rusisë ndaj Ukrainës.[150]

Historianë të njohur evropianë paralajmëruan gjithashtu për një "ngjashmëri shqetësuese midis argumenteve historike të Rusisë ndaj Ukrainës dhe Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut",[151] dhe një ngjashmëri e tillë u bë edhe më e dukshme pas "konflikteve simbolike" në Bullgari për "historinë e përbashkët" me Rusinë, dhe tezat e propagandistëve rusë se Bullgaria "po shndërrohet në Ukrainë 2.0" ose "Ukraina e dytë".[152]

Ndërsa në debatin bullgar për "ndryshimet kushtetuese" historianët pohuan se "Bullgaria e San Stefanit" si shtet "nuk ka ekzistuar as për një ditë të vetme", fryma e "Bullgarisë së San Stefanit" u evokua edhe në "debatin" për ndryshimet kushtetuese në Maqedoni - deputeti dhe lideri i partisë "E Majta", Apasiev, kërcënoi se „Me ndryshimet kushtetuese do të festojmë Bullgarinë e Shën Stefanit këtu në Maqedoni", "në të cilën është inkorporuar një pjesë e Maqedonisë, me kryeqytet Ohrin".

Pak para "debatit" për ndryshimet kushtetuese në Maqedoni, u thirr edhe fantazma propagandistike e "Shqipërisë së Madhe", një tjetër temë e preferuar propagande, jo vetëm e "Të majtës", por edhe e propagandës serbe dhe ruse antiperëndimore në Ballkan.

Inaugurimi i rrugës "Adem Demaçi" në Çair u shfrytëzua maksimalisht për mobilizim propagandistik etno-nacionalist - jo vetëm nga organizatorët vendas dhe mysafiri i tyre - kryeministri i Kosovës Albin Kurti, por edhe nga partia "E majta" dhe nga propaganda (pro)ruse në Maqedoni dhe Serbi. Një ditë para hapjes zyrtare të rrugës, aktivistët politikë të partisë pro-ruse "E majta" e denigruan Adem Demaçin si "separatist nga Jugosllavia dhe luftëtar për Shqipërinë e Madhe dhe pavarësinë e Kosovës",[153] dhe në anën tjetër pretendonin se kujtimi i luftëtarëve të "Brigadës së Dytë Maqedonase" – "ata që dhanë jetën në luftën kundër pushtuesit fashist Bullgar", po fshihej. Përballë akuzave politike dhe mediatike se u fshi kujtimi i luftëtarëve nga "Brigada e Dytë Maqedonase" në Shkup, reagoi ish-kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, "Rruga e Brigadës së Dytë Maqedonase", asnjëherë nuk (u) fshi në Shkup... Ish rr. "Lovçenska 9" quhet rruga "Brigada e Dytë Maqedonase".

Propaganda ruse në Serbi shfrytëzoi maksimalisht vizitën e Albin Kurtit për të përforcuar narrativin e vjetër frikësues propagandistik të "Shqipërisë së Madhe" dhe për të vënë në shënjestër "perëndimin kolektiv". Ditë pas dite, kanalet ruse RT dhe Sputnik në serbisht mbusheshin me artikuj propagande antiperëndimore kundër Kurtit dhe Shqipërisë së Madhe.[154] Për shembull, në artikullin Kurti promovoi Shqipërinë e Madhe dhe veten e tij si liderin e të gjithë shqiptarëve në planet (Sputnik Serbi, 13.08.2023) u pretendua se "perëndimi kolektiv" qëndron pas shovinizmit radikal shqiptar, "që nënkupton jo vetëm tërheqjen e kufijve të rinj, por edhe spastrimin etnik ose, më saktë, gjenocidin e atyre që nuk i përkasin popullit shqiptar".[155]

Derisa propagandistët (pro)rus në Serbi përhapnin narrativët frikësues antishqiptarë, antiperëndimorë dhe islamofobikë[156] "E majta" përhapte narrativë antifashist, antishqiptar dhe antibullgar me dezinformata dhe manipulime. Nga njëra anë, përpjekja për të njollosur Adem Demaçin si "bashkëpunëtor i një lëvizjeje fashiste" paraqet manipulim dhe dezinformatë historike.[157] Nga ana tjetër, prezantimi i luftëtarëve të "Brigadës së Dytë Maqedonase" si "ata që dhanë jetën në luftën kundër pushtuesit fashist bullgar" është një manipulim historik, duke marrë parasysh heshtjen për batalionin bullgar Hristo Botev (që ishte pjesë e "Brigadës së Dytë Maqedonase"), dhe komandohej nga antifashisti bullgar Diço Petrov, emrin e të cilit e mban një rrugë në Shkup.

Një pjesë e narrativëve propagandistik "antifashist" dhe antibullgar të "Të majtës" nuk e fshehin fare se qëllimi i tyre është të pengojnë hyrjen e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Për shembull, pasi EKRI në raportin e saj për Maqedoninë e Veriut vuri në dukje stereotipin tipik anti-bullgar dhe etiketimin e bullgarëve si "fashistë", një propagandist nga "E majta" në stilin ruso-propagandistik sulmoi EKRI-në si një komision i BE-së për "rehabilitimin e fashizmit dhe nazizmit", megjithëse është organ i Këshillit të Evropës.[158]

Vizita e Kurtit u shfrytëzua në vazhdën e ndryshimeve kushtetuese jo vetëm për mobilizim etno-nacionalist nga të gjitha partitë e "interesuara" politikisht.[159] por edhe për një përpjekje për të diskreditуar procesin e ndryshimeve kushtetuese. Për shembull, në një paraqitje në Televizionin Tanjug, Kryetari i PDSM-së dhe deputet në Kuvendin e Maqedonisë, Ivan Stoillkoviq ka thënë se ndryshimet kushtetuese "humbën kuptimin e tyre pas vizitës së Albin Kurtit" dhe se Kurti "varrosi amendamentet kushtetuese".[160]

Përkundër dëshirës së deklaruar të propagandistëve serbo-rus për të "varrosur" ndryshimet kushtetuese në gusht të vitit 2023, shprehjet "ndryshime kushtetuese", "diktat bullgar", "bullgarizim", "asimilimi i popullit maqedonas", janë ende aktuale në hapësirën mediatike-politike maqedonase në fund të shtatorit 2023 - si dhe dezinformatat dhe manipulimet mediatike të përfshira në narrativët propagandistik.

3.Në vend të konkluzionit: Media dhe dezinformatat, teoritë e konspiracionit dhe manipulimet rreth ndryshimeve të propozuara kushtetuese

Në këtë analizë, pamë se si një pjesë e mediave nuk arritën të përmbushin rolin e tyre themelor të kontrolluesit të fakteve, duke e vënë veten me vetëdije në rolin e kanaleve propagandistike për përhapjen e narrativëve me dezinformata dhe teori konspirative që ndiznin pasionet etno-nacionaliste dhe nxisnin diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes.

Në pjesën e parë të analizës, pamë se si mediat ndihmuan në përhapjen e dezinformatave dhe teorive konspirative për "gjenocid" dhe "etnocid" të popullit maqedonas në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese të propozuara në vitin 2023. Fatkeqësisht, disa media maqedonase treguan pak kapacitet për njohjen dhe definimin e dezinformimit politik dhe historik dhe teorive të konspiracionit dhe u keqpërdorën përsëri për qëllime politiko-propagandistike edhe në "debatin" për ndryshimet kushtetuese.

Qëndrimi jokritik i mediave ndaj teorive të konspiracionit për "bullgarizimin" dhe ndaj narrativëve dezinformues për popullin dhe gjuhën maqedonase, për historinë dhe identitetin, kontribuoi në rritjen e polarizimit shoqëror dhe forcimin e ndikimit malinj të aktorëve të huaj në hapësirën mediatike maqedonase. Qëndrimi jokritik i mediave ndaj fushatave dezinformuese në lidhje me amendamentet e propozuara kushtetuese, mosnjohja e narrativëve dhe aktorëve kryesorë të dezinformimit, gjithashtu i mundësoi propagandës (pro)ruse të forcojë ndikimin e narrativëve anti-perëndimore dhe anti-BE në hapësirën mediatike maqedonase.

(Autori është drejtues i hulumtimeve në Institutin për Media dhe Analitikë IMA)

Referencat:

1 Shihni, për shembull, Ardhmëria e Maqedonisë nuk varet nga BE-ja dhe NATO-ja, Kombi Maqedonas, 27.04.2010: "Si Qeveria ashtu dhe opozita parlamentare duhet ta dinë se çdo bisedë dhe marrëveshje për ndryshimin e emrit shtetëror Maqedoni paraqet tradhti të lartë, kapitullim, krim kundër njerëzimit dhe gjenocid ndaj popullit maqedonas".

2 Shihni, për shembull, Çfarë do të ndodhë nëse LSDM-ja dhe shërbëtorët e saj vijnë në pushtet?, Kombi Maqedonas, 28.05.2011. Mbi teoritë konspirative të "etnocidit nga boshti Bruksel-Athinë" Shihni Boshtit Athinë-Bruksel i duhet LSDM-ja në pushtet për ta zhdukur Maqedoninë!, Dnevnik, 28.10.2011.

3 Shihni, Letër e hapur e Manifestit maqedonas: Jo në BE pas injorimit të fundit të Maqedonisë!, 22.12.2013

4 Shihni Letër e hapur kryeministrit Zoran Zaev, Nova Makedonija, 14.06.2018.

5 Shihni Eftim Kletnikov, Idiotizëm dhe idiotë, Nova Makedonija, 20.06.2018 dhe Kletnikov: Populli i vetëdijshëm maqedonas të mos dalë në referendum dhe ta bojkotojë, sepse kjo qeveri është gjenocidale, Republika, 03.09.2018

6 Shihni Paradoksi maqedonas (Referendumi që na bën mendjevogël), Nova Makedonija, 05.09.2018.

7 një koment i qartë për paraqitjen mediatike të Kletnikov: "Shkrimtari thotë se maqedonasit janë hebrenjtë e rinj. Unë u ngrita në këmbë. E shtrëngova shpejt veten që të mos ëndërroja... Nuk është ëndërr, është e vërtetë. Kletnikov flet drejtpërdrejt si Moisiu përpara Hebrenjve. Evropa dhe bota janë fashistët që duan të shkatërrojnë popullin maqedonas. Gjenocidi identitar që po përgatitet ndaj Maqedonasve ishte më i tmerrshëm se gjenocidi fizik..." Eroll Rizaov, Maqedonasit janë Hebrenjtë e rinj, Nezavisen, 05.09.2018.

8 E Veriut: Projekti i fashizmit Evropian- Eftim Kletnikov! , Kolozheg.Info, 19.09.2022.

9 VMRO-DPMNE: Marrëveshja kapitulluese e Zaevit nuk do të sjellë jetë më të mirë, shteti do të fundoset edhe më shumë për shkak të pushtetit të paaftë dhe do të mbahet mend gjenocidi i turpshëm, Kurir, 20.06.2018.

10 Shihni Stoillkovski: Zaev fshin identitetin maqedonas nga himni, tekstet, tradita dhe kultura, Kurir, 21.06.2018.

11 Shihni (Video) Stoillkovski: A do të mund ta këndojnë qytetarët tani himnin "Sot mbi Maqedoni lind"?, Makfaks, 21.06.2018.

12 Shihni Komuniteti i burrave dhe grave maqedonase që krijuan #Bojkotoj publikoi Kodin e etikës!, Observer, 04.08.2018.

13 Shihni, Goce Trpkovski, Fakte, parafakte dhe kundërfakte në fushatën për bojkotim të referendumit, Prizma, 20.08.2018: "Në një numër të madh njoftimesh kryefjala është "gjenocid", gjegjësisht mesazhi është se populli maqedonas do të vetëshkatërrohet me zbatimin e marrëveshjes.

14 Më vonë, një nga faqet e Bojkotoj do të akuzon po ashtu për "shkatërrimin e plotë të popullit maqedonas dhe zbatimin e inxhinierisë gjenetike të dhunshme për krijimin e një kombi të ri të Severxhanëve (Maqedonasve të Veriut)". Në të njëjtën faqe, e cila akuzonte për #gjenocidin bashkëkohor mbi popullin tanë", shihen edhe akuzat për "gjenocid në krah të regjimit neo-nazist kundër Rusëve në Ukrainë", dhe Putin lavdërohet si "kujdestari i vetëm i botës ortodokse."

15 Shihni Propaganda ruse me dezinformata në Maqedoni para referendumit në 2018, ima.mk, 26.04.2022.

16 Shihni Maqedonia e Vetme propozon që autostrada të quhet "Gjenocid" në vend të "Miqësi", Fokus, 25.01.2018.

17 Shihni Baçev: Të parandalojmë gjenocidin që duan ta bëjnë ndaj popullit maqedonas, centar.mk, 23.10.2018: "Megjithatë, sot jemi dëshmitarë se Republika po përballet me një sfidë serioze, sepse qeveria aktuale kukull dhe bosët e saj të huaj duan të fshijnë gjithçka që është maqedonase. Prandaj, tani i takon kësaj gjenerate të maqedonasve që ta parandalojnë këtë gjenocid që duan t'i bëjnë popullit maqedonas, të fshijnë emrin shekullor, identitetin, historinë, traditën, gjuhën dhe kulturën e vjetër maqedonase".

18 Shihni Referendumi në Maqedoni: procesi gjenocidal për ndryshimin e emrit pa legjitimitet, poligrozd.org, 02.10.2018 dhe Emilija Geleva, Akt kundër Zotit, poligrozd.org, 28.11.2018.

19 Shihni, për shembull, Shoqata maqedonase "Ilinden"- Tiranë u bën thirrje Maqedonasve të bojkotojnë referendumin, 27.09.2018: Maqedonasit në Republikën e Shqipërisë refuzojnë ndryshimin e emrit të shtetit të Maqedonisë dhe emrit të popullit maqedonas dhe e konsiderojnë atë gjenocid ndaj popullit maqedonas dhe krim kundër njerëzimit.

20 Shihni VMRO-DPMNE iu kthye bojkotit, Nezavisen, 27.09.2018.
21 Shihni Referendumi në vetvete është gjenocidal, Kombi maqedonas, 22.08.2018.
22 Agatangel Mickoskit: Nuk po ju them të shkoni në mal me pushkë në dorë, por të bëni thirrje për bojkotim të referendumit, Fokus, 30.07.2018.
23 Shihni, Agatangel: Papa në Maqedoni, 06.05.2019: "Kjo vizitë është një qetësim simbolik i ndërgjegjes së të gjithë atyre që kryen një gjenocid të heshtur dhe të veçantë kundër popullit maqedonas".
24 "Tubimi qendror i Bojkotoj "Bojkotoj Veriore, Gjithmonë Maqedoni!" – Shkup, 27 shtator në ora 19:00": "Bojkoti duhet të fitojë sepse ajo që ishte holokausti për Hebrenjtë, është ndryshimi i emrit për Maqedonasit. Për ne Maqedonasit, kjo është një betejë si beteja e mohikanit të fundit - kjo është një betejë për mbijetesë! Ose do të mbijetojmë si komb, ose ne Maqedonasit do të vdesim dhe zhdukemi".
25 (VIDEO) Stoillkovski: U krijua një akt që çon në etnocid, në fshirjen e një kombi të tërë dhe tiparet e tij, A1ON, 21.10.2018.
26 Shihni Dimovski: Mickoski para një viti u zgjodh kryetar i VMRO-DPMNE-së, për një kohë të shkurtër do ta udhëheqë vendin me mençuri, guxim dhe ndershmëri, Kurir, 23.12.2018.
27 Shihni Harta e lajmeve të rreme dhe dezinformatave në Ballkanin Perëndimor dhe identifikimi i mënyrave për t'i luftuar ato në mënyrë efektive, Departamenti i politikave për marrëdhëniet me jashtë, Drejtoria e përgjithshme për politikat e jashtme të Bashkimit, shkurt 2021, fq. 7.
28 Shihni Qeveria në panik- Ivanov do t'i drejtohet OKB-së 7 ditë para referendumit, magazin.mk, 27.08.2018.
29 Ivanov në OKB: Nuk do të votoj, me ndryshimin e emrit do të kemi shtet të ri gjysmë sovran (VIDEO) , mkd.mk, 27.09.2018: Nga Republika e Maqedonisë tani kërkohet të kryejë vetëvrasje ligjore dhe historike, në mënyrë që shfuqizimi ligjor i popullit maqedonas të interpretohet si vullnet i tij.
30 "Manifesti maqedonas": Ivanov të fillojë procedurë ligjore në OKB për mbrojtjen e emrit, Makfax, 26.12.2018.
31 Shihni IVANOV: Marrëveshja e Prespës është anulim juridik dhe historik i popullit maqedonas!, Infomax, 28.12.2018.
32 Shihni Baçev i shkroi Makronit: Pres që ju t'i përmbaheni vendimit tuaj të guximshëm - jo anëtarësim në BE në kurriz të tradhtisë kombëtare, Maqedonia e Vetme, 16.10.2019.
33 Shihni "Në Qendërr", si i "gënjeu" Rusët Gjorge Ivanov?, 9.02.2020. "Kur ishte në Rusi, e pritën si mbret. Putini e priti atë në nivelin më të lartë... por, në fund, ai e anashkaloi edhe Putinin, edhe Rusinë, edhe "Manifestin maqedonas", edhe popullin maqedonas, në mënyrë më të egër. Unë jam shumë i zemëruar. Është tradhti e lartë për mua...".
34 "Manifesti maqedonas" i dërgoi një letër të hapur Vladimir Putinit, Republika, 27.12.2021.
35 Për një pamje më të detajuar, Shihni Narrativë me dezinformata, frikësim dhe teori konspirative për identitetin maqedonas dhe popullin maqedonas, ima.mk, 20.09.2022.
36 Velinovska dhe më vonë në disa raste akuzonte për gjenocid monstruoz dhe "gjenocid ndaj popullit maqedonas".
37 "Mbi 800 intelektualë nënshkruan "Manifestin e mësimdhënësve maqedonas"- JO propozimit poshtërues francez", TV Alfa, 12.07.2022.
38 Shihni Meri Jordanovska, Kundër-spin: Gjenocid ekonomik joekzistent dhe gjoja bllokime për të shpëtuar institucionet – rrotullim në spin në fjalimin e Mickoskit, Vërtetmatës, 20.06.2022.
39 Shihni, Mickoski: Kovaçevski negocioi fshehtas 6 muaj, tani bën sikur nuk e di për propozimin që do ta bënte Maqedoninë bullgare, Republika, 23.06.2022.
40 Shihni Deputetët e VMRO DPMNE-së janë të vendosur: propozimi francez për popullin maqedonas është joevropian, çnjerëzor, johuman, skandaloz dhe diskriminues, Nova Makedonija, 15.07.2022.
41 Shihni Stojanoska: Propozimi francez do të kryejë një gjenocid të paprecedentë ndaj popullit maqedonas, Sitel, 15.07.2022.
42 Shihni: Karakamisheva brutale: Gjenocidi kulturor i maqedonasve po ndodh para syve tanë, e drejta ndërkombëtare ka vdekur!, Infomax 24.06.2022: "Jemi dëshmitarë të gjenocidit dhe etnocidit të llojit më të mjerueshëm!" dhe Andovska: Përbindëshit në pushtet janë gati të nënshkruajnë. Etnocid. "Për të mirën tonë", expres.mk, 21.06.2022. Shihni dhe Perço Bozhinovski, i nënshkruar si anëtar i VMRO-DPMNE-së: "Jo – në emër të maqedonasve, ultimatum – jo, faleminderit!", Nova Makedonija,

06.07.2022: "Për gjenocid kundër një kombi të tërë- një JO me zë të lartë!" Për etnocidin- një JO e fortë!"

43 Ivica Bocevski, Grackat më të mëdha për Maqedoninë në "propozimin francez", Nova Makedonija, 02.07.2022.

44 Ljupço Kocarev, Presidenti i ASHAM, Maqedonizmi do të mbijetojë, Nova Makedonija, 5.07.2022.

45 Shihni Presidenti i ASHAM Kocarev dezinformon se "Maqedonasit qysh sot nuk ekzistojnë ", ИМА, 13.09.2022.

46 Ljupço Kocarev, „ Viti dy mijë e tetëdhjetë e katër" ose "Maqedonasi i fundit në Evropë" , Nova Makedonija, 22.07.2022: "me dy dokumentet, Marrëveshjen dhe Traktatin, Maqedonia në fakt, me dije apo pa dije, bëri gjenocid mbi maqedonasit në Egje dhe në Pirin... nëse nuk i grisim dy dokumentet, maqedonasit do të zhduken dhe Maqedonia do të hyjë në BE, por jo edhe maqedonasit".

47 Shihni „Vetëm paradashësit që gabimisht e quajnë veten politikanë janë të verbër dhe të shurdhër ndaj gjenocidit kulturor kundër Maqedonasve", Nova Makedonija, 07.10.2022: "Vetëm njerëzit maqedonas pa dinjitet, të përulurit, paradashësit dhe pushtetarët, të cilët gabimisht e quajnë veten politikanë, dhe apologjetët e tyre, janë të verbër dhe të shurdhër ndaj faktit se me lidhjen dhe përmbushjen e marrëveshjeve me Greqinë dhe Bullgarinë, po zhvillohet një gjenocid kulturor kundër maqedonasve në vendin e tyre, Maqedoni, si dhe ndaj maqedonasve në vendet fqinje të Greqisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë dhe kudo ku maqedonasit jetojnë dhe ekzistojnë si popull".

48 Ivica Bocevski, Maqedonia ka vetëm një President- Akademikun Lupço Kocarev, Nova Makedonija, 10.10.2022

49 Shihni "Kocarev: Maqedonasit edhe pse janë në prag të zhdukjes do të ekzistojnë përgjithmonë!", „Veçer", 28.10.2022 dhe Poligraf: Janë të pavërteta pretendimet e Presidentit të ASHAM se "Maqedonasit janë në prag të zhdukjes" dhe "Maqedonasit nuk janë më as sot!", ima.mk, 17.11.2022.

50 Për të shpalosur këtë dezinformim të Kocarev, shihni Poligraf: Presidenti i ASHAM-it Kocarev dezinformon se "populli maqedonas është zhdukur plotësisht nga skena ndërkombëtare", ima.mk, 01.03.2023.

51 Kocarev: Marrëveshjet me Greqinë dhe Bullgarinë janë holokaust maqedonas dhe gjenocid kulturor i maqedonasve, Sllloboden Peçat, 22.02.2023: "...Marrëveshjet me Greqinë dhe Bullgarinë, të cilat përfaqësojnë gjenocid kulturor të maqedonasve, duhet të emërtohen në kujtesën kolektive të popullit maqedonas me shprehjen "holokausti maqedonas", dhe institucionet kompetente në Maqedoni duhet të propozojnë një ditë për përkujtim të holokaustit maqedonas...".

52 Eroll Rizaov, "Holokausti i Maqedonasve", DW 28.02.2023.

53 Shihni "Në Paris u shënuan 92 vjet nga vdekja e doktorit Anastas Kocarev, onkologut dhe shkencëtarit të madh maqedonas.", Netpress, 27.03.2023.

54 Shih Eftim Kletnikov, "Qendra Përkujtimore e holokaustit maqedonas", Nova Makedonija, 24.04.2019, ku Kletnikov i përshkroi ato si "projekte satanike të Pentagonit dhe poltronëve të tij nga Brukseli, çekiçët vdekjeprurës për copëtimin e plotë të majës së kokës të Maqedonisë, identitetit, sovranitetit shtetëror edhe atij kombëtar".

55 Në rubrikën ku shtjellon idenë e "Qendra memoriale e holokaustit maqedonas", Kletnikov përforcon narrativin e "gjenocidit të identitetit" si "një projekt vampirik i zgjimit nga vdekja, me rroba zie me të cilat na ka mbështjellë tashmë qytetërimi nazi-fashist perëndimor." Duke vepruar kështu, Kletnikov e përshkruan Angela Merkelin si "mbesën e Firerit të Rajhut të Tretë", i cili korrespondon me dezinformatat kundër Merkelit, të zhvlerësuara nga kontrollues faktesh si dezinformata nga Kremlini.

56 Kocarev: Të mos lejojmë ndryshimin e Kushtetutës dhe zhdukjen e Maqedonisë!- BE e shkatërron duke reviduar shprehjen "pushtues fashist bullgar"!, expres.mk, 19.04.2023

57 Lupço Kocarev, Presidenti i ASHAM, Të mos harrojmë, të kujtojmë dhe të veprojmë, Nova Makedonija, 20.06.2023: "Por, sot nuk duhet harruar Marrëveshja me Greqinë, e cila bëri gjenocid kulturor ndaj maqedonasve nga Egjeu. Duke hequr dorë nga maqedonasit nga Maqedonia e Egjeut, Maqedonia si shtet, në fakt hoqi dorë nga maqedonasit në Republikën e Maqedonisë".

58 Lupço Kocarev, Presidenti i ASHAM, Maqedonia e Veriut ka vdekur, rroftë Maqedonia!, Nova Makedonija, 18.08.2023: "Për maqedonasit gjenocidi kulturor janë të gjitha dokumentet në të cilat, jo shkencërisht, por me presion politik, kërkohet të heqim dorë nga maqedonsia, nga rrënjët maqedonase, të heqim dorë nga vetja,

nga maqedonasit në Pirin dhe në Egje, të heqim dorë nga vazhdimësia gjuhësore hapësinore dhe kohore maqedonase, e cila ekziston për mijëra vjet dhe vazhdon të ekzistojë edhe sot, në Maqedoni, në të gjitha vendet fqinje dhe kudo ku jetojnë maqedonasit".

59 Shihni Statusi autoqefal i kishës sonë tashmë është vendosur, Nova Makedonija, 20.01.2023.

60 Gjykata morale e "Manifestit maqedonas" dënoi Zaevin dhe Dimitrovin për gjenocid identiteti ndaj Maqedonisë, alfa.mk, 10.05.2023.

61 Shihni Eftim Kletnikov, "Gjykatë morale dhe një proces i ri i Nyrnbergut (sepse kjo është fashizëm)", Nova Makedonija, 10.07.2019, ku Kletnikov e akuzonte Evropën "zonjën babilonase" për fashizëm: "Me gjenocidin identitar ndaj maqedonasve, ajo ripërtëriu fuqishëm hijet e Rajhut të Tretë, të fashizmit". Kletnikov fajësoi edhe Merkelin, e cila "aq shumë bëri presion që likuidimi maqedonas të ndodhte", duke e lidhur atë me "gjenin fashist të Firerit gjerman". Kletnikov avokonte për «një gjykatë morale që do të akuzojë kriminelët e rinj më fashistë evropianë, por edhe vendas në vendin tonë, të udhëhequr nga Zaev dhe Dimitrov, për gjenocid identitar ndaj maqedonasve".

62 Shihni Aleksandar Rusjakov, Nevrikoseni që nuk mund të kryeni gjenocid fizik, apo jo? , Nova Makedonija, 17.06.2023 dhe Aleksandar Rusjakov, BE-ja është qorrsokak, nuk kemi alternativë tjetër veç BRIKS, Nova Makedonija, 15.07.2023. Gjithashtu, Aleksandar Rusjakov, "Unë jam Amerika, Navaho nga Maqedonia, nuk jam Evropë", Nova Makedonija, 26/08/2023: "Cili që është normal e do integrimin evropian, pas tridhjetë vjet torturash mbi ne nga BE, nga Deklarata e Lisbonës e deri më sot, me synimin për të kryer një gjenocid identitar?".

63 Shihni në Me Maqedoninë ne ekzistojmë, pa Maqedoninë do të zhdukemi të gjithë bashkë!, Nova Makedonija, 08.09.2023.

64 Në një intervistë për Veçer, Todor Petrov për marrëveshjet e mëparshme me Greqinë dhe Bullgarinë pretendoi se ato kanë "qëllim që Maqedonia të bëhet një territor pa popullin dhe historinë maqedonase ose të ripërcaktohet si shtet i pakicave kombëtare, si Zvicra në Ballkan, si një vend i pjesëve të popujve të vendeve fqinje". Shihni në Todor Petrov: Maqedonia ose do të jetë shtet ose nuk do të ekzistojë!, Veçer, 08.09.2023.

65 Shihni në Zharko Trajanoski, Dezinformatat anti-gjinore dhe protesta e KOM-AO, ima.mk, 11.08.2023.

66 Shihni në Poligraf: Kush dezinformon se me futjen e bullgarëve në Kushtetutë do të bëhemi "Bosnja e dytë"?, ima.mk, 16.03.2023.

67 Shihni në Ftesë për festivalin "Maqedonia 2023", i cili do të mbahet më 2 gusht 2023 në Dellçevë, delcevo365.mk, 01.08.2023.

68 Kështu, në vitin 2022, lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, propagandoi publikisht dilemën e rrejshme "bullgarizim apo jo BE", duke theksuar shprehimisht se nuk dëshiron hyrje në BE, "nëse propozimi është të na asimilojnë dhe të jemi Bullgarë". Shiko Mickoski: Propozimi francez do të thotë ose bullgarizim ose jo BE, Fokus, 16.06.2022 dhe Mickoski: Nëse propozimi është që të na asimilojnë dhe të jemi Bullgarë, atëherë nuk dua të hyjmë në Bashkimin Evropian, Kurir, 16.06.2022.

69 Kuvendi miratoi konkluzionet e reja të propozuara për propozimin francez me 68 vota "PËR", VOA, 16.07.2022.

70 Për shembull, Janko Baçev, Ivan Stoiljkoviq dhe lideri i GROM-it, Stevço Jakimovski, i cili propozoi "vdekje me varje për tradhtarin që me një lëvizje do ta legjitimojë këtë lojë të pandershme për bullgarizimin e Maqedonisë". Shiko "Unë propozoj vdekje me varje për tradhtarin që me një lëvizje do të legjitimojë këtë lojë të pandershme për bullgarizimin e Maqedonisë!", Infomax, 05.09.2022.

71 Kovaçevski: Vëllazërisht pesë ministri të LSDM-së po ia lëmë VMRO-DPMNE-së, 360 gradë, 9.06.2023.

72 Shiko Kovaçevski: Histeria e porositur për gjoja bullgarizim, DW, 28.07.2023: "Është një amendament teknik i Kushtetutës në të cilin, përveç pjesëve ekzistuese të kombeve që janë pjesë e Parambulës sonë, shtohen edhe pjesë të kombeve të tjera që nuk ishin pjesë e saj deri më tani, por renditeshin nën "të tjerët" dhe kjo praktikisht mohon të gjitha ato të pavërteta, gënjeshtra, histeri që u përhapën gjatë vitit të kaluar lidhur me faktin se në Maqedoni do të ndodhë bullgarizimi, asimilimi etj. E shihni që nuk ekziston më në diskursin publik, përveç nga disa bota rusë të paguar, të ashtuquajturit analistë dhe madje disa politikanë, të cilët për hir të burimeve financiare duhet të flasin kështu".

73 Shihni, për shembull, Nikolla Todorov, inati maqedonas, DW, 19.07.2023: "Bullgarizimi i Maqedonisë është i pamundur. Kjo mundësi është zero, ndryshe nga mundësia e serbizimit apo shqiptarizimit, për shembull, që janë shumë më të mundshme. Por prapë besoni se nuk

do të ndodhë as bullgarizimi, as serbizimi apo shqiptarizimi i Maqedonisë. Ajo që ka shumë gjasa të ndodhë është shpopullimi".

74 Detektor: Dy të tretat e maqedonasve besojnë se kuadri i negociatave është një hyrje në bullgarizimin e Maqedonisë, Sitel 14.05.2023.

75 Shihni Botimi i ri i 360°: "Bullgarizimi i Maqedonisë"- intervistë me Vesella Çerneva, 360 shkallë, 20.05.2023.

76 Bocevski: Ndryshimet kushtetuese nuk do të kalojnë, evropianizimi përmes bullgarizimit nuk do të zbatohet, Kurir, 24.07.2023.

77 Shihni edhe Bocevski: "Bullgarizimi i çmendur përmes europianizimit" i maqedonasve nuk do të ketë sukses!", expres.mk, 16.07.2022: "Maqedonia me bekimin e BE-së bëhet koloni bullgare dhe procesi i integrimit evropian të Maqedonisë po kthehet në "bullgarizim përmes europianizimit".

78 Shihni (INTERVISTË) Georgievski: VMRO-DPMNE është ideologji e vjedhur, nuk e kuptoj se si u bë partia më pro-serbe!, Fokus, 10.07.2023: "VMRO-DPMNE sot shkon me tezën se nuk do të lejojmë bullgarizimin e Maqedonisë. Në çfarë jemi bullgarizuar? Duke pasur një kanal në televizion që askush nuk e shikon? Fatkeqësisht, që nga koha e Gruevskit, VMRO-DPMNE ka qenë veçse bartës i një politike perfide të gjoja mbrojtjes së identitetit, ndërsa në thelb po serbizojnë Maqedoninë. Ata po luftojnë kundër bullgarizimit, ndërsa ne shohim kulmin e serbizimit të Maqedonisë. Serbizimin e shohim në të gjitha sferat – kulturën, artin, sportin... Kur luajnë ekipet maqedonase dhe serbe, ju bëni tifo për ekipin serb".

79 Shihni Thaçi për VMRO-DPMNE: Parti proruse dhe proserbe, kjo do të sjellë asimilimin e popullit maqedonas, TV21, 17.04.2023.

80 E majta: Ndryshimet kushtetuese janë kornizë ligjore për bullgarizimin e Maqedonisë, Makfaks, 01.06.2023.

81 E majta: Gjashtë vjet "Marrëveshja e fqinjësisë së mirë"- Gjashtë vjet bullgarizim i Maqedonisë, Antropol, 01.08.2023. Marrëveshja me Bullgarinë dhe protokolli vazhduan të jenë cak i sulmeve keqinformuese edhe nga përfaqësues të VMRO-DPMNE-së (Kam të paktën 2 milionë arsye, të cilat janë kundër ndryshimeve kushtetuese dhe për të cilat po votoj kundër, thotë Mizrahi, Makfaks, 18.08.2023: "Dhe ajo marrëveshje dhe protokoll jo vetëm që nuk hap derën e BE-së, por na fshin të gjithëve."

82 E majta: Ekipi për bullgarizimin e Maqedonisë i përbërë nga megafonë qeveritarë dhe apologjist për tradhtitë, Antropol, 25.04.2023.

83 Shihni BE dhe SHBA mbështesin bullgarizimin kundër demokracisë në Maqedoni, Antropol, 29.05.2023.

84 Shihni "Apasiev hodhi poshtë ndryshimet kushtetuese, për të propozuesit janë një elitë politike e çfamilijarizuar", 360 gradë, 25.07.2023.

85 E majta: Nuk ka ndryshime kushtetuese, ndërprerje e negociatave me Bullgarinë, a1on.mk, 18.08.2023.

86 Kovaçevski për MIA: Duhet konsensus kombëtar për të arritur qëllimin strategjik-anëtarësimin në BE, MIA, 6.08.2023: "Qytetarët nuk duhet të mashtrohen me thënie apo të pavërteta. Së pari ishte "asimilimi dhe bullgarizimi". Pasi u pa se nuk ka asgjë nga këto, tani është "diktim bullgar". Ndryshimet kushtetuese nuk janë diktat i askujt dhe as propozim individual i askujt, por janë pjesë e kornizës negociuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian. As më shumë e as më pak." Shihni dhe Kovaçevski: Pas një viti u bindëm se nuk ka bullgarizim dhe asimilim, unë mbeta maqedonas!, TV21, 25.08.2023.

87 Shihni: Bullgarizimi bëhet me pasaportizim, jo duke përmendur Bullgarët në Kushtetutë, thotë Osmani, sdk.mk, 29.07.2023: "Ky proces i pasaportizimit është platforma më e madhe për bullgarizim."

88 Shihni Kush punon për bullgarizimin dhe kush punon për maqedonizimin?!, Veçer, 09.08.2023: "Bullgarizimi ka ndodhur derisa VMRO-DPMNE ka qenë në pushtet për 11 vjet, pse, sepse në ato 11 vjet janë lëshuar një numër rekord i pasaportave bullgare për qytetarët e Maqedonisë.

89 Maqedonizimi apo bullgarizimi- çfarë do të thotë përfshirja e Bullgarëve në Kushtetutën e Maqedonisë?!, Veçer, 20.08.2023.

90 Shihni Kush punon për bullgarizimin dhe kush punon për maqedonizimin?!, Veçer, 09.08.2023.

91 Në "Tema e ditës" nëtelevizionin Sitel më 20.08.2023. Shihni dhe Kovaçevski: Do të jap dorëheqje ditën që të miratohen ndryshimet kushtetuese, mkd.mk, 20.08.2023.

92 Shihni Gjorgji Spasov, Çfarë pengon VMRO-DPMNE-ja: Bullgarizim apo Evropianizim, Nezavisen, 04.09.2023: "Qëllimi kryesor i tyre nuk është të parandalojnë asnjë lloj "bullgarizimi", por hakmarrje politike dhe përballje me "tradhtarët" e popullit maqedonas, të cilin "vetëm ata e mbrojnë". Shihni dhe
Mersel Biljali, "Kush punon për Radevin?!",

Libertas, 07/08/2023, ku kolumnisti kritikon opozitën se është "të varrosur në vrimën e trashë të "bullgarizimit" ose "diktatit bullgar" të rremë".

93 Shihni, për shembull, Petrushevski për TV 24: Një kornizë e tillë negociuese e pranuar nga qeveria do të thotë bullgarizim i heshtur i popullit maqedonas, 19.09.2023.

94 Anëtar i KE: VMRO-DPMNE nuk është kundër Bullgarëve në Kushtetutë, Antropol, 14.07.2023.

95 Shihni dhe Mickoski- Nuk duhet humbur asnjë sekondë për ndryshimet kushtetuese, zgjidhja janë zgjedhjet, REL, 19.08.2023: "Hyrja në BE është rruga jonë e vetme. Por jo me çmimin e vetëmohimit, jo me çmimin e diktimit që është kutia e Pandorës për shpifjen e identitetit dhe hapjen e portës për shumë kërkesa të tjera".

96 "Nëse vërtet dëshironi t'i shihni Bullgarët në Preambulë, kam kujdes se çfarë them – në Preambulë – një pjesë e popullit bullgar që jeton në Maqedoni janë pjesë e kombit maqedonas, në Preambulë, ata 762 që thanë se gjuha bullgare është gjuha e tyre amtare, atëherë të paktën ju mund t'i kërkoni Bullgarisë që të zbatojë të paktën tre nga ato 14 vendimet e Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut, të cilat janë të detyrueshme dhe kanë një afat të kësaj vjeshte për t'u zbatuar." Shihni dhe Mickoski: Zgjedhjet janë zgjidhja e vetme, vijat tona të kuqe në marrëdhëniet me Bullgarinë janë të qarta, Sitel, 19.08.2023.

97 Erol Rizaov, kush po ja dërgon kërcënimet më të rrezikshme Mickoskit, DW, 19.09.2023.

98 Për një analizë më të detajuar Shihni Zharko Trajanoski, Narrativa me keqinformim dhe manipulime mediatike për gjuhën maqedonase, ima.mk, 22.09.2022.

99 Shihni Poligraf: Është keqinformim se gjuha maqedonase në BE do të ketë fusnotë dhe se ajo është kodifikuar në vitin 1977, ima.mk, 02.11.2022.

100 Shihni Deklarata e Presidentes von der Lejen me rastin e vizitës së saj zyrtare në Maqedoninë e Veriut, www.eeas.europa.eu, 27.10.2022.

101 Identiteti maqedonas mes yjeve dhe fusnotave?!, Nova Makedonija, 27.03.2023.

102 Intervistë me Gir: Partitë që janë për hyrjen e Maqedonisë së Veriut në BE duhet të marrin përgjegjësi politike dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat, Lokalno, 24.04.2023.

103 Gir: Nuk duhet pritur garanci të reja për në BE, DW, 15.06.2023.

104 Shihni "Sondazh: Gjysma e qytetarëve të Maqedonisë nuk besojnë se Maqedonia do të bëhet anëtare e BE-së", mkd.mk, 26.06.2023: "Në rast të marrjes së garancive të fuqishme nga BE-ja për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit maqedonas, 45.1% e qytetarëve të Maqedonisë do të mbështesnin ndryshimet kushtetuese".

105 Shihni, për shembull, komenti i hostit për Çfarë nuk është e qartë, TV Alfa, 16.01.2023: "Grekët thonë se maqedonishtja flitet vetëm në Maqedoni, nëse dal jashtë, në Gjermani për shembull, gjuha ime nuk është maqedonase...".

106 Shihni Ellka Jaçeva-Ulçar: Gjuha ime amtare po përjeton momentet më dramatike dhe më kritike të ekzistencës së saj, Netpres, 21.02.2023.

107 Shihni Aktgjykimi në BE me të cilin statusi i gjuhës maqedonase u vendos zyrtarisht si një nga gjuhët e barabarta në Bashkimin, Nova Makedonija, 21.03.2023.

108 Shihni Katica Kjullavkova, Për gjuhën maqedonase dhe për propozimin e ri të Ligjit për gjuhën maqedonase, Nova Makedonija, 10.02.2023: "Një folës i një gjuhe prej 20 për qind të popullsisë ka të drejta më të mëdha gjuhësore në praktikë sesa e drejta kushtetuese e folësve maqedonas.

109 "Çdo mohim i ekzistimit të kontinuitetit hapësinor dhe kohor të popullit maqedonas dhe gjuhës maqedonase është maqedonofobik", Nova Makedonija, 21.07.2023.

110 Është keqinformim se kompania gjermane DM ka suspenduar gjuhën maqedonase nga dyqanet e saj në Maqedoni, civilmedia.mk, 26.07.2023.

111 Risto Nikovski, Korniza e negociatave, disfata historike e Maqedonisë, +info, 19.09.2023.

112 DS: Në asnjë dokument nuk është përcaktuar se gjuha maqedonase do të jetë zyrtare në BE, Fokus, 26.08.2023.

113 Shihni Zarko Trajanoski, "Keqinformimi, manipulimet mediatike dhe teoritë konspirative për 'propozimin francez'", në ""Propozimi francez": gjuha e urrejtjes, keqinformimi, manipulimi mediatik (analiza mediatike), Instituti për media dhe analitikë IMA Shkup, 2022.

114 Ne po e nënshkruajmë këtë që Shqipëria të fillojë negociatat, jo Maqedonia, thotë Mickoski për propozimin francez, Nova Makedonija, 04.07.2022: "Ne nuk do të fillojmë negociatat tani, këtë duhet ta dinë qytetarët. Shqipëria do të fillojë, jo ne. Ne do të duhet të ndryshojmë Kushtetutën. Ne po e nënshkruajmë këtë që Shqipëria të fillojë negociatat, jo Maqedonia".

115 Mickovski për "Politika": Propozimi francez nuk ofron fillimin e evrointegrimeve të Maqedonisë, Kanal 5, 11.07.2022.

116 Shihni Apasiev vazhdon me sulmet brutale ndaj gazetarëve dhe përhapjen e keqinformimit, IMA, 20.07.2022.
117 Mickoski për referendumin: Jemi fokusuar në kornizën e negociatave, 360 gradë, 20.07.2022.
118 Shihni INTERVISTA, HRISTIJAN MICKOSKI: BDI hyri në pakt me Bullgarinë dhe tradhtoi popullin maqedonas, Veçer, 22.07.2022.
119 Shihni Malinka Ristevska Jordanova, NUK DUHET TË MBETË JO, https://respublica.edu.mk/, 02.07.22.
120 "Pas miratimit të Kornizës për negociatat nga Këshilli, më 19 korrik 2022 u mbajt Konferenca e parë ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut. Komisioni filloi menjëherë procesin e shqyrtimit analitik të *drejtës* së BE-së, që është hapi i parë i procesit të negociatave", thuhet në raport.
121 Shihni Poligrafi: Është e pavërtetë që negociatat me BE-në dhe skriningu nuk kanë filluar, ima.mk, 26.10.2022.
122 Shihni POLIGRAF: Kush po përhap keqinformim se negociatat me BE-në nuk kanë filluar?, ima.mk, 29.11.2022.
123 Për shembull, në shpalljen "Korniza e negociatave, disfata historike e Maqedonisë" Risto Nikovski nxjerr përfundimin e gabuar se "negociatat nuk janë të hapura".
124 Një keqinformim i tillë është zgjëruar edhe pas deklaratës së kryeministres serbe në Bled. Shih, për shembull, Maqedonia ndryshoi emrin dhe ende ka vështirësi në marrjen e datës për fillimin e negociatave, tha kryeministrja serbe në Bled, eMAGAZIN, 29.08.2023.
125 Sonja Kramarska, Maqedonia dhe BE: korniza negociuese shumë e ngushtë për (keq)informim, respublica.edu.mk, 12.04.2023.
126 Formulimi se negociatat janë në „fazë hyrëse", nuk do të thotë se negociatat nuk kanë filluar, sepse tashmë ka ndodhur "miratimi i Kornizës negociuese për negociatat me Maqedoninë e Veriut nga Këshilli më 18 korrik 2022". Sipas kritereve të BE-së, "procesi i shqyrtimit është hapi i parë në negociatat e anëtarësimit", dhe në faqen e internetit të KE-së për Maqedoninë e Veriut (si edhe për Shqipërinë) zyrtarisht thuhet se procesi i shqyrtimit filloi në korrik 2022, menjëherë pas ICG (Konferenca ndërqeveritare për anëtarësimin).
127 Në blogun e Respublika ka edhe një deklaratë të transmetuar gabimisht nga artikulli, kinse autori Dragan Tilev, kështilltar shtetëror për çështje evropiane, ka shkruar si vijon: "A kanë filluar negociatat për anëtarësim?" Po, nga pikëpamja formale juridike, negociatat për anëtarësim ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut filluan zyrtarisht më 19 korrik 2022, shkroi ai në një kolonë. "Por realisht do të fillojnë vetëm pasi të zbatohen ndryshimet kushtetuese", shton Tilev." Pjesa e dytë e deklaratës së pretenduar të Tilevit – "Por realisht do të fillojnë vetëm pasi të zbatohen ndryshimet kushtetuese", nuk gjendet në tekstin e publikuar të Tilevit.
128 Shihni Mariçiq: Më shumë lajmëtarë për procesin e integrimit evropian, më pak hapësirë për keqinformim, ima.mk, 1.04.2023, ku Mariçiq thekson: "Ajo që është e mirë është se Bashkimi Evropian e ka kuptuar si një domosdoshmëri, si diçka që duhet ta bëjë vazhdimisht, për të përsëritur se negociatat kanë filluar".
129 Shihni, për shembull Poligrafi: Pendarovski nuk deklaroi se "njerëzit nga Bullgaria nuk duhej të lejoheshin të kalonin kufirin për të shkuar të adhuronin te varri i Goce Dellçevit", ima.mk, 01.02.2023.
"Poligraf": Kush keqinformoi për praninë e policisë bullgare gjatë festimit të ditëlindjes së Goce Dellçevit në Shkup?, ima.mk, 15.02.2023.
130 Shihni, për shembull, Poligraf: Kush keqinformon për dëbimin e Hebrenjve nga Maqedonia?, ima.mk, 22.03.2023.
131 Shihni Lajmi se pas propozimit të partisë së Petkovit, parlamenti bullgar do të votojë deklaratën për Ilindenin është i rremë, 360 gradë, 23.07.2023.
132 Ndryshe nga tezat e zëvendëskryeministrit Mariçiq se "Në kuadrin e negociatave nuk ka asnjë çështje të vetme që lidhet me historinë dhe Protokollin" (historia dhe protokolli nuk janë pjesë e kornizës së negociatave), përfaqësues të VMRO-DPMNE-së theksuan se protokolli është pjesë e kornizës së negociatave, dhe tregonin se historia nuk duhet të jetë subjekt në kuadrin e negociatave. Gjithashtu u theksua se në kornizën e negociatave përmendet neni 12 i Marrëveshjes së fqinjësisë së mirë, nga i cili "lindin detyrime për komisione të përbashkëta për harmonizimin e historisë", prandaj kërkohej rishikimi i "Marrëveshjes me Bullgarinë".
133 Shihni edhe Zoran Bojarovski, Ka keqinformim se po hiqet lënda e historisë dhe se mësuesit e historisë do të humbasin punën, racin.mk, 26.04.2023.
134 Shihni, për shembull, Përfshirja e Bullgarëve në Kushtetutë është që të riinstalohet Bullgaria si pushtuese në Maqedoni si në vitet 1941-

1944, expres.mk, 19.02.2023; CHEPREGANOV NË ANALIZË TË NOVA MAKEDONIJA: Shqiptarët dhe Bullgarët po punojnë për shkatërrimin dhe ndarjen e Maqedonisë si në 1941, Infomax, 1.03.2023.

135 Shihni për shembull, Aleksandar Litovski, „Dellçevizmi është maqedonizëm“, apla. mk, 03.02.2023: “Kush e bulgarizon historinë maqedonase përmes plagjiaturës ideo-kombëtare nga historiografia bullgare? Kush e bullgarizon vetëdijen kombëtare maqedonase? Kush na bullgarizon si komb? Kush po e bullgarizon të ardhmen maqedonase?

136 Çepreganov: Nëse heqim dorë nga Kryengritja e Ilindenit, për hir të BE-së dhe marrëveshjes për (jo)miqësinë me Bullgarinë, do të përfundojmë në koshin e plehrave të historisë!, expres.mk, 01.08.2023.

137 Për një shembull tjetër Shihni edhe Zharko Trajanoski, Keqinformime historike, manipulime politike dhe polarizimi i ri rreth “Qoses” – simbol i ndarjeve, kërcënimeve, gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit, ima.mk, 22.08.2023.

138 Me thirrjet “Misia, Thrakia, Maqedonia”, si aludime për “tri zonat gjeografike që sipas qarqeve nacionaliste bullgare përbëjnë “Bullgarinë e Madhe”. Në videon në Facebook të kësaj parade, Xhambazki ka shkruar “Një komb! Dy shtete!’’ (FOTO+VIDEO) Festa e Mara Bunevës kaloi pa incidente, por jo pa thirrje dhe retorikë provokuese, 360 gradë, 14.01.2023.

139 Disa media maqedonase gabimisht raportuan se Xhambazki i ka paraqitur këto teza në fjalimin në Shkup.

140 Shihni Provokimet bullgare synojnë të mos bëhen ndryshime në Kushtetutën: Intervistë me Gjorgi Spasov, Nezavisen, 27.01.2023.

141 E majta kërkon shpalljen persona non grata për gjashtë shtetas bullgarë-armiq të popullit maqedonas, Antropol, 16.01.2023.

142 Shihni Sulmuesi i Pendikovit akuzohet se ka shkaktuar lëndime të rënda trupore nga urrejtja, 360 gradë, 8.02.2023.

143 Një deputet bullgar pretendon: Pendikov nuk është shtetas bullgar, por një nga sulmuesit, Fokus, 30.01.2023.

144 Shihni Zoran Bojarovski, Marrëdhëniet maqedono-bullgare vuajtën nga “dashuria” e Moskës, për Delçevin dhe për Bullgarinë e San Stefanos, civilmedia.mk, 06.02.2023.

145 Rumen Radev rikthen në lojë veton për Maqedoninë e Veriut, DW, 09.02.2023: “Aktualisht jemi në gjendje të vetos për anëtarësimin e RS të Maqedonisë në BE, sepse Bullgarët e fqinjit tonë perëndimor ende nuk janë përfshirë në Kushtetutën e saj” (Radev);
“Vetë qeveria në Maqedoni duhet të qëndrojë shumë qartë kundër gjuhës së urrejtjes, e cila çon në përdhosjen e kujtimit të Goce Dellçevit- një revolucionar bullgar që donte ta shihte atdheun e tij të bashkuar” (Jotova).

146 Shihni Dy mite fqinje dhe “ndryshimet tona kushtetuese”, Skopsko eho, 28.02.2023, ku Natasha Kotlar Trajkova pretendon se “insistimi për “ndryshimet kushtetuese” në rrethanat aktuale është qëllim i keq me pasoja edhe më të këqija për shtetësinë dhe identitetin e popullit maqedonas”.

147 “Bujar Osmani me një urim për festën kushtuar Bullgarisë së San Stefanos“, TV Alfa, 03.03.2023

148 Shihni, për shembull, Edhe ushqimi maqedonas qenka bullgare, Sofja promovon “Gjuhën e kuzhinës bullgare”, TV Alfa, 26.05.2023: “Kjo nuk është hera e parë që pala bullgare publikon harta me një Bullgari të Madhe që përfshin edhe Maqedoninë. Por autoritetet në vendin tonë nuk reagojnë. Autoritetet maqedonase heshtën edhe kur ministri bullgar Karakaçanov publikoi hartën e Bullgarisë së Madhe dy vjet më parë me rastin e 8 marsit”.

149 Shihni Sofja e shqetësuar për fatin e klubeve bullgare, DW, 17.03.2023; Bullgaria reagon ashpër për fshirjen e klubit “Ivan Mihajllov”, DW, 23.03.2023.

150 Akuzave të Jotovës për “shkeljen sistematike të të drejtave të Bullgarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Kovaçevski u përgjigj se “diskursi i përdorur nga Bullgaria ndaj Maqedonisë së Veriut është, për fat të keq, shumë i ngjashëm me diskursin e përdorur nga Federata Ruse ndaj Ukrainës”. (VIDEO) Kovaçevski nga Rejkjaviku: Diskursi i Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut është i ngjashëm me atë të Rusisë ndaj Ukrainës, 360 gradë, 17.05.2023).

151 Shihni Në Bullgari dhimbjet fantazmë për Maqedoninë janë të mëdha“ DW, 7.03.2023.

152 Shihni Zharko Trajanoski, Keqinformime historike dhe gjuha “patriotike” e urrejtjes: Pse nuk ka “histori të përbashkët” për “3 Marsin” në Bullgari?, ima.mk, 29.08.2023.

153 Kuptohet, propagandistët pro-rus nuk na informuan fare se Adem Demaçi është fituesi i “Çmimit Saharov për Lirinë e mendimit”, nderimi më i lartë i BE-së, i cili iu dha vitin e kaluar popullit të guximshëm të Ukrainës, dhe më parë ishte

marrë nga Aleksej Navallni, Nelson Mandela, Kofi Annan dhe të tjerë. Kur Adem Demaçi mori këtë çmim të lartë nga Parlamenti Evropian në vitin 1991, ai sigurisht nuk u cilësua si luftëtar për një "Shqipërinë e Madhe", por si "Mandela i Ballkanit" dhe një promovues i përkushtuar i tolerancës dhe pajtimit etnik në Kosovë- me citimet "Kosova u takon të gjithëve" dhe „ne duam një Kosovë të lirë, demokratike dhe multietnike".Edhe Sasho Klekovski, anëtar i KE të VMRO-DPMNE-së, ka publikuar një mendim personal se "Adem Demachi, si fitues i çmimit Saharov të Parlamentit Evropian në vitin 1991, meriton pak respekt".

154 Për lidhjen mes narrativave propagandistike të Beogradit dhe Moskës, pas vizitës së Kurtit, shihni Xhabir Deralla, NARRATIVËT PROPAGANDË: "Mbrojtja vëllazërore" serbe e Maqedonasve nga Shqiptarët, kërcënime për "fatin e Ukrainës" dhe trokitje e armëve, civilmedia.mk, 22.08.2023.

155 Deklaratë e historianit Dr. Milosh Koviq, i cili u citua edhe në lajmet e Sputnik Srbija nga 14.08.2023, ku çështja u trajtua si temë e parë, "Çfarë mesazhi ka dërguar Kurti nga Tetova në Athinë, Shkup, Beograd dhe Podgoricë?": "Kur të heqësh dorë nga interesat jetike kombëtare, dhe nuk ka asgjë më thelbësore se emri i vendit dhe gjuha, atëherë nuk ka fund. Dhe kam frikë se kjo lloj përmbushjeje e të gjitha kërkesave të parashtruara ndaj Maqedonisë së Veriut çon në anulimin së pari të shtetit maqedonas, e më pas të identitetit kombëtar maqedonas", tha Koviq në lajmet e Sputnik Srbija.

156 Në mbrëmjen e 14 gushtit 2023, Sputnik Srbija publikoi një rrëfim konspirativ të frikshëm Si futet Shqipëria e Madhe në Transversalin e gjelbër.

157 Ismail: Brigadën e dytë maqedonase e riemërtuat me bashkëpunëtorët e lëvizjes fashiste - Adem Demaçi, Antropol, 16.09.2023.

158 Shihni Mojsoska: Hyrje në një komunitet evropian të mbërthyer në dekadencën e tij – FALEMINDERIT, JO!, Opserver, 22.09.2023: "Bashkimi Evropian, i cili është thellësisht i përfshirë në rehabilitimin e fashizmit dhe nazizmit, është qartazi një mbështetës AKTIV i Sofjes supremaciste."

159 Për "fitimet" nga "të dyja anët e gardheve etno-politike" pas vizitës së Kurtit, shihni Xhabir Deralla, "Mirësevini në një festë private", civilmedia.mk, 14.08.2023.

160 Shihni "Ditët e Albin Kurtit në Maqedoni, ndryshime kushtetuese dhe zgjedhje të shpejta të jashtëzakonshme", Veçer, 14.08.2023: Thua Kurti, me këtë vizitë provokuese, qëllimisht (me urdhër) apo rastësisht (nga çmenduria) në këtë çast i ka varrosur ndryshimet kushtetuese, ndoshta nuk do ta dimë kurrë.

2. NDRYSHIMET KUSHTETUESE NË ALGORITMIN DEZINFORMATA – URREJTJE – POLARIZIM

Shkruan: Zoran Bojarovski

Gjuha e urrejtjes është ushqim i politikës së jo-kulturës, kurse ata që e prodhojnë dhe ushqehen me të deri në ekstrem e polarizojnë diskursin publik. Kështu mundet të definohet gjendja me valën e pandalshme të gjuhës së urrejtjes, edhe pse kanë kaluar 15 vite që kur është regjistruar si kërcenim sistemik për demokracinë dhe praktikat e mira të politikës, dhe që kur u mbajtën mijëra punëtori, seminare, samite, konferenca për njohjen, dhe identifikimin e gjeneratorëve të urrejtjes, dhe rekomandime për shuarjen tij.

Ajo gjendje del nga algoritmi dezinformata > gjuhë e urrejtjes > polarizim dhe pasqyrohet e përkeqësohet me çdo rast, proces, apo ngjarje të re, për dikë nga fabrikat e urrejtjes do ta vlerësojnë që duhet të jenë "të ndotur" me gjuhën e urrejtjes. Dhe pothuajse nuk ka përjashtim, që, nga ana tjetër, flet për faktin se gjuha e urrejtjes u bë mjeti i rregullt për rrënim, korruptim, obstruksion, minim të proceseve shoqërore apo politike.

Për problemin me gjuhën e urrejtjes mund të thuhet që veçmë është problem sistemik.

Gjuha e urrejtjes (dhe krimet e urrejtjes) është fenomen qe ka trend të përkeqësimit dhe rritje në dy-tri vitet e fundit. Arsyeja kryesore edhe më tej qëndron te pandëshkueshmëria, edhe pse janë miratuar ndryshime në legjislacion, si edhe mosnjohja dhe mosparaqitja tek institucionet përgjegjëse. Kjo konstatohet në raportin e fundit të "Metamorfozis" për respektimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut "Të drejtat bazike - Kornizë ka, implementimi është i ndryshueshëm, gjithkund duhen më shumë të holla"[1]

Prej vitit 2020 rritet numri i rasteve

Gjuha e urrejtjes rritet nga viti në vit, dhe rritje drastike, për afro 160 për qind, është regjistruar nga organizatat joqeveritare në kalimin nga 2019 në vitin 2020, në fillim të pandemisë Covid-19, dhe tendencë nuk ndërpre, gjegjësisht, po regjistrohet edhe sot. Sipas ekspertëve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHDNj), nga viti 2014 deri në 1.6.2022 janë të regjistruara 3.046 raste të gjuhës së urrejtjes.

Regjistrimi i këtyre rasteve mund të shihet në platformën në internet për raportimin e gjuhës së urrejtjes, që është vendosur në vitin 2014 nga ana e KHDNj, me ndihmën e NED-it amerikan, "Gjuha e urrejtjes", (govornaomraza.mk)[2] Ato 3.046 raste që janë regjistruar që nga atëherë janë raste të pastra të gjuhës së urrejtjes në 14 baza të ndryshme që i njeh ligji, dhe vlen të theksohet që janë të kontrolluara dhe të filtruara nga numri i paraqitjeve që është shumë më i madh, prandaj nuk ka dyshim që bëhet fjalë për raste të gjuhës së urrejtjes.

Nga kjo statistikë, si baza më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes veçohen përkatësia etnike me 1.477 raste ose 37 për qind, përkatësia politike me 922 raste apo 23 për qind, përkatësia gjinore apo seksuale me 901 raste apo 23 për qind, gjinia dhe seksi me 238 raste apo 6 për qind.

Gjuha e urrejtjes mund të haset gjithkund, por platformat më të shpeshta të shpërndarjes janë rrjetet sociale. Sipas rangimit të ekspertëve, më së paku ka në mediat tradicionale, kurse shumë më tepër në mediat onlajn, por definitivisht si platforma "mbjellëse" të gjuhës së urrejtjes, keqpërdoren "Fejsbuku", "Jutjubi", dhe kohën e fundit "Tik-toku", thuhet në raportin e "Metamorfozis".

Trendi në rritje konfirmohet edhe nga statistikat që i bën Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Vetëm nga viti 2021 deri në janar të vitit 2022, Komisioni ka marrë 14 vendime për format e kryera të diskriminimit përmes gjuhës së urrejtjes ose gjuhës shqetësuese të shprehura përmes mjeteve të informimit/mediave publike, kryesisht përmes rrjeteve sociale "Fejsbuk dhe "Tuiter". Gjuha e tillë u drejtohej personave që i përkasin një grupi të margjinalizuar, dhe i referohen orientimit seksual, pra në bazë të seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor. Në bazë të origjinës kombëtare ose etnike, prejardhjes, aftësive të kufizuara, gjendjes familjare ose martesore e të tjera janë konstatuar edhe shtatë raste të tjera, ku është konstatuar gjuhë shqetësuese ose diskriminuese, kështu që në total janë mbi 20 raste të tilla në vitin 2021, vetëm me mjete të informimit/mediave publike, përfshirë rrjetet sociale.

Mirëpo, numri rritet në mënyrë dramatike në vitin 2022, Komisioni në raportin e tij tremujor për periudhën janar-mars 2022[3] paraqet të dhëna se deri në 50 për qind e ankesave ku është konstatuar diskriminim, pra 13 ankesa, i referohen diskriminimit të kryer përmes mjeteve të informimit publik/mediave, dhe numri më i madh i tyre i referohen rrjetit social "Fejsbuk".

Nëse merren parasysh rastet e regjistruara nga shoqatat e gazetarëve në një apo dy vitet e fundit dhe organizatave tjera joqeveritare (për shembull, vetëm "Metamorfozis" ka regjistruar rreth dhjetë raste të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së krimeve të urrejtjes ndaj punonjësve të tij), është mjaft e qartë madhësia e problemit me të cilën përballet shoqëria.

Gjuha e urrejtjes "sponsorizohet" nga zyrtarë të lartë dhe figura publike

Në një analizë të mëparshme mbi gjuhën e urrejtjes për "propozimin francez", Instituti për Media dhe Analitikë (IMA), "Propozimi francez: Gjuha e urrejtjes, dezinformata, manipulime mediatike"[4], në kapitullin "Shpërthimi i gjuhës së urrejtjes gjatë debatit publik" rreth 'propozimit francez'", u konstatua se debati ditor politik për të ashtuquajturin "propozim francez" për tejkalimin e kontestit me Bullgarinë dhe vetos për fillimin e negociatave të Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në Bashkimin Evropian, e ndezi gjuhën e urrejtjes në publik, media dhe në rrjetet sociale.

Të tilla fenomene morën hov bashkë me tensionet kur ky proces arriti kulmin, pra, vitin e kaluar, përgjatë debatit për "propozimin francez". Analiza identifikoi karakteristikat dhe elementet e gjuhës së urrejtjes që mbizotërojnë në diskursin publik dhe se si ato u reflektuan në mjedisin aktual të komunikimit në vend në kontekstin e kornizës së

propozuar për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE, pra, "propozimin francez", i cili u pranua gjerësisht si term në diskursin publik.

Në analizën e IMA-s, u konstatua se zyrtarë të lartë të partisë "Levica" (E Majta) gjuhën e urrejtjes e kanë mbartur nga mediumet dhe rrjetet sociale në paraqitjet publike qëkur bënë thirrje për radikalizim (Apasiev propozon radikalizimin e opozitës me protesta, bllokada dhe paralizim të parlamentit[5]), dhe më pas me retorikë të hapur të urrejtjes ndaj presidentit të shtetit Pendarovski (Apasiev e shan publikisht Pendarovskin[6]), pasi kreu i shtetit deklaroi në Samitin e NATO-s në Madrid se propozimi i modifikuar francez është "shumë më i mirë për ne krahasuar nga ai i mëparshmi". Kjo vetëm u dha një shtytje ndjekësve të Apasievit në rrjetet sociale, veçanërisht pasi ai "shpërtheu" me fjalë të pahijshme edhe ndaj disa gazetarëve që shprehën mendimin për "propozimin francez" (Zyrtarët e "Levicës" me etiketa, gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime për ta vënë në "listë" gazetarin Popetreski[7])

Të gjitha këto dukuri kanë ardhur si pasojë e gjuhës urrejtjes, e cila nga rrugët ka kaluar edhe në Kuvend, e ushqyer vazhdimisht nga shkëmbimi masiv i urrejtjes së qytetarëve të polarizuar në rrjetet sociale (Debat rrugësh në Kuvend: Deputetët e LSDM-së janë frikacakë, e ata nga VMRO-DPMNE janë për trajtim në Demir Hisar[8]).

Veçanërisht brengosëse ishin dukuritë e gjuhës më të theksuar të urrejtjes dhe ndarjeve në plan të brendshëm ndërmjet dy grupeve më të mëdha etnike (Mllefi nga propozimi francez derdhet mbi bashkëjetesën[9]).

Instituti për Media dhe Analitikë IMA ka regjistruar se nga gjuha e urrejtjes nuk janë kursyer as zyrtarët e lartë të BE-së, të cilët erdhën në Maqedoninë e Veriut me mesazhe se gjuha maqedonase qëndron pa kualifikim nga BE-ja në propozimin e ndryshuar të kornizës së negociatave dhe se e ardhmja e Maqedonisë së Veriut është në Bashkimin Evropian, si dhe se Evropa nuk është e tërë pa Maqedoninë e Veriut (Sulme të orkestruara me gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata ndaj Fon Der Lejen dhe BE30[10]).

Për këtë ka reaguar Komisari Evropian për Zgjerim dhe Fqinjësi Oliver Varheji, i cili në një intervistë për "Euraktiv"[11] i ka bërë thirrje opozitës në Maqedoninë e Veriut të kthjellet, me mesazhin se "djegia e dokumenteve në sallën plenare, shtyrja e njerëzve në dhunë dhe nxitja e urrejtjes nuk sjell asgjë përveç dëmit."

Komiteti i Helsinkit reagoi ndaj përshkallëzimit të dhunës dhe gjuhës së urrejtjes duke "dënuar çdo akt dhune dhe çdo fjalë urrejtjeje, si dhe nxitjen dhe thirrjet për dhunë[12]", si të dëmshme tej mase dhe në kundërshtim me vlerat e një shoqërie demokratike. Komiteti i Helsinkit njohu se gjuha e urrejtjes është marrë përsipër nga politikanët dhe personat publik dhe u bëri thirrje atyre "të kenë kujdes në lidhje me gjuhën që përdorin në adresimin e tyre ndaj publikut dhe që mediat të raportojnë ngjarje të udhëhequra nga parimet e objektivitetit dhe paanshmëri në raportim". Në këtë kontekst, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi njoftoi se janë dorëzuar rreth dhjetë paraqitje për dëshmim të diskriminimit në bazë etnike në opinionet e publikuara në rrjetet sociale (Dhjetëra raporte për gjuhë të supozuar të urrejtjes ndaj bullgarëve në vend[13]).

Dhe kur u konsiderua se kulmi i gjuhës së urrejtjes u arrit vitin e kaluar gjatë protestave në rrugë kundër "propozimit francez", ai shpërthim i gjuhës së urrejtjes u përhap edhe më pas në debatin publik për ndryshimet kushtetuese, të cilat synojnë të ndryshojnë Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut me amendamente kushtetuese për përfshirjen e bullgarëve në Preambulën e aktit kushtetues të shtetit.

Reagimet dhe apelet nuk ndihmuan. Gjuha e urrejtjes ishte një "shoqërues" i fuqishëm i debatit për marrëdhëniet me Bullgarinë dhe i obstruksioneve të këtij vendi në procesin e qasjes të vendit tonë për anëtarësim në BE edhe në këtë fazë të këtij procesi - veçanërisht në episodet "Protokolli", " Klubet bullgare në Maqedoni", "Përcaktimi i ndryshimeve kushtetuese nga grupi i ekspertëve" dhe në disa të tjera.

Dezinformatat për Protokollin e ndërmjetësuar nga BE-ja për zbatimin e Marrëveshjes për Miqësi ndërmjet Maqedonisë dhe Bullgarisë gjeneruan urrejtje

Se sa e rëndësishme dhe e ndjeshme është çështja e gjuhës së urrejtjes në marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, dëshmon Protokolli[14] për zbatimin e Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim ndërmjet dy vendeve, në të cilin kjo temë dhe rekomandimet lidhur me këtë kanë një kapitull të veçantë.

Protokolli u nënshkrua më 17 korrik 2022 në Sofje nga ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani dhe shefja e atëhershme e diplomacisë së Bullgarisë, Teodora Gençovska. Nënshkrimi i Protokollit dhe mbajtja e mbledhjes së komisionit ndërqeveritar pasoi pasi "propozimi francez" u miratua nga Qeveria, pas miratimit të konkluzioneve në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut.

Në protokoll, mes tjerash, mbi gjuhën e urrejtjes, në mënyrë shtesë parashikohet që shtetet do të marrin masa efektive për parandalimin e propagandës keqdashëse nga institucionet dhe agjencitë dhe do të dekurajojnë aktivitetet e subjekteve private që synojnë nxitjen e dhunës, urrejtjes apo aktivitete të tjera të ngjashme, të cilat do të dëmtonin marrëdhëniet mes tyre.

"Të dy shtetet, përmes kanaleve diplomatike ndërmjet ministrive të punëve të jashtme, të vazhdojnë të shkëmbejnë informacione në lidhje me gjuhën e urrejtjes, mbishkrimet dhe tabelat e identifikuara në ndërtesat dhe monumentet publike, tekstet në librat shkollorë dhe materialet mësimore, si dhe në hapësirën publike në territorin e shtetin tjetër dhe të informojnë brenda një periudhe të arsyeshme kohore që shteti përkatës të marrë masa për heqjen e menjëhershme të rasteve të identifikuara të gjuhës së urrejtjes", thuhet në Protokollin.

Ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, pas nënshkrimit të Protokollit Bilateral, tha se përmes këtyre pikave të Protokollit, ministritë përmes trupave të posaçëm punues do të monitorojnë trendin dhe nëse shohin se dikush po provokon qëllimisht, do t'i informojnë institucionet kompetente.

Por kjo nuk ndihmoi shumë. Së shpejti u shfaqën postime me frekuencë të madhe reagimesh dhe komentesh që shpërndanin dezinformata, në të cilat ngjitej gjuha e urrejtjes, e cila polarizoi edhe më shumë opinionin maqedonas.

Portali Vërtetmatësi (Vistinomer[15]). si shembull tipik i dezinformatave që prodhuan një sasi të madhe të gjuhës së urrejtjes, ka analizuar një postim në rrjetin social Fejsbuk, ku gabimisht pohohet se Protokolli parashikon prishjen e monumenteve që nuk miratohen nga Bullgaria, se i gjithë dokumentacioni nga arkivat në Maqedoni nga viti 1945 deri në vitin 1990 do të çohet në Bullgari ose se do të ketë dënime me burg për "shprehje" kundër bullgarëve.

Kontrolluesit e pavarur të fakteve në analizë dëshmojnë se asgjë nga këto nuk është e vërtetë, ashtu siç nuk është e vërtetë që tekstet e reja do të miratohen në Bullgari ose

se Maqedonia do të duhet t'i kërkojë falje Bullgarisë për persekutimin e bullgarëve në Maqedoni nga komunistët.

Në recensionin e postimit të mbushur me dezinformata, Vistinomer.mk i referohet edhe insinuatave se Protokolli parashikon se librat, filmat dhe veprat e tjera artistike të pamiratuara nga Bullgaria do të ndalohen dhe se të gjithë librat dhe filmat e rinj të ardhshëm do të duhet të miratohen në Sofje.

Kjo gjithashtu nuk është e vërtetë, pasi nuk ka një dispozitë të tillë në Protokoll. Të dy shtetet vetëm garantojnë se financimi shtetëror i librave të rinj, dokumentarëve dhe revistave, filmave dhe prodhimeve të tjera artistike, si dhe i monumenteve e festimeve të kulturës, do të realizohet në frymën e Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim, dhe në këtë kontekst me vëmendjen e nevojshme ndaj të gjitha formave të gjuhës së urrejtjes.

Për më tepër, një dispozitë e tillë nuk është e mundshme, sepse në Maqedoninë e Veriut, në Kushtetutë[16], në nenin 16, "liria e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit është e garantuar. Garantohet liria e fjalës, paraqitja publike, informimi publik dhe krijimi i lirë i institucioneve për informim publik. Censura është e ndaluar".

Sipas fakteve të deklaruara, pretendimet e shprehura në postim janë tendencioze dhe të pavërteta, është konstatuar në analizën e Vistiniomer.mk, por kjo nuk e ka ndalur gjuhën e urrejtjes që nxitet me këtë dhe postime të tjera të ngjashme.

Klubet bullgare bashkërisht me gjuhën e urrejtjes kanë sjellë edhe vepra penale të urrejtjes

Klubet dhe shoqatat bullgare që filluan të krijohen në kulmin e marrëdhënieve të acaruara maqedono-bullgare sollën një valë të re të gjuhës së urrejtjes, por edhe një valë dhune, e cila u bë veçanërisht shqetësuese.

Në hapjen e klubit të parë kulturor të bullgarëve në Manastir të quajtur "Ivan (Vanço) Mihailov", më 16 prill 2022, morën pjesë edhe krerët e atëhershëm të qeverisë bullgare, të kryesuar nga Kiril Petkov si kryeministër.

Ngjarja shkaktoi pakënaqësi të madhe në opinionin maqedonas, më së shumti për faktin se klubi kulturor në Manastir mban emrin e një personi që njihet si negativ në lidhje me historinë dhe luftën revolucionare maqedonase dhe si personazh që ka bashkëpunuar me fashistët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ka pohuar se maqedonasit janë bullgarë.

Më 3 qershor 2022, u dogj porta e klubit në Manastir. Për këtë u akuzua këngëtari Llambe Allabakoski, e pas kësaj filloi një procedurë gjyqësore, e cila përfundoi më 27 shtator të të njëjtit vit me dënim me kusht prej gjashtë muajsh, i cili nuk do të zbatohet nëse Allabakoski nuk kryen vepër të re në dy vitet e ardhshme.

Tensionet e shkaktuara nga këto ngjarje nuk pushuan të nxiten edhe gjatë periudhës në vijim, gjatë së cilës u organizuan më shumë takime dhe u publikuan më shumë deklarata që supozohej se do të deeskalojnë situatën.

Por në vend që kjo të ndodhte, pati disa deklarata të eurodeputetit bullgar Angell Xhambaski, duke përfshirë edhe atë se ai do të drejtojë personalisht një delegacion bullgar për të festuar ditëlindjen e Goce Dellçevit më 4 shkurt.

Për këtë reagoi kryeministri Kovaçevski, i cili deklaroi se "incidentet dhe provokimet mes dy vendeve janë shkaktuar qëllimisht nga ata që nuk duan që ne të bëhemi anëtarë të BE-së", ndërsa ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, tha se, "për herë të fundit do të hyjë në vend kushdo që i quan maqedonasit bullgarë ose thotë se Maqedonia e Veriut është bullgare".

Kësaj vale të tensioneve të rënda në marrëdhëniet maqedono-bullgare i parapriu incidenti në Ohër, kur më 19 janar 2023 u sulmua dhe u rrah sekretari i klubit vendor bullgar "Car Boris Treti", Hristijan Pendikov. Bullgaria akuzoi menjëherë për shkeljen e të drejtave të bullgarëve në Maqedoni, si dhe pati kërcënime për bllokimin e negociatave me Bashkimin Evropian. Incidenti u dënua nga udhëheqësit maqedonas dhe bullgarë dhe Bullgaria dërgoi një aeroplan qeveritar për ta çuar Pendikovin në Sofje për trajtim, gjë që shkaktoi gjuhë të urrejtjes edhe më tej.

Ndërkohë, në rrjetet sociale fondacioni bullgar "Maqedonia" veçmë kishte bërë thirrje për një vizitë të organizuar të bullgarëve te varri i Goce Dellçevit në kishën "Shën. Spasi" në Shkup më 4 shkurt dhe si kundërpërgjigje e drejtpërdrejtë ndaj këtij provokimi ka ardhur edhe reagimi i Aleksandar Pandovit nga VMRO-DPMNE, i cili në profilin e tij në Fejsbuk ka njoftuar se maqedonasit do të jenë në kishën "Sveti Spas" duke filluar nga mëngjesi.

Protesta pati edhe në hapjen e klubit bullgar "Car Borisi i Tretë" në Ohër, ndërsa disa ditë më vonë u dëmtua tabela me emrin e klubit.

Protesta u organizua nga "Levica" dhe u mbështet nga VMRO-DPMNE. Atëherë, edhe komuniteti hebre në Maqedoni doli me qëndrimin se ishin tmerruar nga "lavdërimi i fashizmit dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes".

Në këtë drejtim, deputetët në Kuvendin e Maqedonisë filluan iniciativën për kufizimin e të drejtës së shoqatave për të zgjedhur emrat që lidhen me fashizmin.

Gjuha e urrejtjes nuk e ka anashkaluar debatin për ndryshimet kushtetuese

Fatkeqësisht, shumë e pritshme, gjuha e urrejtjes nuk e ka anashkaluar debatin për ndryshimet kushtetuese, kur ato hynë në fazën e përcaktimit të amendamenteve për përfshirjen e bullgarëve në Kushtetutë.

Një nga karakteristikat tipike të gjuhës së urrejtjes në mediat sociale janë komentet dhe kërcënimet seksiste, të cilat gjithmonë fokusohen tek vajzat dhe gratë që janë të zëshme dhe aktive kur bëhet fjalë për këto apo procese të tjera politike.

Deputetja dhe kryetarja e partisë politike të LDP-së, Monika Zajkova, ishte shënjestër e gjuhës së urrejtjes dhe sulmeve seksiste me një lajm të sajuar gjoja të publikuar nga portali i javores Fokus[17].

Ekipi monitorues i organizatës Civil e përgënjeshtroi këtë përmbajtje dhe bëri të ditur se Fokus për CIVIL Media konfirmoi se një përmbajtje e tillë nuk ishte publikuar në faqen e tyre dhe se logoja e faqes ishte keqpërdorur.

Dezinformata të tilla dhe sulme seksiste pasuan deklaratën e Zajkovës se është me origjinë nga Kukushi, flet gjuhën maqedonase dhe do të jetë gjithmonë maqedonase krenare.

Pak më vonë, kur me iniciativë dhe propozim të Qeverisë u formua grupi i ekspertëve që duhej të përgatiste tekstin e amendamenteve të Kushtetutës, me të cilat bullgarët duhet të përfshihen në kushtetutën e shtetit (Propozimi për qasje në Ndryshime të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Udhëzim për ndryshimin dhe plotësimin e kushtetutës[18]), as ekspertët e propozuar nuk u kursyen nga gjuha e urrejtjes.

Vetë titujt e teksteve për anëtarët e grupit të ekspertëve të propozuar nga Qeveria, i cili duhej të përcaktonte ndryshimet kushtetuese, nxisnin gjuhën e urrejtjes. Për shembull ky: Ja kush do t'i vendosë bullgarët në Kushtetutë: Mes të ashtuquajturve ekspertë ka gjithçka, por jo profesorë të së drejtës kushtetuese[19].

Një shënjestër e veçantë e botëve dhe trollëve partiakë në rrjetet sociale ishte profesoresha Dr. Ana Çupeska nga Fakulteti Juridik në Shkup, ndaj së cilës kishte gjuhë masive urrejtjeje që nxiti VMRO-DPMNE-në me dezinformatat se Çupeska mbështet arrestimin dhe burgosjen e gazetarëve dhe se ajo nuk është kompetente për të shkruar amendamente kushtetuese[20].

Nuk janë kursyer nga gjuha ekstreme e urrejtjes as aktivistët e shoqërisë civilë, madje edhe nga kërcënimet dhe thirrjet e hapura për dhunë fizike. Kryetari i Civilit, Xhabir Deralla, është në shënjestër të vazhdueshme të gjuhës së urrejtjes, por këtë pranverë, ndërsa proceset për përcaktimin e ndryshimeve kushtetuese po përshpejtoheshin, ndaj Derallës janë drejtuar kërcënime serioze dhe gjuhë urrejtjeje.

Në reagimin e Civilit "Gjuhë e urrejtjes, gënjeshtra dhe kërcënime ndaj kryetarit të CIVIL-it, Xhabir Derallës[21]", në përgjigje të gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve, theksohet se "është e qartë se këto sulme aq sa kanë për qëllim Derallën, ato janë drejtuar edhe kundër organizatës CIVIL dhe platformës së saj mediatike. Dihet se CIVIL si organizatë promovon të drejtat e njeriut, demokracinë, multikulturalizmin, vlerat evropiane dhe orientimin euroatlantik të vendit. CIVIL është një nga organizatat më relevante për luftimin e dezinformimit, propagandës dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe një organizatë me reputacion për monitorimin e proceseve zgjedhore dhe kontrollin e armëve. Së këndejmi, sulme të tilla të orkestruara synojnë pikërisht kundër vlerave dhe veprimeve të CIVIL-it dhe me këtë ushtrohet presion edhe ndaj qytetarëve që të mos guxojnë të shprehin mbështetjen publike për organizatën".

Gjuha e urrejtjes rreth fushave sportive

Ekipi monitorues i organizatës Civil ka monitoruar edhe gjuhën e urrejtjes agresive dhe të dhunshme që u shfaq në prag, gjatë dhe pas ndeshjes së futbollit ndërmjet ekipeve të Shkupit dhe Levskit.

Gjuha e urrejtjes dhe dhuna që shkaktoi nuk mund të përjashtohen nga situata dhe imazhi i përgjithshëm i këtij fenomeni të temave që kanë të bëjnë me marrëdhëniet maqedono-bullgare dhe miratimin e amendamenteve kushtetuese.

Në një atmosferë kaq të ndezur dhe të polarizuar, kanë ndodhur edhe skena të pakëndshme dhe të dhunshme të shkaktuara nga tifozët e të dy klubeve.

Në raportin e ekipit të monitorimit të Civilit[22], thuhet se "tifozët e klubit bullgar Levski, të cilët ende nuk kishin arritur në ndeshjen e futbollit mes Levskit dhe Shkupit, veçmë kanë filluar të provokojnë në rrjetet sociale se do ta djegin flamurin maqedonas dhe atë shqiptar në tribunat e stadiumit Todor Proeski në Shkup. Me këtë, nacionalistët bullgarë të veshur me kanotiere huliganësh vetëm dëshmuan se duan të shkaktojnë tensione etnike nga të cilat do të përfitojnë vetëm politikanët bullgarë (dhe një pjesë e maqedonasve) që po bllokojnë rrugën e Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian".

Epilogu i kësaj gjuhe të urrejtjes në prag të ndeshjes rezultoi me dhunë fizike dhe kacafytje mes tifozëve. I tillë ishte incidenti në lagjen Çair të Shkupit, i cili pati një ndikim të madh në mediat maqedonase dhe bullgare. Lidhur me këtë incident, Prokuroria Themelore Publike ka lëshuar një komunikatë[23] në të cilën thuhet:

"Sipas informacioneve fillestare, ngjarja ka ndodhur teksa tifozët e KF "Levski" me dy automjete me targa bullgare kanë qenë duke lëvizur në afërsi të qendrës tregtare "Çairçanja", ku janë zënë verbalisht me kalimtarët dhe qytetarët. Tifozët bullgarë kanë ndaluar automjetet dhe kanë zbritur prej tyre, gjë pas së cilës debati verbal është shndërruar në përleshje fizike me një grup qytetarësh të cilët kanë dalë nga ndërtesat përreth. Gjatë kthimit në makinë, një shtetas bullgar 29-vjeçar ka mbetur i plagosur me një mjet të mprehtë në bark. Tek ai janë konstatuar lëndime të rënda trupore dhe është shtruar në spital. Pas ndërhyrjes kirurgjikale ndodhet në gjendje stabile", kumtoi Prokuroria.

Më pas, para fillimit të ndeshjes jashtë stadiumit të qytetit, ata kanë vazhduar me dhunë verbale dhe fizike, ndërsa brenda stadiumit kanë kënduar këngë kundër maqedonasve dhe shqiptarëve: "Vrit, vrit, vrit Shi.tarë".

Mbi këto ngjarje reagoi edhe Instituti për Media dhe Analitikë (IMA)[24], nga ku theksuan se "gjuha e urrejtjes para, gjatë dhe pas garave sportive shkakton dëme të shumëfishta dhe nxit dhunë. Instituti për Media dhe Analitikë IMA dënon gjuhën e urrejtjes dhe dhunën para dhe gjatë ndeshjes së futbollit në Shkup ndërmjet klubeve të futbollit Shkupi dhe Levski".

Në reagimin e tyre, IMA u bën thirrje institucioneve kompetente që të marrin masa ndëshkuese, si dhe masa të tjera që do të parandalojnë përsëritjen e gjuhës së urrejtjes dhe dhunës që ajo nxit në të ardhmen, si dhe u bëri thirrje politikanëve dhe mediave që të dënojnë publikisht gjuhën e urrejtjes.

Emërtimi ("Name calling") në rrjetet sociale është mjet kryesor për nxirje, frikësim dhe heshtje të kundërshtarëve

Mjeti kryesor që përdorin protagonistët e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale dhe në portalet e mediave tradicionale, me të cilat shajnë, shpifin, frikësojnë dhe tentojnë të mbyllin gojën e kundërshtarëve nga të dyja palët, janë emërtimet fyese, pra atributet nënçmuese.

Më të njohurit dhe më të shpeshtët janë epitetet "severxhan/severxhanë" ose "vmron/vmronë".

Por kur shteren këto ofendime me origjinë «ideologjiko-partiake», vijnë në radhë pjesa tjetër "tradicionale" e emërtimeve perbuzës si «komunjarë", "hajdutë", "hohshtaplerë", "pështyrës", "analfabetë", "të palarë", që pasohet me fyerje në llogari të fesë, përkatësisë etnike, orientimit seksual, kombësisë...

Jo rrallëherë ka përdorim të gjuhës që, bashkë me ofendimet, kërkon qërim hesapesh dhe likuidim fizik.

Një sërë analistësh tregojnë se ky trend është në rritje dhe se lidhet drejtpërdrejt me nevojën e qendrave politike të pushtetit për të shkëputur vëmendjen e publikut nga një sërë problemesh reale nga sfera ekonomike dhe sociale ose për ta drejtuar atë në tema që janë të lidhura me partinë dhe jo të interesit publik.

Fatkeqësisht, për shkak të gjerësisë dhe intensitetit të gjuhës së urrejtjes të orkestruar nga qendra të ndryshme të fuqisë me trollë në rrjetet sociale, ne tashmë kemi breza të rinj që rriten në një jetë të përditshme ku urrejtja është "normale" dhe të cilët në mënyra të ndryshme sugjerojnë që shkelja e dinjitetit dhe individualitetit bazë njerëzor të tyre apo të tjetrit, është diçka e zakonshme.

Pavarësisht nga intensiteti i gjuhës së urrejtjes, rekomandimet janë që proporcionaliteti i masave për trajtimin e saj duhet të jetë i njëjtë, nëse jo më i madh.

Rekomandimi mbetet që publikimet me përmbajtje me gjuhë të urrejtjes duhet të moderohen sipas Udhëzimeve për Raportim Etik të Mediave Onlajn në Maqedoninë e Veriut të Këshillit për Etikën e Mediave në Maqedoni (pika 10.4).

Por megjithëse rekomandimi thotë se "mediat onlajn janë përgjegjëse për shqyrtimin e rregullt dhe heqjen e menjëhershme të komenteve të përdoruesve të postuara nën përmbajtje gazetareske në faqet e internetit ose në rrjetet sociale që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe që kanë potencial të shkaktojnë pasoja të dëmshme në shoqëri" –është i vogël numri i mediave që e bëjnë këtë. Ndoshta në përpjekje për më shumë lexues, për çka kontribuojnë diskutimet me komente të shumta që rrisin shikueshmërinë e postimeve, mediat harrojnë detyrat e tyre etike. Disa prej tyre e justifikojnë këtë me mungesën e resurseve njerëzore për moderimin e duhur të posteve të tyre.

Cilido qoftë shpjegimi apo arsyetimi, dëmtimi i interesit publik dhe shëndetit mendor të shoqërisë do të jetë i pariparueshëm nëse nuk merren masa konkrete, të përshtatshme dhe të vazhdueshme sa më shpejt të jetë e mundur për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase këtij problemi serioz.

Gjuha e urrejtjes dhe propaganda keqdashëse shkojnë dorë për dore

Çdo veprim i sjelljes destruktive nuk i bën mirë askujt, përveç atyre që e përdorin këtë mjet tinëzar për qëllime të pista.

Gjuha e urrejtjes dhe veprat e urrejtjes janë të ndërlidhura dhe përfaqësojnë një kërcënim për të drejtat dhe liritë e njeriut, por edhe për zhvillimin, sigurinë dhe stabilitetin e një shoqërie demokratike.

Ballafaqimi me gjuhën e urrejtjes, marrja e masave efektive për parandalimin e propagandës keqdashëse nga institucionet dhe agjencitë, si dhe dekurajimi i aktiviteteve të subjekteve private, mund të jetë problematik në procesin e qasjes të Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE - përderisa nuk merren masa të tilla.

Fakti që termi "gjuhë e urrejtjes" është përfshirë në dy grupime dhe përmendet 18 herë në Raportin e Komisionit Evropian për përparimin e Maqedonisë së Veriut në procesin e integrimit evropian për vitin 2022[25], tregon se sa e rëndësishme është kjo çështje.

Me këtë, Komisioni Evropian e veçoi gjuhën e urrejtjes si temë veçanërisht aktuale, për të cilën janë formuluar disa rekomandime.

Dilema që mund të shihet këtu është nevoja për të përcaktuar (definuar) se çfarë është propaganda keqdashëse dhe vendosja institucionale dhe përgjegjësia për përcaktimin e saj, bëri me dije Radio Evropa e Lirë në një nga analizat e saj me titullin indikativ "Amendamentet kushtetuese janë vetëm një nga pengesat e mundshme drejt Hyrja në BE". [26]

"Sa i përket gjuhës së urrejtjes, e sidomos duke pasur parasysh aktualitetin dhe ashpërsinë e situatës me gjuhën e urrejtjes nga të dyja palët, nevojitet një reagim i menjëhershëm i MPJ-së në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë, përfshirë edhe Avokatin e Popullit, për të filluar komunikimin me Agjencinë Evropiane për të Drejtat Themelore, me qëllim të shfrytëzimit të ekspertizës, këshillave dhe udhëzimeve të saj për të krijuar një mekanizëm funksional gjithëpërfshirës me respektim të plotë të të gjitha normave ndërkombëtare dhe sigurimin e mbrojtjes së lirisë së mendimit dhe fjalës", tha Zoran Neçev nga Instituti për Demokraci në analizën e Radios Evropa e Lirë.

Në vend, gjuha e urrejtjes trajtohet sipas Ligjit Penal apo konventave ndërkombëtare, sipas të cilave ballafaqimi me gjuhën e urrejtjes duhet të jetë kujdes prioritar i çdo shteti dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për vendin tonë dhe procesin e integrimit evropian.

"Veprimi ndaj gjuhës së urrejtjes do të jetë pjesë e kushteve, por kur flasim se cila gjuhë e urrejtjes është më e dëmshme, atëherë së pari: është ajo ndaj së cilës nuk veprohet dhe, e dyta, është ajo që vjen nga përfaqësuesit zyrtarë të shtetit. Dhe për këtë arsye deklaratat e qytetarëve në rrjetet sociale apo në publik janë pjesë e "zhurmës së madhe", por janë të parëndësishme për procesin e integrimit evropian. Nëse ajo gjuhë vjen nga përfaqësues politikë, deputetë apo nga kreu i shtetit, atëherë është gjuhë e dëmshme që e prish procesin", thotë Andreja Stojkovski nga Prespa Instituti në të njëjtën analizë të Radios Evropa e Lirë.

Sulmet ndaj bullgarëve të Maqedonisë dhe qendrave kulturore bullgare u përfshinë gjithashtu në raportin e ECRI për Maqedoninë e Veriut[27]. Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), i krijuar nga Këshilli i Evropës, si një organ i pavarur monitorues i të drejtave të njeriut i specializuar në çështjet që lidhen me luftën kundër racizmit, diskriminimit (bazuar në "racë", origjinë etnike/kombëtare, ngjyrën e lëkurës , shtetësisë, fesë, gjuhës, orientimit seksual dhe identitetit gjinor), ksenofobisë, antisemitizmit dhe jotolerancës, në raportin për vendin për vitin 2023 vlerëson "dhunën antibullgare si një shqetësim serioz, veçanërisht pas disa sulmeve ndaj njerëzve që e identifikojnë veten si bullgarë dhe mbi qendrat kulturore bullgare" dhe i referohet "hapave të autoriteteve për të anuluar regjistrimin ose për të shpërndarë disa shoqata kulturore ekzistuese bullgare".

Njëkohësisht, përmendet edhe incidenti me klubin "Ivan Mihaillov" në Manastir, i cili ka ndodhur, siç thuhet në raport, pas një sërë kërcënimesh ndaj klubit. Presidenti dhe Qeveria e dënuan sulmin, por qëndrimi i disa bashkëbiseduesve të ECRI-t ishte se dënimi me kusht për sulmin në Manastir nuk ishte mjaft i rreptë për të parandaluar incidente të tilla në të ardhmen.

Po ashtu, përmenden edhe ngjarjet lidhur me klubin "Car Borisi i Tretë" në Ohër, ku në incidentin e dytë janë përdorur armë zjarri dhe dhunë fizike. ECRI kërkon jo vetëm

dënimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe dhunës dhe nxjerrjen para drejtësisë të autorëve të krimeve të urrejtjes, por edhe një kundërshtim sistematik dhe të konsekuent ndaj diskursit publik antibullgar, me qëllim për të ndalur këtë trend shqetësues.

Komisioni, siç shtohet në raport, është i vetëdijshëm për polemikat politike në lidhje me përdorimin e emrit të Ivan Mihaillov dhe idetë e tij politike se maqedonasit janë bullgarë dhe pranon se përdorimi i emrit Car Boris i Tretë është gjithashtu i kontrovers dhe provokues, duke marrë parasysh rolin e bullgarëve si pushtues të Maqedonisë në Luftën e Dytë Botërore.

Pyetja e përhershme: Çfarë duhet bërë?

Ajo që mund të konkludohet nga kjo analizë përputhet me konstatimet e vërtetuara se gjuha e urrejtjes shërben si mjet për përforcimin e dezinformatave, spinimin dhe shkaktimin e dyshimeve dhe mosbesimit në procese dhe institucione. Në këtë rast, gjuha e urrejtjes, përveç polarizimit të opinionit publik, e vë në shënjestër edhe procesin e integrimit evropian të vendit.

Dhe në këtë rast, gjuha e urrejtjes ka modele të qarta si në nivelin eksplicit, ashtu edhe në atë të implicit, pra si kur flitet për përmbajtjen ashtu edhe për formën. Përmbajtja është lehtësisht e dallueshme, mbi të gjitha në fjalorin që është i pahijshëm dhe i joadekuat për komunikim publik.

Ekzistojnë shembuj të panumërt, sidomos në media. Përveç postimeve dhe komenteve në rrjetet sociale, ndotja shtesë e hapësirës publike me gjuhë të urrejtjes bëhet edhe përmes transmetimit të pafiltruar të fjalëve të pjesëmarrësve në ngjarjet që përhapin gjuhën e urrejtjes, si p.sh. bërja e publicitetit nga diçka që nuk meriton vëmendje nga këndvështrimi i interesit publik dhe komunikimi i kulturuar politik dhe etik.

Situata është shumë më e ndërlikuar me narrativët dhe strategjitë e diskursit, të cilat në mënyrë implicite përhapin urrejtje dhe jotolerancë. Si shembull mund të merret paraqitja e vazhdueshme e një grupi të caktuar qytetarësh, strukturave shoqërore apo politike, në një kontekst negativ. Një vënie e tillë në kornizë mesazhesh në vazhdimësi dhe intensitet krijon një odium që nxit urrejtje. Kështu ndodh edhe në rastin e debatit publik për ndryshimet kushtetuese, i cili krijon një atmosferë në të cilën qoftë për avokuesit, qoftë për kundërshtarët e këtij procesi, bëhet e justifikueshme edhe gjuha e urrejtjes ndaj "tjetrit".

Dhe përderisa gjuha e implicite e urrejtjes është e vështirë të identifikohet dhe të njihet menjëherë, ajo eksplicite, më lehtë e dukshme, nëse ka vullnet, duhet të përjashtohet menjëherë nga komunikimi publik duke moderuar thjesht komentet e përdoruesve në një portal lajmesh ose një portal që është platformë onlajn e medias tradicionale të shkruar dhe/ose elektronike.

Nga ana tjetër, edhe pronarët e profileve dhe faqeve personale në rrjetet sociale, nëse nuk duan që "hapësira e tyre personale" në Fejsbuk, Tuiter, Instagram, Tik-Tok dhe rrjete të tjera sociale të pushtohet nga persona që përhapin gjuhë të urrejtjes, ata ose mund t'i përjashtojnë nga lista e miqve në Fejsbuk ose të moderojnë komentet.

Nga ana tjetër, mbetet ajo që ekspertët e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut e njohin si një nga problemet më urgjente, që është se nuk ka dënueshmëri

sistematike të gjuhës së urrejtjes. Ata, ashtu siç detekton KE në raportet e tij, theksojnë se shteti nuk ka një sistem ndëshkimi, megjithëse sektori joqeveritar ndihmon në zbulimin e saj, mbledhjen e provave, komunikimin mes Prokurorisë Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, por, në fund, nga gjyqësori në praktikë rezultojnë shifra dëshpëruese, sepse rastet për të cilat janë nisur procedurat për gjuhë të urrejtjes nga Prokuroria Publike nëpër gjykata prej vitesh numërohen në gishtat e një dore.

(Autori është gazetar dhe redaktor me përvojë shumëvjeçare)

Referenca:

1 Të drejtat bazike - Kornizë ka, implementimi është i ndryshueshëm, gjithkund duhen më shumë të holla („Основни права-Рамка има, имплементацијата варира, секаде се потребни повеќе пари“), Fondacioni Metamorphosis, e publikuar në vitin 2022.

2 www.govornaomraza.mk është platformë e internetit si pjesë e aktiviteteve të parashikuara në projektin “Hartim”, analizë dhe marrje e masave kundër gjuhës së urrejtjes në Republikën e Maqedonisë” e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, përkrahur nga Fondi nacional për demokraci(National Edowment for Democracy –NED) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

3 Raporti tremujor i Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi për periudhën janar-mars 2022 (Квартален извештај на Комисијата за спречување и заштита од дискриминација за јануари-март 2022 година)

4 Propozimi francez: Gjuhë e urrejtjes, dezinformata, manipulime mediatike, botuar nga IMA, shtator 2022 (Францускиот предлог: Говор на омраза, дезинформации, медиумски манипулации)

5 Apasiev propozon radikalizimin e opozitës me protesta, bllokada dhe paralizim të parlamentit (Апасиев предлага радикализација на опозицијата со протести, блокади и парализа на Собранието - 360 степени (360stepeni.mk), e publikuar më 11 nëntor 2021.

6 Apasiev e shan publikisht Pendarovskin (Апасиев јавно го пцуе Пендаровски), e publikuar në MKD.mk në 02.07.2022.

7 Zyrtarët e “Levicës” me etiketa, gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime për ta vënë në “listë” gazetarin Popetreski (Функционери на Левица со етикети, говор на омраза и закани за ставање на „список“ кон новинарот Попетрески), publikuar në portalin e IMA, 23.06.2022

8 Debat rrugësh në Kuvend: Deputetët e LSDM-së janë frikacakë, e ata nga VMRO-DPMNE janë për trajtim në Demir Hisar (Улична дебата во Собранието: Пратениците од СДСМ се изроди, а тие од ВМРО-ДПМНЕ се за лекување во Демир Хисар), e publikuar në portalin Makfaks.mk më 15.07.2022

9 Mllefi nga propozimi francez derdhet mbi bashkëjetesën Бесот од францускиот предлог се истура врз соживотот, e publikuar në Prizma.mk më 07.07.2023

10 Sulme të orkestruara me gjuhë urrejtjeje dhe dezinformata ndaj Fon Der Lejen dhe BE30 (Оркестрирани напади со говор на омраза и дезинформации кон фон дер Лајен и ЕУ), e publikuar në portalin e IMA më 15.07.2022

11 Varheji i BE-së: Vullneti për zgjerim u kthye, jemi të gatshëm të lëvizim shpejt EU’s Varhelyi: Will for enlargement is back, we’re ready to move fast, e publikuar në portalin Euroaktiv më 25.07.2022

12 Apelojmë për protesta paqësore pa dhunë (Апелираме за мирни протести без насилство), e publikuar në portalin e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 06.07.2022

13 Dhjetëra raporte për gjuhë të supozuar të urrejtjes ndaj bullgarëve në vend (Десетици пријави за наводен говор на омраза против Бугарите во земјава), e publikuar në portalin e TV Kanal 5, 21.07.2022

14 Protokoli nga mbledhja e dytë e Komisionit të përbashkët ndërshtetëror, i formuar mbi bazën e nenit 12 të Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim, 17.07.2022

15 Me të pavërteta për Protokollin me Bullgarinë nxitet atmosfera para ndryshimeve kushtetuese (Со невистини за Протоколот со Бугарија се подгрева атмосферата пред уставните измени), Vistinomer.mk, e publikuar më 07.08.2023.

16 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë të Veriut (Устав на Република Северна Македонија), e publikuar në portalin e Qeverisë

17 Keqpërdoret logoja e Fokus-it për përhapje të seksizmit dhe dezinformatave ndaj Zajkovës (Злоупотребено логото на Фокус за ширење сексизам и дезинформации кон Зајкова), e publikuar në Civil Media, 26.01.2023

18 Propozimi për qasje në Ndryshime të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Udhëzim për ndryshimin dhe plotësimin e kushtetutës (Предлог за пристапување кон измена на Уставот на Република Северна Македонија со насоки за изменување и дополнување на уставот), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e publikuar më 18.07.2023.

19 Ja kush do t'i vendosë bullgarët në Kushtetutë: Mes të ashtuquajturve ekspertë ka gjithçka, por jo profesorë të së drejtës kushtetuese (Еве кој ќе ги става Бугарите во Уставот: Меѓу т.н. експерти има сè, само не професори по уставно право), e publikuar për portalin Republika.mk më 24.04.2023.

20 Ana Çupeska, që e përkrah arrestimin e gazetarëve, nuk është kompetente të hartojë ndryshime kushtetuese, e publikuar në portalin Republika.mk më 25.04.2023.

21 Gjuhë e urrejtjes, gënjeshtra dhe kërcënime ndaj kryetarit të CIVIL-it, Xhabir Derallës (Говор на омраза, лаги и закани кон Џабир Дерала, претседателот на ЦИВИЛ), e publikuar në Civil Media më 14.07.2023.

22 Gjuhë ekstreme e urrejtjes nga tifozët e klubit bullgar Levski, indinjatë dhe dënim nga CIVIL (Екстремен говор на омразата од навивачите на бугарскиот клуб Левски, згрозеност и осуда од ЦИВИЛ), e publikuar në portalin Frontlajn.mk më 27.07.2023 г.

23 Vallë edhe huliganizmi do të ngjyroset me ngjyra politike (Дали и хулиганството ќе биде премачкано со политички бои?), e publikuar në DW më 28.07.2023.

24 IMA: Gjuha e urrejtjes së tifozëve që nxit dhunë duhet të dënohet publikisht dhe autorët të ndëshkohen (ИМА: Навивачкиот говор на омраза кој поттикнува насилство треба јавно да се осуди, а сторителите да се казнат), e publikuar në portalin e IMA, 28.07.2023.

25 Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Maqedonisë së Veriut në procesin e integrimit evropian për vitin 2022 (Извештајот на Европската Комисија за напредокот на Северна Македонија во евроинтегративниот процес за 2022), e publikuar në ueb faqen e Sekretariatit për Çështje Evropiane

26Ndryshimet kushtetuese janë vetëm një nga stërkëmbësit e mundshëm ndaj hyrjes në BE (Уставните измени се само една од можните сопки кон влезот во ЕУ) e publikuar në portalin e Radio Evropa e Lirë, 15.05.2023.

27 Raporti i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Maqedoninë e Veriut, Këshilli i Evropës, shtator 2023, i qasshëm në: ECRI Report on North Macedonia, Council of Europe, September 2023

3. MEDIAT SHQIPE: NDRYSHIMET KUSHTETUESE, DOMOSDOSHMËRI PËR INTEGRIM NË BE

Si raportuan mediat në gjuhën shqipe mbi fillimin e debatit në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut mbi ndryshimet kushtetuese? Si u pozicionuan mediat shqipe ndaj qëndrimeve të VMRO DPMNE-së? Sa hapësirë mediatike fitoi opozita shqiptare? Si u raportua mbi qëndrimin radikal të deputetit të pavarur, Skender Rexhepi Zejd? A përdorën disa politikanë fjalor religjioz duke kumtuar qëndrime politike? Cili ishte narrativi i mediave shqipe lidhur me heqjen e "20 përqindëshit"?

Shkruan: SEFER TAHIRI

Ndryshimet kushtetuese si derë e sigurt për vazhdimin e procesit të integrimit të Maqedonisë së Veriut në Bashkimit Evropian vazhdojnë të jenë në fokus të mediave shqipe. Edhe muajve të verës, kjo temë, ka qenë ajo që ka mbuluar më shumë hapësirën informative dhe analitike në mediat në gjuhën shqipe. Qasja profesionale në raportim dhe interpretimin analitik ka qenë gjithmonë afirmative, përkatësisht, ndryshimet kushtetuese shihen si nevojë e domosdoshme që e trason rrugën drejt organizatës së unifikuar evropiane. Por, kjo tendencë mediatike gjithmonë është shoqëruar me aktualizimin dhe justifikimin politik të partive dhe opinionit publik shqiptar që ndryshimet kushtetuese duhet të përfshijnë ndryshimin e përkufizimit statistikor mbi gjuhën shqipe si "gjuha që e flasin mbi 20 për qind e popullatës" dhe zëvendësimin e tij me termin "gjuha shqipe".

Siç kemi nënvizuar që në korrik të vitit 2022, kur publikuam analizën me titull "Si raportuan mediat në gjuhën shqipe për "propozimin francez"?[1], mediat në gjuhën shqipe dallojnë nga ato maqedonase sa i përket qasjes ndaj ndryshimeve kushtetuese. Një pjesë të saj po e ripërkujtojmë, për të dëshmuar se krahasuar me diskursin aktual politik dhe mediatik nuk ka dallime të mëdha në qasjet e mediave në gjuhë të ndryshme.

"Mediat në gjuhën shqipe kishin raportim kryesisht afirmativ mbi "propozimin francez" për kornizën negociuese të BE-së për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Mirëpo, kishte raste të raportimit sensacionalist, si dhe të dezinformimit. Mediat në gjuhën shqipe i kanë dhënë rëndësi të madhe deklaratës së kryeministrit të vendit, Dimitar Kovaçevski, por edhe deklaratave të ministrit të jashtëm, Bujar Osmani, presidentit të vendit, Stevo Pendarovski e zyrtarëve, por edhe politikanëve rajonal e diplomatëve, të cilët shpreheshin me intonacion pozitiv mbi propozimin".

Paralajmërim i fuqishëm i seancës për ndryshimet kushtetuese

Një pjesë e madhe e mediave në gjuhën shqipe, më 17 gusht 2023 kanë paralajmëruar mbajtjen e seancës së Kuvendit, në të cilën në rend dite ishin ndryshimet kushtetuese, me të cilat bullgarët bëhen pjesë e Preambulës së aktit më të lartë juridik të shtetit.

Një pjesë e madhe e mediave raportonin duke paralajmëruar seancën, por edhe duke kumtuar letrën e ministrit të jashtëm të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani drejtuar deputetëve, me të cilën një ditë para seancës u bënte thirrje se "Të premten vendosni për të ardhmen":

- Ndryshimet kushtetuese në RMV, ministri i Jashtëm letër deputetëve: Të premten, ju vendosni për të ardhmen (17 gusht 2023, Gazeta Express)[2].
- Ministri i Jashtëm letër deputetëve për ndryshimet kushtetuese: Të premten ju vendosni për të ardhmen (17 gusht 2023, TV Shenja)[3].
- Bujar Osmani letër deputetëve: Ndryshimet kushtetuese nuk bëhen nën diktatin bullgar (17 gusht 2023, portali Telegrafi)[4].
- Osmani me letër të hapur për deputetët: Nga ju varet ardhmëria evropiane e shtetit (17 gusht 2023, TV 21 Maqedoni)[5].
- Osmani u dërgon letër deputetëve në para fillimit të diskutimit për ndryshimet kushtetuese (17 gusht, 2023, portali Almakos)[6].

Hapësirë e balancuar për pushtetin (LSDM) dhe opozitën (VMRO-DPMNE)

Një pjesë e mediave janë fokusuar tek qëndrimet e Qeverisë, përkatësisht kryeministrit Dimitar Kovaçevski dhe partisë kryesore opozitare maqedonase, VMRO-DPMNE. Qeveria mbante qëndrimin që ndryshimet kushtetuese duhet të miratohen, ndërsa opozita maqedonase se nuk do t'i mbështesë me asnjë kusht. Pozicionet qeveritare dhe opozitare janë prezantuar kryesisht në mënyrë objektive dhe korrekte, por edhe të balancuar:

- Nesër dita "D" për ndryshimet kushtetuese – Qeveria kërkon konsensus, opozita nuk dorëzohet (17 gusht 2023, portali INA)[7]
- Seanca plenare për ndryshimet kushtetuese, LSDM: Do të dëshmojë kush përkrahë integrimin (17 gusht 2023, portali Flaka)[8].
- Mesazhe për seancën e ndryshimeve kushtetuese, Kovaçevski: Për Maqedoninë europiane, duhen 80 vota (17 gusht 2023, TV 21 Maqedoni)[9].
- VMRO-DPMNE: Nuk do të ketë ndryshime kushtetuese, Kovaçevski si ka deputetët (17 gusht 2023, portali Tetovasot)[10]
- Dy ditë para seancës për ndryshimet kushtetuese, VMRO-DPMNE nuk lëshon pe: "Jemi kundër, nuk ka shumicë" (17 gusht 2023 TV 21 Maqedoni)[11].
- VMRO-DPMNE: Mbetemi kundër ndryshimeve kushtetuese 17 gusht 2023, portali Lajmpress)[12].
- Ndryshimet kushtetuese: Shansi i fundit i VMRO-së për të reflektuar mbi progresin evropian të vendit (17 gusht 2023, portali Pressonline)[13].

Disa media me tone kritike ndaj VMRO-DPMNE-së

Disa portale në gjuhën shqipe kanë pasur qasje kritike ndaj VMRO-DPMNE-së, e cila sipas tyre bën veprime bllokuese ndaj procesit të integrimit në Bashkimin Evropian. Titulli i portalit Tetovasot "Rrugën e Maqedonisë së Veriut drejt BE-së e bllokon vetëm VMRO-ja dhe "satelitët" e saj!"[14] duket se pasur vetëm qëllim për të rritur klikimet, pasi brenda lajmit transmetohen deklaratat e kryeministrit Kovaçevski, por nuk shpjegohet se kush janë satelitët e partisë së Mickoskit që bllokojnë integrimin.

Edhe portali Gazetaexpress publikoi titullin "e fuqishëm" lidhur me qëndrimet e VMRO-DPMNE-së "E vetmja idoeologji që ka VMRO-ja dhe Mickoski është bllokimi i ardhmërisë europiane"[15], por në titull nuk shpjegohet se a bëhet fjalë për qëndrim të politikës editoriale të redaksisë së portalit, pasi nuk atribuohet kryeministri Kovaçevski. Në vetë artikullin, kryeministri parafrazohet se e vetmja ideologji e VMRO-DPMNE-së është bllokimi dhe izolimi. "VMRO-DPMNE dëshmoi se nuk kanë argumente dhe se nuk ka ide për debat. Dëshmojnë se janë të gatshëm ta bllokojnë të ardhmen evropiane të qytetarëve vetëm për qëllime personale", deklaroi Kovaçevski.

Portali INA publikoi komentin e zyrtarit qeveritar, Marjan Zabërçanec me titull "Plani sekret i Mickoskit"[16], në të cilin shprehej se ky plan "nuk mund të jetë njëkohësisht edhe antievropian edhe maqedonas".

"Çfarë planesh sekrete po thur dhe po fsheh Mickoski? A ka dikush në këtë vend dilema se çdo plan sekret i DPMNE-së është plan i rrezikshëm për Maqedoninë? A është plani sekret i Mickoskit ndërprerje e negociatave me BE-në dhe izolim i ri i vendit? A është plani sekret i Mickoskit që të hedh vaj në zjarrin e Radevit dhe Kurtit dhe t'i kapet sentimentit antibullgar dhe antishqiptar në mesin e maqedonasve?", shkruan Zabërçanec në komentin e publikuar.

Opozita shqiptare fiton hapësirë të madhe mediatike

Ndërkohë një pjesë e madhe e mediave u kanë dhënë hapësirë të konsiderueshme qëndrimeve të Frontit opozitar shqiptar, i përbërë nga Lëvizja Demokratike e Izet Mexhitit, Alternativa e Afrim Gashit dhe Lëvizja BESA e Bilall Kasamit, të cilët kërkonin shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nëse nuk miratohen ndryshimet kushtetuese:

- Blloku opozitar me thirrje të përbashkët: Menjëherë të vendosen në votim ndryshimet kushtetuese! (17 gusht 2023, TV 21 Maqedoni)[17]
- Pse nuk pranohen amendamentet e LD-së që ofrojnë zgjidhje evropiane ballkanike (17 gusht 2023, portali Aktuale)[18]
- Mexhiti, Kasami dhe Gashi: T'i votojmë ndryshimet kushtetuese dhe të hiqet 20-përqindshi (17 gusht 2023, TV Shenja)[19]
- Kushtëzon fronti opozitar shqiptar: Pa heqjen e 20% nuk ka ndryshime kushtetuese (17 gusht 2023, Portalb)[20]

Portali Zhurnal publikoi analizën me titull "Analizë: Maqedonia e Veriut, një nuse me fustan të bardhë që po digjet nga dashuria për BE-në, por i mungojnë 7-8 vota për t'u fejuar."[21]

"Të gjithë në Maqedoninë e Veriut e duam BE-në, por kjo dashuri nuk po merr ende "flakë" për shkak të mungesës së 5-6, ose 7-8 votave të deputetëve, që të mund ajo të kurorëzohet dhe të fillojmë procedurën për shkëmbimin e unazave të fejesës. Afati joformal mbetet nëntori, por opozita kërkon që mos të pritet deri atëherë, por gjërat të qartësohen më herët, duke testuar disponimin për futjen e bullgarëve në Preambulë, por edhe futjen e gjuhës shqipe në vend të 20 përqindëshit, shkruan Zhurnal.

Ndryshimet kushtetuese- udhëkryq midis Perëndimit dhe Lindjes!

Ndryshimet kushtetuese si çelës për hapjen e dyerve të Bashkimit Evropian, në telvizionin nacional në gjuhën shqipe, Alsat M u interpretua si pikë kthese që përcakton trajektoren e ardhmërisë së vendit në udhëkryqin midis bllokut evropian perëndimor dhe atij lindor prorus.

Titullit i raportit gazetaresk është "Deputetët: Maqedonia sot vendos nga perëndimi apo lindja!"[22], por në kronikë nuk pati ndonjë vrojtim që lidhet me titullin. Në raport thuhej: "Atmosferë e shtendosur dukej para fillimit të seancës në Kuvend. Deputetët hallin më të madh e kishin se ku t'i parkojnë makinat. Disa kujdeseshin të vijnë me radhë që të kenë rastin të flasin para mediave. Pati mendime të ndryshme nga gjitha partitë politike lidhur me pritjet për ndryshimet kushtetuese". Nga ana tjetër, TV Alsat në mënyrë korrekte dhe të balancuar prezantoi qëndrimet e të gjitha partive.

Zejdi me deklaratë "bombastike": Komunat shqiptare vetë në BE

Në vlugun e debatit politik mbi ndryshimet kushtetuese, deputeti i pavarur, Skender Rexhepi Zejd, i cili formoi partinë e re politike, Lëvizja Populli, doli me idenë e madhe me narrativ të fuqishëm etnopolitik, edhe pse tepër joreale, që "Komunat shqiptare mund të kërkojnë rrugën drejt Bashkimit Evropian veçmas nga komunat maqedonase".

"Rexhepi në Kuvend: Mund të ndodh që komunat shqiptare të kërkojnë rrugën drejt BE-së veçmas komunave maqedonase", ishte titulli i portaleve: Zhurnal[23], Tetovasot[24], Almakos [25] dhe Telegrafi[26].

Televizioni 21 deklaratën e deputetit Skender Rexhepi e transmetoi me titullin "Zejdi alarmon për rrezikun nga nacionalizmi: Komunat shqiptare në Maqedoni mund të kërkojnë rrugëtim drejt BE-së, ndaras nga ata maqedonase"[27].

"Deputeti i pavarur, Skender Rexhepi-Zejdi në fjalimin e tij gjatë debatit për miratimin e nevojës për ndryshimet kushtetuese foli për rrezikun e përhapjes së nacionalizmit në vend, në rast se nuk votohen ndryshimet kushtetuese. Rexhepi thotë se në kampin politik shqiptar mund të krijohet parti nacionaliste, e cila do të shkaktonte probleme shtesë në përplasje me partitë nacionaliste maqedonase. "Mund të vije që në të ardhmen e afërt, të ndodhin kërkesa tjera ku shqiptarët apo komunat shqiptare, të nxitur nga një nacionalizëm i tillë, të kërkojnë rrugëtim drejt BE-së, ndaras nga komunat maqedonase", deklaroi Zejdi", raportoi TV 21.

Duhet theksuar se të gjitha mediat kanë transmetuar deklaratën e deputetit Rexhepi në mënyrë jokritike, përkatësisht ky deputet nuk është pyetur se si e koncepton integrimin e komunave shqiptare në BE dhe se vallë ky projekt e dezintegron vendin?

Që ndryshimet kushtetuese në hemisferën politike shqiptare janë parë si mburojë për pengimin e skenarëve anti-perëndimorë flet edhe deklarata e liderit të partisë së re shqiptare, Partisë për Ardhmëri Evropiane (PAE), Arijanit Hoxha[28]. "Nëse nuk kalojnë ndryshimet kushtetuese, Maqedonia e Veriut bëhet cak i lehtë i skenarëve anti-perëndimore! Shanset e dhëna nga partnerët ndërkombëtarë nuk duhet të humben, prandaj ju bëjmë thirrje gjithë faktorëve politik që në këto momente historike të dalin jashtë kornizave të sondazheve partiake dhe të mendojnë për të ardhmen e qytetarëve, gjeneratave të reja dhe vendit", u shpreh Hoxha.

Fjalori religjioz i politikanëve në debatin për ndryshimet kushtetuese

Që çështja e ndryshimeve kushtetuese është shumë e rëndësishme dhe madje kruciale për kampin politik shqiptar, dëshmojnë edhe deklaratat që shkojnë përtej sferës politike. Madje, koordinatori i grupit parlamentar të Bashkimit Demokratik për Integrim, Arbër Ademi, duke dashur të justifikojë domosdoshmërinë e ndryshimeve në Kushtetutë, në ditën e nisjes së debatit, duke kopjuar fjalët e liderit të kësaj partie, Ali Ahmeti, gjë që flet për kultivimin e kultit të liderit, me fjalor religjioz u shpreh se "sot dalim para urës së Siratit"[29] (Në besimin islam predikohet se Ura e Siratit është më e hollë se qimja e flokut dhe më e mprehtë se shpata dhe në ditën e Gjykimit (Kijametit), ata që do ta kalojnë atë do të hynë në parajsë).

Ndërsa profesori i së drejtës kushtetuese në Universitetin e Tetovës, Mersim Maksuti, duke dashur të shpjegojë se pavarësisht rigjiditetit, përkatësisht ngurtësisë kushtetuese që duhet ta kenë vendet demokratike, në deklaratën për TVM 2, Programi në gjuhën shqipe shprehet se "Në anën tjetër nuk do të thotë se kushtetuta është dokument i shenjtë që nuk ndryshohet asnjëherë. Jo. Edhe këto ndryshime që i kemi sot të kushtetutës janë si rezultat i nevojës, i debllokimit në rastin tonë të procesit të integrimit në rrugën drejt BE-së".

Përderisa TVM 2, kronikën e transmetoi me titullin "Ndryshimi i shpeshtë i Kushtetutës, Maksuti: Lejohet, por akti duhet t'a ruajë ngurtësinë"[30], pjesa më e madhe e portaleve, si Tetova Sot[31], Gazeta[32], Almakos[33], Flaka[34], deklaratën e ripublikuan me titullin "Maksuti: Kushtetuta nuk është dokument i shenjtë!"

Mediat, politikanët dhe opinionistët në gjuhën shqipe: Të përfshihet shqipja, të hiqet "20 përqindëshi"

Edhe në analizën e publikuar në qershor të vitit 2023 me titull "Raportim mediatik etnocentrik dhe partiak mbi ndryshimet kushtetuese"[35] kemi theksuar se "Mediat në gjuhën shqipe theksin e kanë vënë tek fakti që me ndryshimet kushtetuese nuk do të përmirësohet statusi i shqiptarëve, përkatësisht nuk do të bëhet përkufizimi i tyre nga "pjesëtarë të bashkësisë, që janë mbi 20 %" në shqiptarë dhe as gjuhës shqipe nuk do t'i hiqet statusi i "gjuhës, të cilën e flasin mbi 20 % e popullatës"".

Krahas domosdoshmërisë për miratimin e ndryshimeve kushtetuese, politika shqiptare, edhe gjatë verës nuk ka reshtur së kërkuari që gjuha shqipe të përfshihet në Kushtetutë, duke e zëvendësuar formulimin "20 përqindëshi".

Deklarata e deputetit të Aleancës për Shqiptarët, Halil Snopçe, se "Kjo është kërkesë që vjen nga populli shqiptar, gjuha shqipe është ndër gjuhët më të vjetra në Evropë"[36] ka bërë bujë në mediat në gjuhën shqipe. Snopçe, citohet nga mediat të ketë thënë: "Gjuha shqipe është njëra ndër gjuhët më të vjetra në Evropë e vjetër 6000 vite dhe do të ishte nder, thotë Snopçe, që çdo shtet evropian ta ketë gjuhë zyrtare gjuhën shqipe. Maqedonasit vet duhet të angazhohen për zyrtarizimin e gjuhës shqipe dhe zëvendësimin e segmentit të 20% me gjuhën shqipe".

Portali Nistori, deklaratat e Snopçes i publikoi me titullin "Snopçe: Maqedonasit duhet ta marrin për nder që gjuha shqipe të jetë zyrtare"[37]. Por, Snopçe në deklaratë nuk kërkon që shqipja të jetë zyrtare, por të hiqet 20 përqindëshi, ndërsa theksoi se "çdo shtet evropian do ta kishte nder ta ketë shqipen gjuhë zyrtare", pra ngjashëm si Maqedonia e Veriut.

Ndërkohë, portali Inaonline publikoi komentin e opinionistit, Muhamer Pajaziti me titull "Ku po shkoni në Evropë pa gjuhën shqipe?"[38], një pjesë të të cilit po e ripublikojmë.

"Çfarë bëjnë maqedonasit, ku është dallimi, a është e vështirë për të gjetur arsyet se pse Bashkimi Evropian ka nevojë për 24 gjuhë zyrtare, e Maqedonia nuk është në gjendje të zyrtarizojë gjuhën e popullit etnik i cili përbën rreth 30 për qind të popullsisë.

Arsyet nuk janë vështirë për tu gjetur, ato janë: demokracia, transparenca dhe e drejta për të ditur, të cilat mentaliteti maqedonas nuk dëshiron t'i pranojnë.

Si është e mundur që Bashkimi Evropian legjislacionin e miratuar e boton dhe vë në dispozicion në 24 gjuhë zyrtare, ndërkaq shqiptarët në Maqedoni këtë të drejtë akoma e kanë të mohuar?! Pse edhe Maqedonia nuk respekton parimin themelor të BE që të gjithë qytetarëve të saj dhe përfaqësuesve të zgjedhur t'u ofrojë mundësinë të komunikojnë me institucionet në gjuhën e tyre kombëtare?"

Komenti, siç shihet, u adresohet maqedonasve, të cilët sipas opinionistit nuk kanë asnjë arsye për të mos njohur shqipen në Kushtetutë.

Gazetari dhe publicisti i njohur, Mahi Nesimi në analizën e tij me titull "Bullgarët ecin përpara – shqiptarët në gjumë të thellë"[39], shkruan se pozita juridiko-kushtetuese në të cilën historikisht jetojnë shqiptarët është e pavolitshme: "Meqë punët rreth ndryshimeve kushtetuese kanë përparuar dukshëm ndërsa asnjë përfaqësues shqiptar (ministër, deputet, parti politike etj), nuk e ka hapur gojën për të kërkuar që ndryshimet në Preambulë të përfshijnë edhe shqiptarët, duke u siguruar *status të populllit shtetformues,* kjo dëshirë 78 vjeçare e shqiptarëve ka mbetur (fatkeqësisht) të paraqitet nga individë jashtë strukturave politike të zgjedhura dhe emëruara nga shqiptarët që angazhohen për të mirën e shqiptarëve", komenton Nesimi.

Portali Zhurnal ka publikuar qëndrimin e opionionistit Sulejman Mehazi, i cili lidhërëve të LSDM-së, VMRO DPMNE-së apo partisë E Majta (Levica), por edhe BDI-së dhe ASH-së u bën thirrje "Kujdes me 20%! RMV-ja historikisht është më shumë shqiptare sesa maqedonase"[40].

Mehazi, pasi rendit disa figura të mëdha të historisë shqiptare me prejardhje nga Maqedonia e Veriut, siç janë: ministri i parë i Mbrojtjes së shtetit shqiptar, Mehmet Deralla; Vojsava, nëna e Skënderbeut; Mustafë Sheh Tetova, sekretar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; mjeku i famshëm shqiptaro-amerikan, Ferid Muradi që mori çmimin Nobel si dhe e Shenjta Nëna Tereza, përmend edhe se "...Shkupi ka qenë Vilajeti i shqiptarëve e jo

i maqedonasve", si dhe se "...Kongresi i Alfabetit Shqiptar, u mbajt në qytetin e Manastirit të Maqedonisë suaj Veriore".

Mehazi në fund konkludon: "Kujdes me 20% e shqiptarëve!, ju bashkëkombas maqedonas, Mickoski, Apasiev, Kovaçevski që krekoseni ndaj shqiptarëve, se, shteti juaj i RMV-së u krijua nga stenda e zemrës së sëmurë të Iliridës."

Toponimi Ilirida, sipas historianit Nebi Dervishi "është emër i lumit që në kohën antike i lagte brigjet e tri Mbretërive Ilire: të Dardanëve, Pajonëve dhe Enkelejve. Lumi Ilirida sipas disa historianëve shqiptarë të kohës më të re: si Prof. Ali Vishko, Prof. Masar Kodra, Prof. JusufBuxhovi, e ndonjë tjetër, është lumi i sotëm Treska". Ky toponim në janar të vitit 1992 u përdor për të shpallur Autonominë politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut[41], projekt që nuk u pranua nga institucionet e shtetit të pavarur, i dalë nga ish federata jugosllave.

Lajme (dhe dezinformata) të vjetra publikohen si të reja

Kur ka debate të nxehta politike, portalet shpesh ripublikojnë lajme të vjetra, që kanë synim që përmes sensacionalizimit të rrisin ndjekjen e tyre. Kjo ka ndodhur me deklaratën e gazetares dhe analistes bullgare të politikës ndërkombëtare, Zornica Ilieva, e cila siç transmetojnë me tekste pothuajse identike portalet Ina-online.net[42], Telegrami.mk[43], Infoshqip.com[44] më 9 shtator 2023 (disa duke iu referuar një artikulli të publikuar në portalin në gjuhën maqedonase Expres.mk), ka vlerësuar se "Maqedonia do të federalizohet pavarësisht se a do të hyjë në BE."

"Pas Marrëveshjes së Ohrit, shqiptarët jo vetëm që morën të drejtat e tyre, por para tyre mbeti vetëm një çështje tjetër – federalizimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky është shqetësimi i madh i maqedonasve. Ata shpresojnë se me hyrjen e tyre në BE kjo nuk do të ndodhë. Jo, do të ndodhë, sepse potencialin më të madh integrues në Ballkan e ka grupi etnik shqiptar, pavarësisht nëse është në Shqipëri, Kosovë apo Maqedoni. Të gjitha vendimet në Maqedoni merren jo vetëm me pjesëmarrjen e partive shqiptare, por edhe në bazë të asaj që thonë ato. Pa ata nuk mund të ketë qeveri, pa to nuk mund të merret asnjë vendim. Ata janë në pushtetin vendor. Ortodoksët nuk jetojnë më në Tetovë, Maqedoninë Perëndimore dhe Tirana ushtron ndikim të drejtpërdrejtë në Maqedoninë Veriore. Është fakt", tha Ilieva për televizionin bullgar "Pogled".

Por kjo deklaratë është transmetuar nga portali Expres,mk një vit e dy muaj më parë, që në datën 9 korrik 2022! Që do të thotë se ekziston mundësi reale që bëhet fjalë për ripërsëritje të lajmeve në data të njëjta, por në muaj e vite të ndryshme, që është qasje joobjektive, jokorrekte dhe mund të konsiderohet si manipuluese ndaj publikut.

Lidhur me këtë deklaratë të analistes Ilieva, edhe në analizën mbi raportimin e mediave shqipe mbi propozimin francez të botuar nga IMA në vitin e kaluar (shtator 2022) kemi nënvizuar se "Përveç portalit të apostrofuar Ina- online, edhe portali Zhurnal, portali Medial, portali Lajme.mk, kanë transmetuar deklaratën e Ilievës, e publikuar së pari në portalin në gjuhën maqedonase Expres.mk, pa i bërë interpretim analitik. Për shembull nuk u përgënjeshtrua qëndrimi se në rajonin e Tetovës dhe Maqedonisë Perëndimore, nuk jetojnë më ortodoksë! Regjistrimi i fundit i popullsisë, por edhe vetë realiteti shoqëror dëshmon se jo vetëm në Tetovë, por edhe në mbarë perëndimin e vendit jetojnë maqedonas – ortodoksë"[45].

Mediat transmetuan tonet zbutëse të Imer Selmanit

Ish politikani dhe ish-kandidati për kreun e shtetit, Imer Selmani në intervistën për Radion Evropa e Lirë[46] më 20 gusht 2023, e cila është publikuar në masë të madhe edhe nga mediat në gjuhën shqipe, është shprehur se "Ëndrrat për shtete të mëdha nuk ekzistojnë tek qytetarët e vetëdijshëm. Për qytetarët pa dallim etnie është më e rëndësishme të jetojnë në shtet ku ka paga të majme, standard jetësor më të mirë e drejtësi".

Edhe Selmani, njësoj si Maksuti është shprehur se Kushtetuta nuk mund të jetë e pandryshuar: "As kushtetuta e asnjë vendi nuk është e përjetshme, as ligjet nuk janë të përjetshme, kështu që gjithmonë do të ketë synim për përparim më të mirë, për më shumë të drejta. Edhe maqedonasit kanë të drejtë të kërkojnë më shumë të drejta dhe shqiptarët kanë të drejtë të kërkojnë gjithmonë më shumë të drejta. Megjithatë, kur jetojmë në një komunitet është njësoj si të jetosh në shtëpi me fëmijë dhe një grua dhe gjithmonë do të përfundoni duke kërkuar kompromis".

Vizita e Kurtit, pakënaqësitë sociale – a janë zhvendosje e vëmendjes nga ndryshimet kushtetuese?

Portali Flaka publikoi shkrimin me titull **"**Kush dëshiron çështjen e ndryshimeve kushtetuese t'a zhvendos me tema të tjera?"[47].

Në shkrim theksohet se disa pakënaqësi të kategorive të ndryshme sociale dhe vizita e kryeministrit Kurti në Çair dhe Tetovë e zhvendosin vëmendjen nga ndryshimet kushtetuese. "Periudha e pazakontë e tensionuar e verës në prag të seancës së ndryshimit kushtetues, tensionet rreth vizitës së kryeministrit Kurti, protestat e pensionistëve, por edhe paralajmërimet për protesta të reja nga shtatori në dukje nuk kanë lidhje me ndryshimet kushtetuese, por ekspertët (Vlladimir Bozhinovski dhe Nenad Markoviq) thonë se do të kenë ndikim", shkruan Flaka.

Duke pasur parasysh morinë e reagimeve në kampin politik dhe mediatik maqedonas ndaj vizitës së Kurtit, mediat shqipe janë fokusuar tek trajtimi i tyre[48]. Mediat shqipe raportuan se "ardhja e Albin Kurtit trondit Maqedoninë", por në përgjithësi, lidhur me reagimet, në to ka pasur raportim kryesisht korrekt dhe të balancuar, meqë nuk janë regjistruar raportime komentuese, që janë shpesh praktikë e mediave të vendit kur trajtohet çështje me sensibilitet etnik.

Ndërkohë, rasti i fundit i zbulimit të shitjes së e ilaçeve në Klinikën Onkologjisë[49] nuk është ndërlidhur drejtpërdrejt me ndryshimet kushtetuese, përkatësisht defokusimin e opinionit publik nga ndryshimet në Kodin Penal. Siç mund të konfirmohet përmes portalit grumbullues të lajmeve Fax.al, fokusi i mediave shqipe është vënë tek protesta në të cilën kërkohej përgjegjësi penale dhe politike, reagimet politike, deklaratat e ministrit të Shëndetësisë, Fatmir Mexhiti dhe tek krijimi i Komisionit Hetimor për rastin e Klinikës së Onkologjisë.

Në anën tjetër, ndryshimet e bëra në Kodin Penal[50], në mediat shqipe janë raportuar në mënyrë objektive, por shpesh theksi është vënë tek dilema e ngritur se "A po shpëtohen funksionarët kriminelë? meqë Kodi penal në mënyrë të qetë po ndryshohet, opozita s'ka amendamente". Mediat kanë kumtuar edhe reagimet e opozitës maqedonase se "Qeveria amniston krimin, në vend se ta mbrojë atë", reagimet e opozitës shqiptare

se "Me ndryshimet në Kodin penal qeveria kërkon ta kthejë Gruevskin" për të siguruar votat e nevojshme të deputetëve për ndryshimet kushtetuese, ndërsa është raportuar edhe mosfirmosja e propozimit për ndryshimet e Kodit Penal nga ministri i Drejtësisë, Krenar Lloga dhe arsyetimi i tyre nga zëvendës-kryeministri Artan Grubi.

Mediat në gjuhën shqipe përcjellin mesazhet e Gabriel Eskobarit dhe BE-së

Një rëndësi të veçantë në media i është kushtuar vizitës së zëvendës-ndihmës sekretarit amerikan të shtetit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Eskobar. Disa muaj para vizitës, në maj të vitit 2023, mediat kumtuan porositë e tij me titullin "Escobar: Ne nuk kërkojmë nga opozita ta mbështesë kryeministrin, por rrugën euroatlantike të Maqedonisë së Veriut"[51], që ishte intervistë e zyrtarit amerikan për Zërin e Amerikës. Mediat shqipe këtë vizitë e raportuan kryesisht me titullin "Escobar: Mbështesim fuqishëm procesin për ndryshime kushtetuese në RMV, angazhohemi që mos të ketë kërkesa të reja nga Bullgaria".

Porositë e "Treshes së Vajmarit": Anna Lirmann - Ministre për Evropën e Gjermanisë, Lorence Bunn - Sekretare e Shtetit për Evropën në Qeverinë franceze dhe Shimon Senk - Ministër i Çështjeve Evropiane të Polonisë, nga mediat shqipe janë raportuar kryesisht me titullin "Votoni ndryshimet kushtetuese për ta bllokuar Rusinë!"[52], por duke nënvizuar edhe faktin që këto ndryshime nuk mbështeten nga VMRO-DPMNE-ja.

Përfundime

Mediat në gjuhën shqipe gjatë disa muajve të fundit patën fokus të qartë dhe konstant mbi ndryshimet e propozuara kushtetuese, me të cilat edhe bullgarët bëhen pjesë e aktit më të lartë juridik të vendit.

Sipas analizës së narrativit të mediave shqipe, mediat shqipe patën qasje afirmative ndaj ndryshimeve, duke u dhënë hapësirë të konsiderueshme qëndrimeve të pushtetit, të balancuara me ato të opozitës, ndërsa ndaj VMRO-DPMNE-së, edhe pse në hapësirë jovoluminoze, kanë pasur edhe tone kritike.

Në shumë media u është dhënë hapësirë e madhe edhe qëndrimeve të opozitës shqiptare, e cila kërkoi që ndryshimet kushtetuese të vihen në rend dite dhe nëse nuk ka vota për miratim të shpallen zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Qëndrimi se "komunat shqiptare vetë mund të integrohen në BE", i kumtuar nga deputeti Skender Rexhepi Zejd ka ngjallur interesim të madh tek mediat, por ky qëndrim nuk ka pasur vrojtim kritik, përkatësisht nuk është zbërthyer nga mediat ose të pyetet deputeti vallë kjo shpie drejt federalizmit ose kantonizimit apo drejt ndarjes së shtetit.

Disa media, duke dashur të duken më të kapshme për publikun, nuk kanë kursyer as fjalorin religjioz, duke sjellë para tij formulimet si "Sot dilet para Urës së Siratit" ose "Kushtetuta nuk është e shenjtë".

Një pjesë, në anën tjetër, kanë «ricikluar» lajme dhe dezinformata të vjetra, për të qenë më sensacionaliste dhe me këtë edhe më të klikuara, veprim të cilin nuk duhet

ta bëjnë mediat, pasi publiku nuk meriton manipulim, që mund të cilësohet edhe si nënçmim i inteligjencës së tij.

Ndonëse një portal ka ngritur dilemën se vallë vizita e Kurtit dhe pakënaqësitë sociale kanë për qëllim defokusimin e opinionit publik nga ndryshimet kushtetuese, ky nuk ka qenë rasti me skandalin e Klinikës së Onkologjisë, pasi në mediat në gjuhën shqipe nuk ka pasur interpretime që kanë bërë relacion midis këtyre dy proceseve.

Por, kështu nuk është komentuar mbi ndryshimet në Kodin penal, pasi ato shihen si amnisti për politikanët në përgjithësi dhe për ish - kryeministrin Nikolla Gruevski, i cili sipas disa mediave do të kthehej nga Budapesti i Hungarisë dhe si "shpërblim" do të sigurojë 10 deputetë të VMRO-DPMNE-së, me votat e të cilëve do të arrihet numri prej 80 deputetëve për ndryshimet kushtetuese.

Mediat shqipe kanë transmetuar porositë e zyrtarit të lartë amerikan, Gabriel Eskobar dhe të "treshes diplomatike evropiane" që ndryshimet kushtetuese janë të domosdoshme, dhe se, mes tjerash, me anë të tyre Maqedonia e Veriut do t'i kundërvihet politikës dhe propagandës ruse.

Në mediat shqipe, një hapësirë e madhe i është kushtuar debatit që ndryshimet kushtetuese të përfshijnë edhe përfshirjen e gjuhës shqipe me emërtimin e saj të vërtetë, ndërsa në këtë kontekst ka dominuar qëndrimi i deputetit Halil Snopçe, por edhe i shumë opinionistëve që kanë argumentuar se shqipja duhet të përmendet në Kushtetutë, ndërsa ka pasur edhe qëndrime se me ndryshimet duhet të përfshihet edhe ndryshimi i statusit juridik - kushtetues të shqiptarëve, i cili do të barazohej me atë të popullit maqedonas.

(Autori është profesor universitar në lëmine e gazetarisë dhe komunikimeve publike)

Referenca:

1 Sefer Tahiri, "Si raportuan mediat në gjuhën shqipe për "propozimin francez"?", Instituti për Media dhe Analitikë IMA, 30.07.2023, https://ima.mk/sq/2022/07/30/si-raportuan-mediat-ne-gjuhen-shqipe-per-propozimin-francez/

2 17.08.2023, Gazeta Express, https://www.gazetaexpress.com/ndryshimet-kushtetuese-ne-rmv-ministri-i-jashtem-leter-deputeteve-te-premten-ju-vendosni-per-te-ardhmen/

3 TV Shenja, 17.08.2023, https://shenja.tv/video-ministri-i-jashtem-leter-deputeteve-per-ndryshimet-kushtetuese-te-premten-ju-vendosni-per-te-ardhmen/

4 17.08.2023, Telegrafi, https://telegrafi.com/progres-kushtetutes-letra-e-osmanit-drejtuar-deputeteve-per-unitetin-maqedonas-dhe-bullgar/

5 17.08.2023, TV 21 Maqedoni, https://tv21.tv/osmani-me-leter-te-hapur-per-deputetet-nga-ju-varet-ardhmeria-evropiane-e-shtetit/

6 17.08.2023, Almakos, https://almakos.com/osmani-u-dergon-leter-deputeteve-ne-para-fillimit-te-diskutimit-per-ndryshimet-kushtetuese/

7 17.08.2023, INA, https://ina-online.net/neser-dita-d-per-dryshimet-kushtetuese-qeveria-kerkon-konsensus-opozita-nuk-dorezohet/

8 17.08.2023, Flaka, https://flaka.com.mk/seanca-plenare-per-ndryshimet-kushtetuese-lsdm-do-te-deshmoje-kush-perkrahe-integrimin/

9 17.08.2023, TV21 Maqedoni, https://tv21.tv/mesazhe-per-seancen-e-ndryshimeve-kushtetuese-kovacevski-per-maqedonine-europiane-duhen-80-vota/

10 17.08.2023, Tetovasot, https://www.tetovasot.com/2023/08/vmro-dpmne-nuk-do-te-kete-ndryshime-kushtetuese-kovacevski-si-ka-deputetet/

11 17.08.2023, TV21 Maqedoni, https://tv21.tv/dy-dite-para-seances-per-ndryshimet-kushtetuese-vmro-dpmne-nuk-leshon-pe-jemi-kunder-nuk-ka-shumice/

12 17.08.2023, Lajmpress.org, https://lajmpress.org/vmro-dpmne-mbetemi-kunder-ndryshimeve-

kushtetuese/
13 17.08.2023, Pressonline.al, https://pressonline.al/2023/08/17/ndryshimet-kushtetuese-shansi-i-fundit-i-vmro-se-per-te-reflektuar-mbi-progresin-evropian-te-vendit/
14 21.08.2023,Tetovasot, https://www.tetovasot.com/2023/08/rrugen-e-maqedonise-se-veriut-drejt-be-se-e-bllokon-vetem-vmro-ja-dhe-satelitet-e-saj/
15 19.08.2023, Gazetaexpress.com, https://www.gazetaexpress.com/e-vetmja-idoeologji-qe-ka-vmro-ja-dhe-mickoski-eshte-bllokimi-i-ardhmerise-europiane/
16 21.08.2023, INA, https://ina-online.net/plani-sekret-i-mickoskit/
17 17.08.2023, TV21 Maqedoni, https://tv21.tv/blloku-opozitar-me-thirrje-te-perbashket-menjehere-te-vendosen-ne-votim-ndryshimet-kushtetuese/
18 17.08.2023, Aktuale, https://aktuale.mk/pse-nuk-pranohen-amendamentet-e-ld-se-qe-ofrojne-zgjidhje-evropiane-ballkanike/
19 17.08.2023, TV Shenja, https://shenja.tv/video-mexhiti-kasami-dhe-gashi-ti-votojme-ndryshimet-kushtetuese-dhe-te-hiqet-20-perqindshi/
20 17.08.2023, Portalb, https://portalb.mk/kushtezon-fronti-opozitar-shqiptar-pa-heqjen-e-20-nuk-ka-ndryshime-kushtetuese/
21 17.08.2023, Zhurnal, https://www.zhurnal.mk/analize-maqedonia-e-veriut-nje-nuse-me-fustan-te-bardhe-qe-po-digjet-nga-dashuria-per-be-ne-por-i-mungojne-7-8-vota-per-tu-fejuar/
22 18.08.2023, TV Alsat, https://alsat.mk/deputetet-maqedonia-sot-vendos-nga-perendimi-apo-lindja/
23 18.08.2023, Zhurnal, https://www.zhurnal.mk/rexhepi-ne-kuvend-mund-te-ndodh-qe-komunat-shqiptare-te-kerkojne-rrugen-drejt-be-se-vecmas-komunave-maqedonase/
24 18.08.2023, Tetovasot, https://www.tetovasot.com/2023/08/rexhepi-ne-kuvend-mund-te-ndodh-qe-komunat-shqiptare-te-kerkojne-rrugen-drejt-be-se-vecmas-komunave-maqedonase/
25 18.08.2023, Almakos, https://almakos.com/rexhepi-ne-kuvend-mund-te-ndodh-qe-komunat-shqiptare-te-kerkojne-rrugen-drejt-be-se-vecmas-komunave-maqedonase/
26 17.08.2023, Telegrafi, https://telegrafi.com/rexhepi-ne-kuvend-mund-te-ndodh-qe-komunat-shqiptare-te-kerkojne-rrugen-drejt-se-vecmas-komunave-maqedonase/
27 18.08.2023, TV21 Maqedoni, https://tv21.tv/zejdi-alarmon-per-rrezikun-nga-nacionalizmi-komunat-shqiptare-ne-maqedoni-mund-te-kerkojne-rrugetim-drejt-be-se-ndaras-nga-ata-maqedonase/
28 "Hoxha bën thirrje të votohen ndryshimet kushtetuese: Të unifikohen partitë politike, të mendojnë për të ardhmen e të rinjve", 18.08.2023, TV21 Maqedoni, https://tv21.tv/hoxha-ben-thirrje-te-votohen-ndryshimet-kushtetuese-te-unifikohen-partite-politike-te-mendojne-per-te-ardhmen-e-te-rinjve/
29 "Ademi: Sot dalim para "Urës së Siratit" (Video)", 18.08.2023, Lajmpress.org, https://lajmpress.org/ademi-sot-dalim-para-ures-se-siratit-video/
30 18.08.2023, TVM 2 https://al.mrt.com.mk/node/118033
31 19.08.2023, Tetovasot, https://www.tetovasot.com/2023/08/maksuti-kushtetuta-nuk-eshte-dokument-i-shenjte/
32 20.08.2023, Gazeta, https://gazeta.mk/maksuti-kushtetuta-nuk-eshte-dokument-i-shenjte/
33 19.08.2023, Almakos, https://almakos.com/maksuti-kushtetuta-nuk-eshte-dokument-i-shenjte/
34 19.08.2023, Flaka, https://flaka.com.mk/kushtetuta-nuk-eshte-dokument-i-shenjte/
35 Sefer Tahiri, 30.06.2023, IMA, https://ima.mk/sq/2023/06/30/raportim-mediatik-etnocentrik-dhe-partiak-mbi-ndryshimet-kushtetuese/
36 "Snopçe për heqjen e 20%: Është kërkesë që vjen nga populli shqiptar, gjuha shqipe është ndër gjuhët më të vjetra në Evropë", Telegrafi, https://telegrafi.com/snopce-per-heqjen-e-20-eshte-kerkese-qe-vjen-nga-populli-shqiptar-gjuha-shqipe-eshte-nder-gjuhet-te-vjetra-ne-evrope/
37 18.08.2023, Nistori, https://nistori.com/lajme/snopce-maqedonasit-duhet-ta-marrin-per-nder-qe-gjuha-shqipe-te-jete-zyrtare/
38 20.08.2023, INA, https://ina-online.net/ku-po-shkoni-ne-evrope-pa-gjuhen-shqipe/
39 14.08.2023, Lajmpress, https://lajmpress.org/bullgaret-ecin-perpara-shqiptaret-ne-gjume-te-thelle/
40 20.08.2023, Zhurnal, https://www.zhurnal.mk/kujdes-me-20-rmv-ja-historikisht-eshte-me-shume-shqiptare-sesa-maqedonase/
41 "Republika e Iliridës", Wikipedia shqip, https://sq.wikipedia.org/wiki/Republika_e_Ilirid%C3%ABs
42 "Maqedonia do të federalizohet pavarësisht se a do të hyjë në BE, vlerëson analistja bullgare", 09.09.2023, INA, https://ina-online.net/maqedonia-do-te-federalizohet-pavaresisht-se-a-do-te-hyje-ne-be-vlereson-analistja-bullgare/
43 09.09.2023, Telegrami.mk, https://telegrami.

mk/maqedonia-do-te-federalizohet-pavaresisht-se-a-do-te-hyje-ne-be-vlereson-analistja-bullgare-2/

44 09.09.2023, Infoshqip, https://www.infoshqip.com/maqedonia-do-te-federalizohet-pavaresisht-se-a-do-te-hyje-ne-be-vlereson-analistja-bullgare/

45 Sefer Tahiri, "Si raportuan mediat në gjuhën shqipe për "propozimin francez"?", Instituti për Media dhe Analitikë IMA, 30.07.2023, https://ima.mk/sq/2022/07/30/si-raportuan-mediat-ne-gjuhen-shqipe-per-propozimin-francez/

46 "Selmani – Koncepti ndëretnik do të thotë të bëjmë kompromise (Селмани - Меѓуетничкиот концепт значи да правиме компромиси), 20.08.2023, Radio Evropa e Lirë në gjuhën maqedonase, https://www.slobodnaevropa.mk/a/selmani---megjuetnichkiot-koncept-znachi-da-pravime-kompromisi-/32552488.html

47 15.08.2023, Flaka, https://flaka.com.mk/kush-deshiron-ceshtjen-e-ndryshimeve-kushtetuese-ta-zhvendos-me-tema-te-tjera/

48 Sefer Tahiri, "Vizita që bëri bujë: Mediat shqipe me qasje afirmative, maqedonaset – kritike ndaj Kurtit", 18.08.2023, IMA, https://ima.mk/sq/2023/08/18/vizita-qe-beri-buje-mediat-shqipe-me-qasje-afirmative-maqedonaset-kritike-ndaj-kurtit/

49 Agregatori i lajmeve Fax.al, https://fax.al/news/38434590/rasti-onkologjia-proteste-kerkohet-pergjegjesi-penale-dhe-politike

50 Agregatori i lajmeve Fax.al https://fax.al/news/38452613/maqedoni-e-veriut-kuvendi-miraton-ndryshimet-e-kodit-penal

51 13.05.2023, Agregatori i Lajmeve Fax.al https://fax.al/news/37328217/escobar-ne-nuk-kerkojme-nga-opozita-ta-mbeshtese-kryeministrin-por-rrugen-euroatlantike-te-maqedonise-se-veriut

52 18.07.2023, Agregatori i lajmeve fax.al, https://fax.al/news/38058585/treshja-e-be-se-ne-kuvend-ndryshimet-kushtetuese-partite-politike-me-qendrime-te-ndryshme

4. NDRYSHIMET KUSHTETUESE NË MEDIA DHE RRJETET SOCIALE: POLARIZIM DHE URREJTJE E FUQISHME, ONLAJN MODERIM I DOBËT, PAK HULUMTIME DHE ANKESA DREJTUAR TRUPAVE VETËRREGULLUESE

Shkruan: PETRIT SARAÇINI

Debati për ndryshimet kushtetuese, të cilat janë kusht për vazhdimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, për një kohë më të gjatë është një ndër temat, të cilave si media ashtu edhe publiku u kushtojnë vëmendje të madhe, dhe e cila padyshim shkakton polarizim të madh në shoqëri.

Përshtypja e përgjithshme është se, ashtu si edhe për çështjet e tjera shoqërore, një pjesë e mediave raportojnë në mënyrë profesionale dhe të balancuar për temat që kanë të bëjnë me ndryshimet kushtetuese, duke u përpjekur t'i japin publikut informacion dhe njohuri nga këndvështrime dhe aspekte të ndryshme. Por në një pjesë të mediave, veçanërisht në sferën onlajn, vërehen raportime të njëanshme dhe joprofesionale, dhe shpesh ka dezinformata dhe gjuhë nxitëse, madje edhe gjuhë urrejtjeje, veçanërisht në postimet në rrjetet sociale dhe komentet e publikut.

Megjithatë, për të mos u bazuar në përfundime dhe perceptime të përgjithshme për të vlerësuar raportimin mediatik për ndryshimet kushtetuese, si dhe polarizimin, dezinformatat dhe gjuhën e urrejtjes, të cilat duket se janë më të pranishme në rrjetet sociale, u përpoqëm të hyjmë më thellë në analizimin e këtyre çështjeve. Mu për këtë, Instituti për Media dhe Analitikë IMA kontaktoi disa shoqata dhe organizata profesionale mediatike, duke përfshirë organizata që kanë përvojë dhe ekspertizë shumëvjeçare në monitorimin e përmbajtjeve mediatike dhe prodhimin e hulumtimeve profesionale të përmbajtjes mediatike. IMA u kërkoi atyre t'u përgjigjen dy pyetjeve lidhur me këtë temë:

1. *Si e vlerësoni raportimin e mediave për ndryshimeve e propozuara kushtetuese që janë një kusht në kornizën e negociatave të BE-së për Maqedoninë e Veriut?*
2. *Në përmbajtjet lidhur me ndryshimet e propozuara kushtetuese në faqet e mediave maqedonase në rrjetet sociale vërehen komente të shumta të lexuesve me retorikë të ashpër, fyerje dhe gjuhë të urrejtjes. Sa i ndjekin mediat udhëzimet etike për moderimin e komenteve dhe parandalimin e përdorimit të platformave të tyre për përhapjen e urrejtjes dhe thirrjeve për dhunë, dhe cilat janë rekomandimet tuaja për ta për këtë çështje, e cila kontribuon në thellimin e polarizimit në komunikimin publik?*

SHGM: Nuk ka parashtresa për këtë temë, duhet shmangur sensacionalizmi, gjuha e urrejtjes të trajtohet në mënyrë të koordinuar nga institucionet

Së pari, kërkuam përgjigje nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, e cila ekziston afër 80 vjet, është anëtare e plotfuqishme në Federatën Evropiane të Gazetarëve, dhe përfaqëson gazetarët dhe punonjësit mediatik që punojnë në mediat në vendin tonë.

"Kur është fjala për mënyrën e raportimit të gazetarëve, theksojmë se në kuadër të SHGM funksionon Këshilli i Nderit, i cili është organ vetërregullues i gazetarëve në Maqedoni, detyra kryesore e të cilit është të kujdeset dhe të promovojë parimet etike, kriteret dhe standardet e gazetarisë profesionale dhe të përgjegjshme të shkruara në Kodin e gazetarëve të Maqedonisë. Ajo që mund të vërehet është se deri më tani deri te Këshilli i Nderit nuk ka arritur parashtresë për këtë temë", thuhet në përgjigjen e SHGM në pyetjen se si e vlerësojnë raportimin mediatik për ndryshimet e propozuara kushtetuese.

Në lidhje me përmbajtjet lidhur me ndryshimet kushtetuese në faqet e mediave maqedonase në rrjetet sociale, dhe komentet e lexuesve me retorikë të ashpër, fyerje dhe gjuhë urrejtjeje, të cilat kontribuojnë në thellimin e polarizimit, SHGM thotë se është e rëndësishme të respektohet roli themelor i medias, e ai është informimi i publikut për ndryshimet kushtetuese, i cili përfshin shpjegimin e përmbajtjes së amendamenteve, kuptimin e tyre dhe si lidhen me procesin e negociatave me BE-në.

"Objektiviteti në raportim është si gjithmonë i rëndësishëm, arsyeja për të cilën mediat duhet të paraqesin një qasje të balancuar në lidhje me ndryshimet, gjegjësisht duhet të përfshihen të gjitha palët në informacion, përfshirë ato pro dhe ato që janë kundër ndryshimeve kushtetuese. Kjo me qëllim që publiku të mund të formojë qëndrimin e tij lidhur me temën", bëjnë me dije nga SHGM.

Shoqata më e vjetër e gazetarëve në vend thekson se është e rëndësishme të shmanget sensacionalizmi, të shmangen titujt provokues që mund të polarizojnë opinionin publik. Ata theksojnë gjuhën e urrejtjes si rrezik të veçantë, adresimi i së cilës kërkon një reagim të koordinuar institucional.

"Rrezik i veçantë, siç thoni edhe ju vetë, është shfaqja e gjuhës së urrejtjes. Në rastin e trajtimit të gjuhës së urrejtjes në kuadër të negociatave me BE-në dhe përmbushjes së Traktatit të Miqësisë me Bullgarinë, qëndrimi i SHGM-së është se gjuha e urrejtjes është vepër penale pavarësisht se për çfarë konteksti bëhet fjalë kur ka shembuj të qartë të gjuhës së urrejtjes, dhe institucionet duhet të tregojnë proaktivitet, pavarësisht nëse ajo plasohet në mediat tradicionale, digjitale apo sociale. Vetëm përmes një reagimi të koordinuar dhe institucional ndaj autorëve nga Prokuroria Publike dhe Ministria e Punëve të Brendshme do të mund të bëhet një betejë efikase dhe efektive kundër gjuhës së urrejtjes. Presim që gazetarët dhe mediat të respektojnë me përpikëri Kodin e Gazetarëve, pra në çdo situatë të re shoqëroro-politike në vend, të informojnë me përgjegjësi dhe profesionalizëm maksimal", thuhet në përgjigjen e SHGM-së.

Georgievska, KEMM: Polarizimi i mediave është i qartë i theksuar në raportimin për ndryshimet kushtetuese

Polarizimi i mediave në Maqedoni në vija politike, veçanërisht në portalet onlajn, është qartë i dukshëm edhe kur bëhet fjalë për raportimin për ndryshimet kushtetuese, thotë Biljana Georgievska, drejtoreshë ekzekutive e Këshillit për Etikë në Mediat në Maqedoni (KEMM) në përgjigjet e saj ndaj pyetjeve të IMA-s lidhur me raportimin e mediave për ndryshimet kushtetuese, si dhe për polarizimin, dezinformatat dhe gjuhën e urrejtjes që janë veçanërisht të dukshme në rrjetet sociale.

"Për dallim nga mediat e afërta me të majtën në pushtet në bllokun politik maqedonas, të cilat vazhdimisht theksojnë deklaratat politike, rekomandimet dhe komentet se "pa ndryshimet kushtetuese nuk do të ketë vazhdim të rrugës evropiane të Maqedonisë së Veriut, do të pasojë regresioni demokratik, fondet e rëndësishme evropiane të zhvillimit dhe për reforma në vend do të mbeten të bllokuara, emigracioni do të vazhdojë...", mediat që anojnë nga e djathta opozitare në bllokun politik maqedonas fokusohen në të kundërtën – se "pas ndryshimeve kushtetuese, do të pasojnë kushte të reja nga Bullgaria, se kjo çon në shpërfytyrimin e popullit maqedonas sipas diktatit të Bullgarisë dhe tradhti të plotë kombëtare". Ky lloj fokusi i transferuar në rrjetet sociale shpeshherë është bazë për përhapjen e dezinformatave, ofendimeve dhe gjuhës së urrejtjes në mesin e lexuesve, gjë që kontribuon edhe më shumë në "ngulitje në istikamet e tyre" të grupeve politike", konsideron Georgievska nga KEMM.

Ajo vuri në dukje se statistikat e Këshillit të Etikës për parashtresat e dorëzuara në Komisionin e ankesave, deri në mesin e gushtit 2023 (83 ankesa të pranuara, për 60 prej tyre është marrë vendim/mendim) tregojnë se më i cenuari (në 38% të vendimeve/mendimeve) është ende neni nr. 1 i Kodit të Gazetarëve (1. Gazetari duhet të publikojë informacion të saktë, të verifikuar dhe të mos fshehë të dhëna thelbësore...).

"Kjo do të thotë se gazetarëve, veçanërisht në mediat onlajn, u mungon profesionalizmi dhe përgjegjësia, që në masë të madhe kontribuon në përhapjen e informacionit të pasaktë, e me këtë edhe në rënien e besimit në mediat në përgjithësi", tha Georgievska.

Më tej, drejtoresha ekzekutive e KEMM thotë se çereku ose 25% e shkeljeve të Kodit të Gazetarëve, sipas vendimeve të Komisionit të ankesave, i referohen nenit 10 (10. Gazetari nuk duhet të krijojë apo përpunojë me vetëdije informacione që kërcënojnë të drejtat apo liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë e diskriminim...). Kjo vlen veçanërisht për komentet që pasojnë një tekst gazetaresk të publikuar në faqen e internetit të medias ose në profilin e medias në rrjetet sociale.

"Neglizhimi i obligimit të redaksisë për të hequr komentet që janë diskriminuese, që bëjnë thirrje për urrejtje apo dhunë më së shpeshti shpjegohet me mungesën e stafit dhe mjeteve të redaksisë për "pastrim" të rregullt të komenteve ofenduese dhe keqdashëse. Në këtë mënyrë, mediat jo vetëm që kontribuojnë në përhapjen e informacionit të pasaktë dhe gjuhës së urrejtjes, por nuk bëjnë asnjë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin për pasojat negative të gjuhës së urrejtjes, për të identifikuar dhe ekspozuar një gjuhë të tillë dhe për të vënë në dukje aktorët që e prodhojnë atë, siç kërkohet me nenin 10.3 të Udhëzimeve për raportimin etik të mediave onlajn, për të cilat janë obliguar anëtarët e KEMM-së", thekson Biljana Georgievska nga KEMM.

Trpevska, Instituti RESIS: Një numër i vogël i mediave onlajn respektojnë Udhëzimet e raportimit etik për moderimin e komenteve në rrjetet sociale

Për t'u dhënë përgjigje përkatëse këtyre dy pyetjeve, është e nevojshme të kryhet një hulumtim i hartuar me kujdes. Është një ndërmarrje e ndërlikuar, por vetëm në këtë mënyrë mund të nxjerrim ndonjë lloj përgjithësimesh. Gjithçka tjetër duket se bie në të menduarit me sens të shëndoshë, që bazohet në atë që kemi fituar si përshtypje nga burimet nga të cilat ne personalisht marrim informacione - konsideron Dr. Snezhana Trpevska nga Instituti RESIS.

"Për t'iu përgjigjur pyetjes së parë duhet bërë një analizë sasiore dhe cilësore të përmbajtjes së raportimit mediatik. Por para kësaj, për të vendosur metodologjinë e analizës, duhet të përcaktoni disa aspekte të rëndësishme të hulumtimit, duke përfshirë edhe: Për cilat media dëshironi të nxirrni përfundime, qofshin ato onlajn apo ato tradicionale që kanë ndikim më të madh mbi formimin e opinionit publik? Nëse doni të merrni njohuri vetëm për mediat onlajn, atëherë cilat media do të merrni në konsideratë, pasi janë mbi 100 në vend? Më pas, duhet ta definoni kornizën konceptuale të raportimit për ndryshimet kushtetuese, gjegjësisht çfarë do të analizoni në tekstet apo kronikat e mediave?", bën me dije Trpevska.

Ajo thotë se si organizatë hulumtuese nuk kanë bërë një analizë sistematike të përmbajtjes për këtë çështje, kështu që nuk mund të ndajë ndonjë njohuri relevante, as nuk mund të ndajë përshtypjet personale, bazuar në mediat nga të cilat informohet, sepse kjo do të ishte njohuri anekdotike, e cila mbështetet vetëm në një ose dy raste.

"Për pyetjen e dytë, gjuhën e urrejtjes dhe komentet fyese të lexuesve të postuara nën tekste mediatike në rrjetet sociale, sërish është e vështirë të përgjithësohet, edhe pse të gjithë e dimë që komente të tilla ekzistojnë. Ajo që unë di nga përvoja personale si anëtare e Komisionit të ankesave të Këshillit të Etikës, është se vetëm një numër i vogël i mediave onlajn i respektojnë Udhëzimet për raportim etik të medias onlajn – të ndërhyjnë kur ka gjuhë të qartë urrejtjeje kundër anëtarëve të një grupi të caktuar. Madje, mendoj se vetë mediat nuk i kanë lexuar këto Udhëzime, ndonëse u janë dërguar në fazën e diskutimit publik, para tre vitesh", thotë Trpevska, duke treguar se bëhet fjalë për nenin 10 të Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë - i cili është elaboruar në Udhëzimet në disa pika, nga të cilat pika 10.4 i referohet pikërisht komenteve të lexuesve:

Neni 10 – Kodi i gazetarëve të Maqedonisë

Gazetari nuk do të krijojë apo përpunojë me vetëdije informacion që kërcënon të drejtat apo liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim mbi asnjë bazë (kombëtare, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientimi seksual, përkatësie politike...).

Pika 10.4. – Udhëzime për raportimin etik të mediave onlajn

Mediat online janë përgjegjëse për shqyrtimin e rregullt dhe heqjen e shpejtë të komenteve të përdoruesve që publikohen nën përmbajtje gazetareske në faqet e internetit ose në rrjetet sociale, të cilat përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe kanë potencial të shkaktojnë pasoja të dëmshme në shoqëri.

Trpevska gjithashtu theksoi se përgjegjësia e mediave onlajn për përmbajtjet e postuara nga përdoruesit është një çështje e cila është trajtuar në mënyrë specifike në nenin 20 të Udhëzimeve, dhe jo vetëm në lidhje me gjuhën e urrejtjes.

"Është e rëndësishme të kuptohet se në ekosistemin e digjitalizuar koncepti i përgjegjësisë editoriale po ndryshon – media është përgjegjëse për komentet e përdoruesve që ka inkurajuar vet, në vend që t'i ekspozojë, kritikojë ose heqë ato, siç thuhet në Udhëzimet. Për këtë qëllim, çdo medium duhet të vendosë rregullat e veta që do t'i publikojë në faqet e saj në rrjetet sociale. Lexuesit që ndjekin mediat duhet të jenë të vetëdijshëm se kjo është sferë publike dhe se liria e shprehjes ka kufij", thotë Trpevska.

Neni 20 – Përgjegjësia për publikimin e komenteve nga lexuesit

20.1. Media onlajn është përgjegjëse edhe për përmbajtjen e komenteve të publikuara nga lexuesit e saj, të publikuara në faqen e medias onlajn në zonën e komenteve, nën përmbajtjen gazetareske.

20.2. Mediumi onlajn do të heqë të gjitha komentet që përmbajnë: thirrje për dhunës ose vepra të tjera penale, gjuhë të urrejtjes, diskriminim, kërcënime dhe forma të tjera të rrezikimit të të drejtave dhe sigurisë së individëve, grupeve, institucioneve, pavarësisht nëse ato lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me tekstin ose temën që trajton.

20.3. Mediumi onlajn do të përcaktojë rregulla për redaktimin e komenteve të lexuesve në hapësirën për komente të lira nën tekstet dhe përmbajtjet e publikuara. Ato rregulla do të publikohen në platformat në të cilat publikohet përmbajtja dhe do të përmbajnë: informacion për regjistrimin e komenteve, respektimin e rregullave të komentimit, përmbajtje të palejuara në komente, arsyen e heqjes së komenteve, etj.

Trpevska thotë se Komisioni për ankesa në Këshillin e Etikës edhe këtë vit ka pranuar një numër të madh të ankesave për komentet e lexuesve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, por një numër i vogël kanë të bëjnë me tekstet që lidhen me ndryshimet kushtetuese. "Më të shumtat kanë qenë ato që kanë të bëjnë me mbajtjen e Paradës së krenarisë. Në të gjitha rastet e tilla, Komisioni ka marrë vendim se është shkelur neni 20 i Udhëzimeve dhe dispozita 10.4, përkatësisht neni 10 i Kodit të Gazetarëve", thuhet në përgjigjen e Dr. Trpevskës në pyetjet e IMA-s.

Metamorfosis: Për ndryshimet kushtetuese janë shpërndarë dezinformata, për të luftuar gjuhën e urrejtjes nevojitet reagim më efektiv i autoriteteve dhe ndërgjegjësim në media

Edhe nga Fondacioni Metamorfozis thonë se nuk mund t'i përgjigjen thjeshtë pyetjes për vlerësim të raportimit të mediave për ndryshimet e propozuara kushtetuese, sepse nuk kanë bërë hulumtime që do të jepnin një pasqyrë të qartë të të gjitha aspekteve të ngritura nga pyetja. "Ajo që është e qartë është se për temat që kanë të bëjnë me ndryshimet kushtetuese janë përhapur dezinformata të ndryshme, veçanërisht në lidhje me përmbajtjen e dokumenteve si Protokolli me Bullgarinë, si dhe një sërë manipulimesh të bazuara në interpretime apo gjysmë të vërteta të ndryshme. Lidhur me këtë, në qershor, në konferencën "Ndërtimi i rezistencës shoqërore ndaj efekteve të dëmshme të dezinformatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut», drejtori i Ag-

jencisë së Kundërzbulimit paralajmëroi se ndryshimet kushtetuese do të jenë një nga temat kryesore të fushatave dezinformuese. Fatkeqësisht, nxitja e atmosferës politike me dezinformata është përcjellë edhe me përhapjen e gjuhës së urrejtjes, veçanërisht me qëllim të nxitjes së jotolerancës ndëretnike", thonë nga Metamorfozis.

Sa i përket pyetjes së dytë – se sa media i ndjek udhëzimet etike për moderimin e komenteve në rrjetet sociale dhe parandalimin e përhapjes së gjuhës së urrejtjes në profilet e tyre të rrjeteve sociale që shërbejnë si platforma për sa më shumë lexues, është e rëndësishme të theksohet se kjo dukuri është seriozisht e pranishme dhe nuk është e re, por mund të thuhet se është endemike - thuhet në përgjigjen e kësaj organizate. "Për më tepër që gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale nuk ka të bëjë vetëm me çështjen e ndryshimeve kushtetuese, por sipas të gjitha përvojave të organizatave profesionale që monitorojnë gjuhën e urrejtjes dhe organizatave profesionale gazetareske dhe Këshillit të Etikës, është konstatuar se është prezent më së shpeshti për çështjet e politikës gjinore, u drejtohet veçanërisht individëve që janë anëtarë të komunitetit LGBTIQ, anëtarë të grupeve të ndryshme etnike/racore, anëtarëve apo simpatizuesve të partive dhe opsioneve politike etj.", theksojnë nga Metamorfosis.

Nga kjo organizatë mediatike thonë se sipas normave ligjore që rregullojnë hapësirën mediatike (Ligji për media dhe Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale), mediat janë të lira në politikën e tyre redaktuese dhe në përmbajtjen e produkteve gazetareske, por në të dyja ligjet ka një nen që ndalon përhapjen e urrejtjes në disa baza, por fatkeqësisht nuk njihet gjuha e urrejtjes në bazë politike.

"Gjithashtu, në disa nene Kodi penal e trajton gjuhën e urrejtjes si krim, dhe në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi është përcaktuar saktësisht se çfarë nënkupton diskriminimi dhe kush është i detyruar të merret me të, dhe këtu përmenden dhe mediat. Prandaj, kur flitet për gjuhën e urrejtjes, duhet pasur parasysh se ajo është e rregulluar, gjegjësisht e ndaluar si krim në Kodin Penal, e veçanërisht përhapja e saj përmes rrjeteve kompjuterike, d.m.th. dhe përmes rrjeteve sociale", bëjnë me dije nga Metamorfozis.

Sipas kësaj organizate, rrethi i mbyllur në hapësirën mediatike në Maqedoni krijohet me atë se mediat nuk lejojnë komente në faqet e tyre të internetit, por komentet janë të mirëseardhura dhe të lejuara në llogaritë e mediave në rrjetet sociale, veçanërisht në Fejsbuk, sepse me këtë rritet dukshmëria e artikujve brenda algoritmit të platformës, dhe rrjedhimisht edhe kapaciteti reklamues i mediumit.

Edhe nga Metamorfozis vënë në dukje se nga pikëpamja e vetërregullimit, mediat kanë udhëzime etike që të moderojnë komentet në portalet e tyre, por edhe në rrjetet sociale, siç thuhet në Udhëzimet për Raportimin Etik të Mediave Onlajn, dokument që përfaqëson një shembull për aplikim të Kodit të Gazetarëve në sferën onlajn, i zhvilluar dhe promovuar në vitin 2021 nga KEMM me mbështetjen e OSBE-së.

"Por problemi është se mediat nuk duan të heqin dorë nga komentet e tyre, për arsyet e lartpërmendura, e në të njëjtën kohë, sipas përvojës së KEMM, shpesh thonë se nuk kanë potencial të mjaftueshëm kuadrosh për të moderuar komentet. Nga këtu, vetërregullimi përmes Udhëzimeve nuk mund të ndihmojë shumë në afat të shkurtër për të parandaluar ose hequr komentet në mediat sociale, megjithëse ka shembuj të portaleve me trafik të lartë që, sapo kanë pasur dijeni se ka ankesë kundër postimit të tyre në rrjetet sociale për gjuhë të urrejtjes, qoftë në tekst apo në komente, e heqin përmbajtjen në tërësi", bëjnë me dije nga Metamorfozis.

Sipas kësaj organizate, shikuar në terma afatgjatë, duke rritur ndërgjegjësimin e pronarëve dhe redaktorëve dhe gazetarëve në mediat onlajn dhe duke futur procedura të brendshme në redaksi sipas Udhëzimeve dhe parimeve të tjera etike profesionale, mund të veprohet përmes rritjes së ndërgjegjësimin të publikut për nevojën për të moderuar komentet ose për ato përmbajtje, për të cilat është e lehtë të supozohet se janë shumë të rrezikshme për komente me gjuhë të urrejtjes, të mos shpërndahen në rrjetet sociale ose të ndalojnë/moderojnë komentimin e tyre.

"Njëkohësisht, duhet theksuar se, në kuadër të detyrimeve të ndërmarra më parë në marrëdhëniet me Bashkimin Evropian (Kodi i sjelljes së BE-së kundër gjuhës së urrejtjes onlajn), si dhe sipas rregullativës së re të BE-së që ka hyrë së fundmi në fuqi, platformat duhet të kenë mekanizmat e tyre për heqjen e përmbajtjeve të paligjshme, ku bëjnë pjesë edhe përmbajtje lidhur me vepra penale si gjuha e urrejtjes. Më saktësisht, detyrimet kundër gjuhës së urrejtjes mbulohen nga Akti i shërbimeve digjitale (Digital Services Act), të cilin vendi ynë, si kandidat për anëtarësim në BE, duhet ta miratojë dhe zbatojë sa më shpejt të jetë e mundur", bëjnë me dije nga Metamorfosis. Ata gjithashtu shpjegojnë se këta mekanizma janë të ndryshëm nga ata që lidhen me verifikimin e fakteve. Kështu, për shembull, metodologjia e Partneritetit për verifikimin e fakteve nga palët e treta në Fejsbuk, në të cilën merr pjesë edhe Vërtetmatësi, nuk përfshin shënjimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes.

Sa i përket parandalimit të gjuhës së urrejtjes në pranitë e mediave në rrjetet sociale, Metamorfozis thotë se është e nevojshme punë e vazhdueshme në terren me pronarët/redaktorët/gazetarët në mediat onlajn për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për rrezikun e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në çfarëdo lloj baze në rrjetet sociale në komentet e postimeve të tyre, por edhe vëmendje të veçantë ndaj krijimit të teksteve që janë rrezik potencial për gjuhë të urrejtjes dhe diskriminim.

"Gjithashtu, është e nevojshme të ndalet kultura e mosndëshkimit, përmes një mbikëqyrjeje të shtuar nga shteti në bashkëpunim me sektorin civil dhe me organizata të specializuara gazetareske në monitorimin dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në rrjetet sociale, dhe, kuptohet, një reagim shumë më efikas dhe më i shpejtë i autoriteteve hetimore dhe gjyqësore në fushën e sanksionimit të përhapjes së një gjuhe të tillë", thuhet në përgjigjen e Metamorfozis për IMA.

Përfundime dhe rekomandime: Si të veprohet për të reduktuar polarizimin, dezinformatat dhe gjuhën e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale?

Nga pikëpamjet, perceptimet dhe informacionet e paraqitura në këtë analizë nga organizatat profesionale mediatike, organet vetërregulluese dhe organizatat hulumtuese të medias, mund të konkludohen disa gjëra.

Së pari, mbizotëron përshtypja se debati publik për ndryshimet kushtetuese është shumë i polarizuar dhe për këtë kontribuon edhe një pjesë e mediave, ndërkohë që kjo është më e dukshme në ato media që janë të afërta me opsionet politike që kundërshtohen për këtë çështje, dhe reflektohet më së shumti në rrjetet sociale.

Polarizimi për këtë çështje është vetëm një pjesë e "betejës" për pothuajse të gjitha temat, e cila imponohet kryesisht nga aktorët politikë.

Në të njëjtën kohë, siç theksuan Reporterët pa kufij në raportin e fundit për vendin, polarizimi politik intensifikohet përmes sistemeve paralele mediatike të krijuara nga partitë si nga pushteti ashtu edhe nga opozita, presionet ekonomike në media, si dhe rrjetet sociale që favorizojnë përgjithësisht përhapjen e dezinformatave, gjëra të cilat në kombinim me standardet e ulëta profesionale, kontribuojnë në përkeqësimin e situatës mediatike që rezulton në rënien e besimit të publikut në media dhe intensifikimin e sulmeve ndaj mediave dhe gazetarëve. Për të adresuar këto probleme komplekse, është e qartë se duhet shumë përpjekje nga të gjithë aktorët, si në politikë ashtu edhe në media, si dhe bashkëpunim në mirëbesim mes tyre, gjë që aktualisht mungon.

Por, është indikative se për raportimin e mediave për ndryshimet kushtetuese, siç tregohet nga SHGM dhe KEMM, ka pak ankesa të drejtuara organeve vetërregulluese të mediave, gjë që tregon se palët e interesuara i përdorin pak mekanizmat vetërregullues për të adresuar shkeljet e mundshme etike të mediave në raportimin për këtë çështje.

Gjithashtu, është evidente se mungon hulumtim më i tërësishëm sasior dhe cilësor lidhur me raportimin e mediave për këtë temë të rëndësishme, e cila ka qenë objekt i interesit të lartë publik për një periudhë të gjatë kohore. Disa nga organizatat e kontaktuara nga IMA kanë treguar se nuk kanë hulumtime më të sakta për këtë temë, ndaj shprehën rezerva për të dhënë përgjigje për të vlerësuar raportimin e mediave për ndryshimet kushtetuese.

Ndoshta arsyeja për këtë është mungesa e fondeve – gjegjësisht dihet që prej vitesh mungon përkrahja nga buxheti i shtetit për projektet kërkimore të institucioneve shkencore dhe arsimore. Mirëpo, çështjet që kanë të bëjnë me negociatat e vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke përfshirë edhe çështjen e ndryshimeve kushtetuese e cila ka ndikim edhe në mbështetjen për vetë BE-në në vend, si dhe në polarizimin, forcimin e dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes, meritojnë trajtim më serioz nga aspekti i hulumtimeve mediatike.

Ndoshta mjetet për përpjekje të tilla duhet të kërkohen dhe të priten përsëri nga fondet ndërkombëtare dhe të BE-së, përfshirë ato për bashkëpunimin ndërkufitar - sepse çështja e gjuhës së urrejtjes është një kapitull i veçantë në Protokollin e takimit të dytë të Komisionit të përbashkët ndërqeveritar me Bullgarinë, në të cilin të dy shtetet obligohen të marrin masa efektive për të parandaluar propagandën keqdashëse nga ana e institucioneve dhe agjencive dhe për të dekurajuar aktivitetet e subjekteve private, që synojnë nxitjen e dhunës, urrejtjes ose aktivitete të tjera të ngjashme, të cilat do të dëmtonin marrëdhëniet e tyre.

Prej përgjigjeve vërehet gjithashtu pajtueshmëri e ekspertëve se një pjesë e madhe e mediave onlajn nuk respektojnë Udhëzimet për raportim etik, të cilat i referohen përgjegjësisë për përmbajtjen e komenteve të lexuesve. Mediat duhet të moderojnë diskutimet në faqet e tyre në rrjetet sociale dhe të heqin komentet që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, diskriminim, thirrje për dhunë apo krime të tjera, kërcënime dhe forma të tjera të rrezikimit të të drejtave dhe sigurisë së individëve, grupeve, institucioneve, pavarësisht nëse ato lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me tekstin e botuar ose temën që trajtohet.

Edhe pse një pjesë e mediave justifikohen se nuk kanë burime njerëzore apo mjete financiare për një operacion të tillë, justifikimi duket se ka një bazë të hollë, veçanërisht duke pasur parasysh se në vend ka edhe shembuj të mediave onlajn që prapëseprapë arrijnë të moderojnë diskutimet e lexuesve të tyre në rrjetet sociale. Kjo çon në një tjetër konkluzion të mundshëm, se një pjesë e medias përdor qëllimisht sensacional-

izëm, tituj provokues apo klikues (klickbait) dhe lejon lloj-lloj komentesh për të rritur lexueshmërinë e postimeve dhe ueb faqeve të tyre. Në të ardhmen, duhet të vazhdojë puna për ndërgjegjësimin e mediave se këto çështje kontribuojnë vetëm në uljen e besimit ndaj tyre dhe në ikjen e publikut nga mediat, që është gjithashtu një trend botëror, siç tregojnë hulumtimet e Institutit Reuters të Universitetit të Oksfordit.

Në lidhje me gjuhën e urrejtjes, organizatat mediatike vazhdimisht theksojnë se për minimizimin dhe luftimin e saj nevojitet veprim konsistent dhe reagim i koordinuar nga institucionet kompetente – në radhë të parë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë. Vite më radhë, në vend mbizotëron praktika e mosndëshkimit të gjuhës së urrejtjes. Edhe pse kjo pamje duket se po ndryshon kohët e fundit, situata në terren, si në botën reale ashtu edhe në atë virtuale, përfshirë debatin e ashpër të polarizuar për ndryshimet kushtetuese, tregon nevojën për përpjekje shumë më të mëdha institucionale në këtë drejtim. Natyrisht, në këtë drejtim është i rëndësishëm edhe roli i mediave, të cilat duhet të përfshihen më aktivisht në përballjen me këtë dukuri negative dhe të përmbahen nga përmbajtjet që përhapin apo shkaktojnë gjuhë të urrejtjes.

Referencat:

1 Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë, në dispozicion në https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/

2 Udhëzime për raportim etik të mediave onlajn, KEMM, në dispozicion në: https://semm.mk/dokumenti/korisni-resursi/kodeks/850-nasoki-za-etichko-izvestuvanje-na-onlajn-mediumite

„ Me të pavërteta për Protokollin me Bullgarinë po nxehet atmosfera para ndryshimeve kushtetuese", Vërtetmatës.mk, 07.08.2023, në dispozicion në: https://vistinomer.mk/so-nevistini-za-protokolot-so-bugarija-se-podgreva-atmosferata-pred-ustavnite-izmeni/

3 „ Agjencia e Kundërzbulimit: Do të jemi cak i dezinformatave për amendamentet kushtetuese, çështjen kishtare dhe zgjedhjet në vitin 2024", Vërtetmatësi.mk, 21.06.2023, në dispozicion në: https://vistinomer.mk/agencija-za-razuznavanje-kje-bideme-meta-na-dezinformacii-za-ustavnite-izmeni-crkovnoto-prashanje-i-izborite-vo-2024/

4 Reporterët pa kufij, Maqedonia e Veriut, në dispozicion në https://rsf.org/en/country/north-macedonia

5 Protokolli nga takimi i dytë i Komisionit të përbashkët ndërqeveritar me Bullgarinë, i publikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në: https://www.mfa.gov.mk/mk/page/13/post/3040/protokol-od-vtoriot-sostanok-na-zaednichkata-megjuvladina-komisija-so-bugarija-sken-od-oficijalnata-potpishana-verzija

6 Instituti Reuters, Universiteti i Oksfordit, Projekti Besimi në lajme, në dispozicion në: https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/trust-news-project

